



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Viti: 2023 – Numri: 15

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E hënë, 30 janar 2023

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 17, datë 26.1.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 1911
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 23, datë 18.1.2023	Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor, për vitin 2023..... 1911
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 26, datë 27.1.2023	Për bazën e të dhënave të platformës “Me ty për Shqipërinë që duam”, rregullat e detajuara për seksionet e saj, të dhënat parësore e dytësore, dhënësit e informacionit, ndërveprimin me bazat e tjera të të dhënave, sistemet elektronike dhe protokollet e institucioneve..... 1916
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 27.1.2023	Për transferimin në pronësi të Bashkisë Roskovec, për Njësinë Administrative Kurjan, të pasurisë me numër 213, zona kadastrale 3805, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 770, datë 24.9.2010, të Këshillit të Ministrave..... 1921
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 28, datë 27.1.2023	Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve..... 1923
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 29, datë 27.1.2023	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Zgjerimi i varrezave publike Kuçovë”..... 1927
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 33, datë 27.1.2023	Për miratimin e buxhetit për Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale, për vitin 2023..... 1928
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 36, datë 27.1.2023	Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e spitaleve rajonale, terciare dhe qendrave spitalore rajonale publike..... 1929
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 37, datë 27.1.2023	Për disa shtesa në vendimin nr. 330, datë 22.4.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore ‘Sistemi i deklarimit të pasurisë dhe konfliktit të interesit – EACIDS’”..... 1930

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 38, datë 27.1.2023	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2023, miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për organizimin e zgjedhjeve për organet e vetëqeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023.....	1931
Urdhër i ministrit të Kulturës nr. 18, datë 12.1.2023	Për delegim kompetencash.....	1931
Urdhër i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 36, datë 24.1.2023	Për miratimin e rregullores për krijimin e regjistrimit shtetëror të revistave shkencore që botohen në Republikën e Shqipërisë.....	1932
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 42, datë 27.12.2022	Me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet jo më pak se një të katërtës së deputetëve dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Deklarimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 80/2021, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, “Për mosmiratimin e projektvendimit, ‘Për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve dhe mosveprimeve të institucioneve shtetërore dhe funksionarëve publikë në çështjet që kanë sjellë si pasojë vendimin e arbitrazhit ‘Becchetti dhe të tjerë kundër Shqipërisë’”.....	1937
Urdhër i Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 16, datë 25.1.2023	Për delegim të përkohshëm kompetencash.....	1956
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 357, datë 30.12.2022	Mbi kërkesën e shoqërisë “E-Vento s.r.l. Albania” sh.p.k., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 32, datë 4.2.2021, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘E-Vento s.r.l. Albania’ sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 84, datë 17.7.2008, i ndryshuar”.....	1957
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 359, datë 30.12.2022	Mbi përfundimin e procedurës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘HEC Bishnica 1, 2’ sh.p.k., për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet palëve, shoqërisë Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a. dhe shoqërisë ‘HEC Bishnica 1, 2’ sh.p.k.”.....	1958
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 360, datë 30.12.2022	Mbi përfundimin e procedurës së filluar me vendimin e ERE-s nr. 112, datë 19.5.2022, mbi kërkesën e shoqërisë “HEC - i Tërvolit” sh.p.k., “Për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet shoqërisë Furnizuesi i Tregut të Lirë (FTL) sh.a. dhe shoqërisë ‘HEC - i Tërvolit’ sh.p.k.”.....	1960
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 81/5, datë 25.1.2023	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajjtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Lidhja e Rrugës Transballkanike me Portin Detar, Vlorë”.....	1961
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 83/3, datë 24.1.2023	Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajjtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtim i Qendrës Shëndetësore në lagjen ‘Gafurr Muço’”, Bashkia Lushnjë.....	1965
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 94/1, datë 20.1.2023	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajjtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikimi urban i rrugëve ‘Ura e Re-Shish’, ‘Antipatrea’, shëtitortja ‘Osumi’ dhe ‘Santa Lucia Filipine’, Berat.....	1967

**DEKRET****Nr. 17, datë 26.1.2023****PËR LEJIMIN E LËNIES SË  
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 13, nenit 14, nenit 20 dhe në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

**DEKRETOJ:****Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Gëzim Mustafa Mançka
2. Alessandra Gëzim Mançka
3. Mirel Agim Demo
4. Artisa Alban Burazeri
5. Juxhin Anesti Ganellari
6. Adelaide Gëzim Mançka
7. Fiorentina Qani Saraçi
8. Nancy Arjan Lleshi
9. Olsi Arqile Teta
10. Ana Fejzo Hysaj-Sopi
11. Bëan Benjamin Sopi
12. Dorina Xhemal Cekani
13. Kevin Kujtim Cekani
14. Ajda Kujtim Cekani
15. Ajan Kujtim Cekani
16. Rudina Seit Osmani (Rruci)
17. Zlatan (Artan) Niko ŠOĆ (Shoqja)
18. Nensi Roland Rexho
19. Alban Ilirjan Qinami
20. Marsida Ferit Sinani
21. Suela Agim Selaci
22. Domenik Pedro Dëma
23. Enxhi Adnand Zaloshnja
24. Besian Maksi Nuellari
25. Marjan (Marian) Sllobodan Sekulić (Pambuku)
26. Rovena Kujtim Rucaj
27. Engjell Sali Qamirani
28. Priam Sali Qamirani
29. Erind Vladimir Hoxha
30. Vasil Spiro Radomi
31. Helena Vasil Radomi

32. Melina Vasil Radomi
33. Anisa Muhamet Kohnen (Cegrani)
34. Rexhino Flamur Hodja
35. Jasmina Danil ŠOĆ (Gjinoviq)
36. Klevis Fatbardh Gjergji
37. Qendrim Shefqet Zebeli
38. Ermelinda Jenari Eppler (Zenelaj)
39. Elvis Vogël Xhebexhia

**Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË**

**Bajram Begaj****VENDIM****Nr. 23, datë 18.1.2023****PËR FINANCIMIN E SHËRBIMEVE  
SHËNDETËSORE SPITALORE NGA  
SKEMA E DETYRUESHME E  
SIGURIMEVE TË KUJDESIT  
SHËNDETËSOR, PËR VITIN 2023**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, të nenit 10, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 53, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Financimin nga skema e detyrueshme e sigurimeve shëndetësore të paketës së shërbimeve të ofruara në spitalet publike, sipas listës së shërbimeve në shtojcën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Spitali e ushtron veprimtarinë e tij, në përputhje me standardet, treguesit e cilësisë e të performancës, protokollet e diagnozës e të trajtimit, të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

3. Buxheti për mbulimin e paketës së shërbimeve spitalore, sipas listës së shërbimeve që



ofron çdo spital, ndahet sipas shtojcës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor lidh kontratat me spitalet për financimin e paketave të shërbimeve shëndetësore të ofruara prej tyre, në përputhje me indikatorët e performancës spitalore.

5. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor financon paketën e shërbimeve spitalore të kontraktuara me këto metoda:

a) Buxhetim me zëra shpenzimesh, për:

i. paga dhe shpenzime të tjera lidhur me pagën e personelit;

ii. kontribute për sigurime shëndetësore e shoqërore të personelit;

iii. mallra e shërbime të tjera.

b) Buxhetim për pagesën e paketave të shërbimeve me çmime të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Buxheti detajohet për çdo spital në zëra shpenzimesh me vendim të Këshillit Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

c) Buxhetim për spitalet Durrës e “Memorial” Fier. Detajimi në zëra shpenzimesh i buxhetit miratohet nga bordet e këtyre spitaleve. Fondi financon dy spitalet nëpërmjet transfertave në llogaritë bankare që spitalet kanë në bankat e nivelit të dytë.

6. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor financon spitalet, në zbatim të vendimit nr. 258, datë 24.4.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjës”. Fondi rishikon financimin e spitaleve për këtë kontratë gjatë vitit, me vendim të Këshillit Administrativ, me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë e Mbrojtjes Sociale ose të strukturave përgjegjëse.

7. Spitali është përgjegjës për zbatimin e buxhetit të kontraktuar, sipas zërave të përcaktuar të buxhetit, në përputhje me indikatorët dhe aktivitetin e shërbimit spitalor.

8. Rishpërndarja e buxhetit ndërmjet spitaleve bëhet brenda një kufiri prej 3% të buxhetit të spitaleve, me vendim të Këshillit Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

9. Një fond jo më i madh se 30% e buxhetit vjetor, i planifikuar për shërbimet spitalore, mbahet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për ta shpërndarë gjatë vitit, me vendim të Këshillit Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, përkatësisht, për:

a) financimin e shërbimit spitalor gjatë vitit;

b) pagesat e paketave të shërbimeve të veçanta, të ofruara nga shërbimet spitalore, publike e jopublike, brenda e jashtë vendit, të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave;

c) pagesat për kujdes shëndetësor në institucione jopublike, brenda e jashtë vendit, sipas miratimit, rast pas rasti, me vendim të Këshillit të Ministrave;

ç) pagesat për kujdes shëndetësor, sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara;

d) pagesat e shërbimeve të kryera për llogari të spitaleve publike nga operatorë të kontraktuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, sipas legjislacionit për partneritetin publik privat;

dh) transferta për individët (mjekë në shërbimet spitalore).

10. Shpenzimet kapitale për investimet në spitale mbulohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor vlerëson kërkesat e spitaleve (rajonale/bashkiake) për investimet dhe ia paraqet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për miratim. Spitalet universitare paraqesin kërkesën për investime në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

11. Burime të tjera financimi për spitalet janë fondet e krijuara nga të ardhurat e realizuara gjatë veprimtarisë së tyre dhe nga dhurimet. Përdorimi i tyre bëhet tërësisht nga vetë spitali, si pjesë e kostos së shërbimit, bazuar në procedurat e miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Këto të ardhura vlerësohen si të ardhura jashtë limitit, të cilat mbarten në vitin buxhetor pasardhës.

12. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për raste të vlerësuara nga ajo ose me kërkesë të autoriteteve kontraktuese (spitaleve), mund të zhvillojë procedura të përqendruara prokurimi për disa mallra, shërbime dhe investime.

13. Spitali zbaton sistemin e referimit dhe tarifat për shërbimet me pagesë, të miratuara nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.



14. Numri i përgjithshëm i punonjësve të spitaleve është 13 200 (trembëdhjetë mijë e dyqind) veta, nga të cilët 141 (njëqind e dyzet e një) punonjës në Spitalin Universitar të Traumës për Shërbimin e Urgjencës Ambulatore dhe Shërbimin e Ortopedi-Traumatologjisë.

15. Për raste të veçanta të mungesës së mjekut specialist në shërbime të ndryshme të spitaleve rajonale, bashkiake dhe ditore, ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, brenda numrit të përgjithshëm të personelit spitalor, urdhëron kontraktimin, për një periudhë të caktuar, të mjekëve specialistë. Për spitalet bashkiake dhe ditore, kur nuk plotësohen kushtet e përcaktuara në paragrafin e parë të kësaj pike, ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale urdhëron kontraktimin e mjekëve të përgjithshëm, pranë shërbimit të urgjencës. Mjekët e përcaktuar në këtë pikë, përveç pagës, trajtohen financiarisht me një bonus deri në 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë në muaj. Vlera e bonusit përcaktohet, rast pas rasti, nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, bazuar në vlerësimin e komisionit përkatës. Ky bonus, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, trajtohet sipas shkronjës “e”, të pikës 2, të kreut II, të vendimit nr. 77, datë 28.1.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”, të ndryshuar.

16. Mjekët e kontraktuar, sipas pikës 15, të këtij vendimi, nuk e përfitojnë shpërblimin sipas shkronjave “a” e “b”, të pikës 9/1, të vendimit nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe niveleve të pagave të personelit mjekësor, të punonjësve të tjerë me arsim të lartë dhe të punonjësve të personelit teknik të shkencave mjekësore, në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura dhe në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe spitalin përkatës”, të ndryshuar.

17. Numri i pedagogëve me kontratë shërbimi për spitalet universitare miratohet nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Pagesa e tyre bëhet nga buxheti për shërbimet e spitalit.

18. Financimi i institucioneve dhe i shërbimeve, të përcaktuara në shtojcën nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi, bëhet nga Fondi i Sigurimit të

Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, vetëm kundrejt shtesave përkatëse në buxhet, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

19. Vendimi nr. 43, datë 19.1.2022, i Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2022”, të ndryshuar, shfuqizohet.

20. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 1 janar 2023.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
**Belinda Balluku**

#### SHTOJCA NR. 1

#### LISTA E SHËRBIMEVE SPITALORE QË DO TË FINANCOHEN NGA FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

##### I. SPITALET UNIVERSITARE

1. Shërbimi i kardiologjisë:
  - a) Hemodinamika;
  - b) Reanimacioni i kardiologjisë;
2. Shërbimi i kardiokirurgjisë;
3. Shërbimi i kirurgjisë angiovaskulare;
4. Shërbimi i hematologjisë;
5. Shërbimi i gastro-hepato-enterologjisë;
6. Shërbimi i endokrinologjisë;
7. Shërbimi i nefrologjisë dhe hemodializës;
8. Shërbimi i anestezi-reanimacionit;
9. Shërbimi i urgjencave polivalente;
10. Shërbimi i hipertonsisë dhe i mjekësisë interne;
11. Shërbimi i alergologjisë;
12. Shërbimi i reumatologjisë;
13. Shërbimi i dermatologjisë;
14. Shërbimi i traumatologjisë;
15. Shërbimi i ortopedisë;
16. Shërbimi i okulistikës;
17. Shërbimi i ORL-së;
18. Shërbimi i kirurgjisë oro-maksilo-faciale (OMF);
19. Shërbimi i urgjencës kirurgjikale;



20. Shërbimi i kirurgjisë digjестive;
21. Shërbimi i urologjisë;
22. Shërbimi i djegie-plastikës;
23. Shërbimi i neurologjisë;
24. Shërbimi neurovaskular (stroke dhe poststroke);
25. Shërbimi i neurokirurgjisë;
26. Shërbimi i onkologjisë;
27. Shërbimi i sëmundjeve infektive;
28. Shërbimi i pediatriisë së specialiteteve;
29. Shërbimi i onkohematologjisë pediatrike;
30. Shërbimi i pediatriisë infektive;
31. Shërbimi i urgjencës dhe i pediatriisë së përgjithshme;
32. Shërbimi i kirurgjisë infantile;
33. Shërbimi i reanimacionit pediatrik;
34. Shërbimi i laboratorëve (klinikë-biokimikë, mikrobiologjikë, imunologjikë, anatomisë patologjike, gjenetikë mjekësore, laborator i mjekësisë nukleare);
35. Shërbimi i imazherisë dhe i mjekësisë nukleare;
36. Shërbimi i fizioterapisë;
37. Shërbimi i statistikave;
38. Shërbimi i pneumologjisë;
39. Kirurgjia torakale;
40. Shërbimi i ftiziatrisë;
41. Shërbimi i gjinekologjisë;
42. Shërbimi i obstetrikës;
43. Shërbimi i patologjisë së barrës;
44. Shërbimi i neonatologjisë;
45. Shërbimi i farmacisë;
46. Shërbimi i konsultave të specializuara ambulatorë;
47. Shërbimi i toksikologjisë klinike;
48. Shërbimi i psikiatriisë (QSUT);
49. Kontrolli i infeksioneve spitalore;
50. Shërbimi i urgjencës ambulatorë.
51. Banka e gjakut.

## II. QENDRA SPITALORE RAJONALE

Shërbimet e qendrës spitalore rajonale përcaktohen rast pas rasti në urdhrin e ministrit për ngritjen e qendrës spitalore rajonale.

## III. SPITALET NË NIVEL QARKU (SPITALET RAJONALE)

Spitalet publike të përgjithshme në nivel qarku ofrojnë:

1. Shërbimin e urgjencës;
2. Shërbimin e mjekësisë së përgjithshme;
3. Shërbimin e kirurgjisë së përgjithshme, ortopedi-traumatologjisë, urologjisë, ORL, okulistikës, angiologjisë, max-facial;
4. Shërbimin e obstetrikë-gjinekologjisë;
5. Shërbimin e neonatologjisë;
6. Shërbimin e pediatriisë;
7. Shërbimin e radiologjisë;
8. Shërbimin e fizioterapisë;
9. Shërbimin e anatomisë dhe histologjisë patologjike;
10. Shërbimin e laboratorëve kliniko-biokimikë të mikrobiologjisë;
11. Shërbimin e anestezi-reanimacionit;
12. Shërbimin e farmacisë;
13. Shërbimin e onkologjisë (kimioterapisë, kujdesi paljativ);
14. Kontrollin e infeksioneve spitalore;
15. Shërbimin psikosocial;
16. Shërbimin e konsultave të specializuara (poliklinika e specialiteteve);
17. Bankën e gjakut.

## IV. SPITALET NË NIVEL BASHKIE

Spitalet publike të përgjithshme në nivel bashkie ofrojnë:

1. Shërbimin e urgjencës;
2. Shërbimin e mjekësisë së përgjithshme;
3. Shërbimin e kirurgjisë së përgjithshme;
4. Shërbimin e pediatriisë dhe obstetrikë-gjinekologjisë, neonatologji;
5. Shërbimin e radiologjisë;
6. Shërbimin e laboratorëve kliniko-biokimikë të mikrobiologjisë;
7. Shërbimin e anestezi-reanimacionit;
8. Shërbimin e farmacisë;
9. Shërbimin ambulator të specializuar;
10. Bankën e gjakut.

## V. SPITALET DITORE

1. Ndihmë e parë mjekësore për trajtim dhe kurim brenda 24 orëve.



SHTOJCA NR. 2  
BUXHETI I SHËRBIMIT SPITALOR 2023

Institucionet	Buxheti në 000 lek sipas artikujve						Total
	Art. 600	Art. 601	Art. 602	Art. 602 PPP laboratorë	Art. 604	Rezervë	
Berat	322 000	53 700	170 000	56 700			602 400
Bulqizë	88 700	14 800	30 000	0			133 500
Delvinë	39 000	6 500	7 000	0			52 500
Devoll	57 000	9 480	12 000	0			78 480
Dibër	280 000	46 750	125 000	28 600			480 350
Elbasan	496 400	82 600	235 000	80 100			894 100
Fier	418 050	69 500	210 000	110 000			807 550
Gramsh	140 000	23 000	32 000	0			195 000
Gjirokastër	239 000	39 500	110 000	32 100			420 600
Has	49 000	8 150	15 000	0			72 150
Kavajë	129 000	21 500	32 000	0			182 500
Kolonjë	89 000	14 700	20 000	0			123 700
Korçë	464 700	77 400	270 000	77 300			889 400
Krujë	136 700	22 500	30 000	0			189 200
Kuçovë	72 200	12 000	18 000	0			102 200
Kukës	291 200	48 200	120 000	30 000			489 400
Kurbini	95 300	15 900	37 000	0			148 200
Lezhë	291 900	48 500	140 000	52 900			533 300
Librazhd	170 500	28 100	53 000	0			251 600
Lushnjë	246 300	41 000	105 000	44 900			437 200
Malësi e Madhe	25 000	4 150	6 500	0			35,650
Mallakastër	47 500	7 900	13 000	0			68 400
Mat	146 000	24 300	35 000	0			205 300
Mirditë	116 900	19 500	29 000	0			165 400
Peqin	41 400	6 900	7 500	0			55 800
Përmet	90 000	14 950	35 000	0			139 950
Pogradec	182 900	30 500	80 000	0			293 400
Pukë	105 700	17 600	38 000	0			161 300
Sarandë	171 400	28 500	110 000	32 700			342 600
Skrapar	87 600	14 550	17 000	0			119 150
Shkodër	597 000	99 650	250 000	64 600			1 011 250
Tepelenë	100 000	16 400	16 000	0			132 400
QSUT	2 730 000	425 000	3 200 000	763 000			7 118 000
SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë”	324 000	54 000	250 000	21 300			649 300
SUOGJ “Koço Gliozheni”	269 100	44 900	260 000	22 000			596 000
SU “Shefqet Ndroqi”	415 700	68 280	350 000	54 200			888 180
SU Trauma	154 200	25 600	230 000	48 800			458 600
Tropojë	121 000	20 000	35 000	0			176 000
Vlorë	446 600	74 200	320 000	55 000			895 800
“Memorial” Fier				0	950,000		950 000
Durrës				72 700	1 090 000		1 162 700
Paketat e shërbimeve					3 135 920		3 135 920
Transferta për individët (mjekë specialistë)					50 000		50 000
Trajtime me VKM				0	30 000		30 000
Pagesat e shërbimeve PPP					2 625 000		2 625 000
Rezervë				53 100		1 118 470	1 171 570
<b>TOTAL</b>	<b>10 287 950</b>	<b>1 680 660</b>	<b>7 053 000</b>	<b>1 700 000</b>	<b>7 880 920</b>	<b>1 118 470</b>	<b>29 721 000</b>



SHTOJCA NR. 3  
LISTA E INSTITUCIONEVE, QË NUK DO  
TË FINANCOHEN NGA FONDI I  
SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË  
KUJDESIT SHËNDETËSOR

1. Spitali psikiatrik Vlorë;
2. Spitali psikiatrik Elbasan;
3. Shërbimet e shëndetit mendor në rrethe;
4. Shërbimi i psikiatrisë Shkodër;
5. Qendra Kombëtare e Ri aftësimit, Mirërritjes dhe Zhvillimit të Fëmijëve;
6. Shërbimi Kombëtar i Transfuzionit;
7. Qendra Kombëtare Biomjekësore.

**VENDIM**  
**Nr. 26, datë 27.1.2023**

**PËR BAZËN E TË DHËNAVE TË  
PLATFORMËS “ME TY PËR  
SHQIPËRINË QË DUAM”, RREGULLAT  
E DETAJUARA PËR SEKSIONET E SAJ,  
TË DHËNAT PARËSORE E DYTËSORE,  
DHËNËSIT E INFORMACIONIT,  
NDËRVEPRIMIN ME BAZAT E TJERA  
TË TË DHËNAVE, SISTEMET  
ELEKTRONIKE DHE PROTOKOLLET E  
INSTITUCIONEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 16, pika 4, dhe 22, pikat 3 e 4, të ligjit nr. 107/2021, “Për bashkëqeverisjen”, dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Ky vendim ka si objekt përcaktimin e rregullave për:

a) funksionimin e bazës së të dhënave të platformës “Me ty për Shqipërinë që duam”, në vijim “Platforma”, seksioneve të saj, së bashku me elementet përkatëse, si: të dhënat parësore e dytësore, dhënësit e informacionit, si dhe për ndërveprimin me bazat e tjera të të dhënave;

b) procedurën dhe metodologjinë e ndërveprimit mes sistemeve elektronike dhe protokolleve të institucioneve për kalimin automatik në

platformë të çështjeve të parashikuara në ligjin nr. 107/2021, “Për bashkëqeverisjen”, në vijim “ligji”, si dhe për monitorimin e trajtimit të shkresave të subjekteve private, drejtuar institucioneve të administratës shtetërore.

2. Institucioni administrues i bazës së të dhënave të “Platformës” është Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje, në vijim “Agjencia”.

3. Baza e të dhënave të “Platformës” është e organizuar në pjesë, në vijim të quajtura seksione, të cilat pasqyrojnë seksionet e parashikuara në kreun VI të ligjit. Në rast të miratimit të seksioneve të reja të “Platformës” nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me pikën 4, të nenit 16, të ligjit, ky ndryshim pasqyrohet në bazën e të dhënave.

4. Baza e të dhënave të “Platformës”, sipas seksioneve përkatëse, përmban të dhëna për ankesat dhe kërkesat e subjekteve dhe për ecurinë e përfundimit e shqyrtimit të tyre (ankesave/kërkesave). Këto të dhëna përftohen nga Agjencia gjatë zbatimit të procedurave të parashikuara në ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij.

5. Dhënës të informacionit janë subjektet ankuese dhe kërkuese në seksionet e “Platformës”, si dhe koordinatorët e punonjësit e Agjencisë për të dhënat, të cilat mbledhen dhe administrohen prej tyre përmes protokolleve elektronike ose shkresore të institucioneve qendrore dhe degëve territoriale të tyre.

**II. SEKSIONET, TË DHËNAT PARËSORE,  
DYTËSORE, AKSESIMI DHE NDËRVEPRI-  
MI ME BAZAT E TJERA**

1. Të dhëna parësore dhe dytësore të bazës së të dhënave, sipas seksioneve, janë, si më poshtë vijon:

a) Të dhënat parësore të seksioneve “Ankesa ime” dhe “Biznesi im”, ku përfshihen:

i. numri unik i ankesës/kërkesës;

ii. organi administrativ në adresë të të cilit drejtohet ankesa/kërkesa;

iii. natyra e ankesës/kërkesës, sipas kategorizimit të kryer nga ankuesi në “Platformë”, bazuar në shkronjat “a”, “b” ose/dhe “c”, të nenit 24, të ligjit;

iv. objekti konkret i ankesës/kërkesës dhe përshkrimi i saj sipas ankuesit/kërkuesit;

v. dokumentet bashkëlidhur saj, nëse ka të tilla;

vi. data e paraqitjes së ankesës/kërkesës;

vii. punonjësi ose koordinatori i Agjencisë, që ndjek trajtimin e kërkesës/ankesës;

viii. natyra e kërkesës/ankesës sipas vlerësimit të punonjësit ose koordinatorit të Agjencisë;





ix. struktura dhe nëpunësi përgjegjës për ndjekjen e çështjes pranë organit administrativ;

x. data e delegimit të struktura dhe nëpunësi përgjegjës i organit administrativ;

xi. etapa e trajtimit dhe afati përkatës;

xii. përgjigjja ose akti i nxjerrë nga organi administrativ, në përfundim të shqyrtimit;

xiii. koha e përfundimit të shqyrtimit;

xiv. njoftimi i Agjencisë drejtuar ankuesit dhe/ose kërkuesit për përfundimin e shqyrtimit, i nënshkruar elektronikisht nga koordinatori ose punonjësi që ka trajtuar çështjen, në rastin kur përgjigjja jepet përmes platformës, ose si skanim i shkresës në *hard copy* kur denoncimi ka ardhur në këtë formë (*hard copy*);

xv. shënime të koordinatorit ose punonjësit të Agjencisë për çështjen, nëse ka të tilla;

xvi. të dhëna të kontaktit: numri i telefonit dhe/ose adresa e *e-mail*-it të ankuesit/kërkuesit.

b) Të dhënat parësore të seksionit “Denonco korrupsionin”, ku përfshihen:

i. numri unik i denoncimit;

ii. organi administrativ i referuar në denoncim;

iii. nëpunësi/t e organit administrativ ndaj të cilëve drejtohet denoncimi;

iv. objekti konkret i denoncimit dhe përshkrimi i tij sipas denoncuesit;

v. dokumentet bashkëlidhur denoncimit, si fakte ose prova që vërtetojnë denoncimin;

vi. data e paraqitjes së denoncimit;

vii. koordinatori ose punonjësi i Agjencisë që ka administruar denoncimin;

viii. vlerësimi paraprak formal i koordinatorit ose punonjësit të Agjencisë;

ix. data e dërgimit të denoncimit pranë Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit;

x. njoftimi i Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit drejtuar Agjencisë për ecurinë e denoncimit dhe nivelin e informacionit që mund të publikohet për çështjen;

xi. njoftimi i Agjencisë drejtuar denoncuesit mbi ecurinë e denoncimit, i nënshkruar elektronikisht nga koordinatori ose punonjësi i Agjencisë, kur përgjigjja jepet përmes platformës, ose si skanim i shkresës në *hard copy* kur denoncimi ka ardhur në këtë formë (*hard copy*);

xii. shënime të koordinatorit ose punonjësit të Agjencisë për çështjen, nëse ka të tilla;

xiii. të dhëna të kontaktit: numri i telefonit dhe/ose adresa e *e-mail*-it të ankuesit/kërkuesit.

c) Të dhënat parësore të seksioneve “Nisma ime” dhe “Fjala ime”, ku përfshihen:

i. numri unik i propozimit/opinionit;

ii. organi administrativ (ministra ose institucioni) që mbulon fushën për të cilën paraqitet propozimi/opinionit;

iii. objekti dhe përshkrimi i propozimit/opinionit;

iv. dokumentet bashkëlidhur tij, nëse ka të tilla;

v. data e paraqitjes së propozimit/opinionit;

vi. punonjësi ose koordinatori i Agjencisë, që ndjek çështjen;

vii. data e dërgimit tek organi administrativ kompetent;

viii. punonjësi, drejtorja ose titullari i institucionit që ndjek çështjen;

ix. përgjigjja e organit administrativ për përputhshmërinë me programin qeverisës, realizueshmërinë e propozimit dhe, nëse është rasti, hapat e ndërmarrë;

x. qëndrimi/vlerësimi i Agjencisë mbi çështjen;

xi. njoftimi i Agjencisë drejtuar propozuesit për përfundimin e shqyrtimit, rezultatet e tij dhe, nëse është rasti, hapat që do të ndërmerren për realizimin e tij, i nënshkruar elektronikisht nga koordinatori ose punonjësi i Agjencisë që ka trajtuar çështjen;

xii. shënime të punonjësit ose koordinatorit të Agjencisë për çështjen, nëse ka të tilla;

xiii. të dhëna të kontaktit: numri i telefonit dhe/ose adresa e *e-mail*-it të subjektit që ka paraqitur propozimin/opinionin.

ç) Të dhënat parësore të seksionit “Interpelanca ime”, ku përfshihen:

i. numri unik i kërkesës;

ii. organi administrativ (ministra ose institucioni) për të cilin është paraqitur kërkesa për “interpelancë”;

iii. përshkrimi i çështjes/problematikës sipas kërkuesve;

iv. dokumentet bashkëlidhur tij, nëse ka të tilla;

v. data e paraqitjes së kërkesës;

vi. punonjësi ose koordinatori i Agjencisë, që ndjek çështjen;

vii. data e dërgimit tek organi administrativ kompetent;

viii. përgjigjja e organit administrativ drejtuar Agjencisë për kalendarin e “interpelancës”;

ix. njoftimi i Agjencisë drejtuar kërkuesve për kalendarin e “interpelancës”;



x. data/t e “interpelancës”;  
xi. shënime të koordinatorit ose punonjësit të Agjencisë për angazhimet e marra gjatë interpelancës;

xii. raportimet periodike të organit publik ndaj agjencisë për ecurinë e angazhimeve deri në realizimin përfundimtar të kërkesës;

xiii. njoftimet e Agjencisë ndaj kërkuesve për çështjen e nënshkruar elektronikisht nga koordinatori ose punonjësi i Agjencisë që ka trajtuar çështjen;

xiv. të dhëna të kontaktit: numri i telefonit dhe/ose adresa e *e-mail-it* të kërkuesit.

d) Të dhënat parësore të seksionit “Shkolla ime”, ku përfshihen:

i. numri unik i kërkesës;

ii. organi administrativ (ministra) për të cilin është paraqitur kërkesa ose projekti “Shkolla ime”;

iii. përshkrimi i çështjes/projektit sipas kërkuesve;

iv. dokumentet bashkëlidhur tij, nëse ka të tilla;

v. data e paraqitjes së kërkesës/projektit;

vi. koordinatori ose punonjësi i Agjencisë që ndjek çështjen;

vii. data e dërgimit tek organi administrativ kompetent;

viii. përgjigjja e organit administrativ drejtuar Agjencisë për kërkesën ose projektin “Shkolla ime”;

ix. njoftimi i Agjencisë drejtuar kërkuesve për hapat e ndërmarrë për kërkesën ose projektin “Shkolla ime”;

x. data/t e njoftimit për realizimin e kërkesës ose projektit “Shkolla ime”;

xi. shënime të punonjësit ose koordinatorit të Agjencisë për angazhimet e marra gjatë realizimit të projektit;

xii. raportimet periodike të ministrisë ndaj Agjencisë për ecurinë e angazhimeve deri në realizimin përfundimtar të kërkesës/projektit;

xiii. njoftimet e Agjencisë ndaj kërkuesve për çështjen e nënshkruar elektronikisht nga koordinatori ose punonjësi i Agjencisë që ka trajtuar çështjen;

xiv. të dhëna të kontaktit: numri i telefonit dhe/ose adresa e *e-mail-it* të kërkuesit.

dh) Të dhënat parësore të seksionit “Nota ime”, ku përfshihen:

dh/1) Të dhëna për shërbimet *on-line*, si:

i. emërtimi i shërbimit publik;

ii. organi administrativ që ofron shërbimin;

iii. data e ofrimit të shërbimit;

iv. “Nota” për vlerësimin e cilësisë së shërbimit të dhënë;

v. numri i vlerësimeve të marra për shërbimin gjatë muajit sipas kalendarit;

vi. koha e shpenzuar për shërbimin e ofruar dhe të vlerësuar;

vii. shënime, nëse ka, për cilësinë e shërbimit të ofruar;

viii. “Nota mesatare”, nisur nga mesatarja e vlerësimeve për muajin, e cila publikohet në mënyrë periodike;

ix. koeficienti për vlerësimin e institucionit publik që ka ofruar shërbimin;

x. të dhëna të kontaktit: numri i telefonit dhe/ose adresa e *e-mail-it* të qytetarit që paraqet notën për shërbimin.

dh/2) Të dhëna për shërbimet që nuk ofrohen *on-line*, si:

i. emërtimi i shërbimit publik;

ii. organi administrativ që ofron shërbimin;

iii. data e kërkesës/dhënies së shërbimit;

iv. “Nota” për cilësinë e shërbimit të ofruar në sportel;

v. koha e shpenzuar në sportel për shërbimin e ofruar;

vi. shënime, nëse ka, për cilësinë e shërbimit të ofruar;

vii. numri i vlerësimeve të marra për shërbimin gjatë muajit sipas kalendarit;

viii. “Nota mesatare”, nisur nga mesatarja e vlerësimeve për muajin, e cila publikohet në mënyrë periodike;

ix. koeficienti për vlerësimin e strukturave ofruese të shërbimeve të institucionit publik;

x. të dhëna të kontaktit: numri i telefonit dhe/ose adresa e *e-mail-it* të subjektit që paraqet notën për shërbimin.

e) Të dhënat parësore të seksionit “Dua të kontribuoj”, ku përfshihen:

i. numri unik i kërkesës për kontribut;

ii. organi administrativ (ministra ose institucioni) që mbulon fushën për të cilën paraqitet propozimi i kontributit/kërkesa;

iii. objekti dhe përshkrimi i kontributit/kërkesës;

iv. dokumentet bashkëlidhur tij, nëse ka të tilla;

v. data e paraqitjes së propozimit të kontributit /kërkesës;



vi. punonjësi ose koordinatori i Agjencisë, që ndjek çështjen;

vii. data e dërgimit tek organi administrativ kompetent;

viii. punonjësi, drejtorja ose titullari i institucionit që ndjek çështjen;

ix. përgjigjja e organit administrativ për rëndësinë e propozimit të kontributit të paraqitur dhe mundësitë për përfshirjen e tij në institucion dhe, nëse është rasti, hapat që do të ndërmerren deri në realizimin e tij;

x. qëndrimi/vlerësimi i Agjencisë për çështjen;

xi. njoftimi i Agjencisë drejtuar propozuesit për përfundimin e shqyrtimit të kërkesës për kontribut, rezultatet e tij dhe, nëse është rasti, hapat që do të ndërmerren për realizimin e tij, i nënshkruar elektronikisht nga koordinatori ose punonjësi i Agjencisë që ka trajtuar çështjen;

xii. shënime të koordinatorit ose punonjësit të Agjencisë për çështjen, nëse ka të tilla;

xiii. të dhëna të kontaktit: numri i telefonit dhe/ose adresa e *e-mail*-it të kërkuarit.

ë) Të dhënat parësore të seksionit “Kuvendimi ynë”, ku përfshihen:

i. organi administrativ (ministra ose institucioni) që mbulon fushën për të cilën paraqitet propozimi/opinionit;

ii. përshkrimi i propozimit/opinionit;

iii. data e paraqitjes së propozimit/opinionit;

iv. punonjësi ose koordinatori i Agjencisë, që ndjek, grumbullon e trajton opinionet dhe i grupon ato si rekomandime;

v. vlerësimi i Agjencisë për propozimet e marra;

vi. data e dërgimit të grup-opinioneve/rekomandimeve tek organi administrativ kompetent;

vii. punonjësi, titullari ose drejtorja e institucionit që ndjek çështjen;

viii. përgjigjja e organit administrativ për rekomandimet e paraqitura dhe masa e realizueshmërisë së tyre;

ix. njoftimi/publikimi i Agjencisë për rekomandimet/grup-opinionet e dala si rezultat i temës së propozuar për kuvendim;

x. të dhëna të kontaktit: numri i telefonit dhe/ose adresa e *e-mail*-it të propozuesit.

f) Të dhënat dytësore të bazës së të dhënave, ku përfshihen:

f/1) Të dhënat dytësore për individin (qytetarin), si:

i. numri personal i identifikimit (ID) i subjektit që përdor “Platformën, në cilësinë e kërkuarit, ankuesit, denoncuesit, apo cilësimi tjetër i tij sipas qëllimit të secilit seksion të Platformës”;

ii. gjenealitetet e tij, në rastin e qytetarëve;

iii. adresa/të dhënat e vendbanimit brenda dhe jashtë vendit;

iv. gjinia e personit;

v. faktin e të qenit përfaqësues i një komuniteti, nëse ai është identifikuar si i tillë.

f/2) Të dhënat dytësore për personin juridik privat, shoqëri tregtare (biznesin), si:

i. emri tregtar i regjistruar në QKB;

ii. NUIS-i / NIPT-i;

iii. emri i administratorit;

iv. forma juridike (PF, SHPK, SHA);

v. adresa/të dhënat e vendbanimit brenda dhe jashtë vendit.

2. Baza e të dhënave të “Platformës” ndërvepron me:

a) Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, administruar nga institucioni përgjegjës, i përcaktuar sipas parashikimeve të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, për të dhënat që lidhen me gjenealitetet dhe numrin personal të identifikimit të individit që përdor “Platformën” (në cilësinë e kërkuarit, ankuesit, denoncuesit e të tjera, sipas qëllimit të secilit seksion të “Platformës”);

b) Regjistrin Tregtar, administruar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, për të dhënat që lidhen me emrin dhe numrin NUIS të subjekteve tregtare që përdorin “Platformën” (në cilësinë e kërkuarit, ankuesit, denoncuesit e të tjerat, sipas qëllimit të secilit seksion të “Platformës”);

c) Regjistrin Kombëtar të Adresave, të administruar nga institucioni përgjegjës, i përcaktuar sipas parashikimeve të ligjit nr.9270, datë 29.7.2004, “Për sistemin e adresave”, i ndryshuar, për të dhënat që lidhen me adresën ose vendbanimin e subjekteve që përdorin “Platformën” (në cilësinë e kërkuarit, ankuesit, denoncuesit apo në cilësimin tjetër të tij, sipas qëllimit të secilit seksion të “Platformës”).

3. Nivelet e aksesimit në bazën e të dhënave të “Platformës”, janë:

a) Agjencia ka akses të plotë dhe të pakufizuar në informacionin që prodhohet, regjistrohet dhe administrohet në bazën e të dhënave, në rolet:

i. lexues;



- ii. përdorues;
- iii. administrator;
- iv. auditues;
- v. prodhues i statistikave.

b) Individët dhe të gjitha subjektet, që aksesojnë “Platformën” në cilësinë e kërkesit, ankuesit, denoncuesit apo cilësimi tjetër të tyre, sipas qëllimit të secilit seksion të “Platformës”, kanë vetëm nivelin e aksesimit “përdorues”.

c) Përfaqësuesit e institucioneve kanë vetëm nivelin e aksesimit “lexues” dhe vetëm për çështjet që lidhen me ankesat/kërkesat drejtuar tyre.

Çdo veprim në bazën e të dhënave të Platformës lidhur me aksesin, ndryshimin, korrigjimin, përhapjen e të dhënave duhet të lërë gjurmë, me qëllim garantimin e sigurisë dhe konfidencialitetit.

### III. PROCEDURA DHE METODOLOGJIA E NDËRVEPRIMIT MES SISTEMEVE ELEKTRONIKE DHE PROTOKOLLEVE TË INSTITUCIONEVE

1. Në përputhje me pikat 3 dhe 4, të nenit 22, të ligjit, ndërveprimi i sistemeve elektronike dhe protokolleve të institucioneve me “Platformën” kryhet për:

a) kalimin automatik në platformë të çështjeve të parashikuara në ligj;

b) monitorimin e trajtimit të shkresave, kërkesave dhe ankesave të subjekteve private drejtuar institucioneve të administratës shtetërore.

2. Në funksion të kalimit automatik të çështjeve në të gjitha faqet *on-line* të institucioneve shtetërore të administratës shtetërore, rubrikat e ankesave mbi veprimtarinë e institucionit lidhen drejtpërdrejt me “Platformën”, në mënyrë që ankesa të përcillet në të.

3. Në të gjitha institucionet shtetërore, ku trajtimi i shkresave të qytetarëve dhe biznesit kryhet nëpërmjet sistemeve/protokolleve elektronike, koordinatorët dhe punonjësit e Agjencisë kanë akses të drejtpërdrejtë në këto sisteme/protokolle, si dhe në dokumentacionin fizik për verifikimin e përputhshmërisë së tij me informacionin e ngarkuar në sistem.

4. Në rastin e institucioneve qendrore, të cilat përdorin protokollin elektronik EDRMS (*Electronic Document Record Management System*), ankesat/ kërkesat e qytetarëve dhe subjekteve kalojnë në mënyrë automatike në “Platformën” e

bashkëqeverisjes për trajtim të mëtejshëm, sipas parashikimeve të ligjit.

5. Për rastet e ankesave/kërkesave të paraqitura në mënyrë shkresore nga subjektet, pranë institucioneve qendrore caktohet një punonjës për hedhjen brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga administrimi tyre në “Platformën” e bashkëqeverisjes.

6. Në rast se pranë institucioneve qendrore paraqiten ankesa/kërkesa, shqyrtimi i të cilave, pavarësisht adresimit të kryer nga ankuesi, janë në kompetencë të Agjencisë, në përputhje me ligjin nr. 17/2021, ato i përcillen në rrugë zyrtare kësaj të fundit për ndjekje dhe kompetencë.

7. Në përputhje me përcaktimet e neneve 21, pika 4, dhe 35, pika 5, shkronja “a”, të ligjit, në platformë nuk trajtohen ankesa ose denoncime anonime.

8. Denoncimet e ardhura në rrugë shkresore, që i drejtohen Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit, nuk trajtohen nga Agjencia, por i përcillen për ndjekje dhe kompetencë strukturës përkatëse pranë Ministrisë së Drejtësisë.

9. Në kuptim të shkronjës “c”, të pikës 4, të kreut II, të këtij vendimi, akses në rolin e lexuesit në ankesat dhe kërkesat e ardhura nga protokollit shkresor i institucionit, të regjistruara në “Platformën” e bashkëqeverisjes, përveç punonjësve të ngarkuar me ndjekjen e tyre, kanë dhe titullari i institucionit, drejtori i kabinetit dhe sekretari i përgjithshëm.

### IV. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Agjencia, në bashkëpunim me AKSHI-n, bashkërendojnë punën për zhvillimet teknike të nevojshme, që të mundësohen funksionimi i bazës së të dhënave dhe ndërveprimi i sistemeve, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje ndërvepron dhe bashkëpunon me Agjencinë e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) për ndjekjen e ecurisë së trajtimit të ankesave dhe kërkesave të administruara nga Agjencia përmes “Platformës” së bashkëqeverisjes [www.shqipëriaqeduam.al](http://www.shqipëriaqeduam.al), si dhe monitorimin e shërbimeve *on-line* sipas përcaktimeve në ligjin nr. 107/2021, “Për bashkëqeverisjen”, dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij.

3. Ngarkohen Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe institucionet që ndërveprojnë



në “Platformën” e bashkëqeverisjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
**Belinda Balluku**

**VENDIM**  
**Nr. 27, datë 27.1.2023**

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË ROSKOVEC, PËR NJËSINË ADMINISTRATIVE KURJAN, TË PASURISË ME NUMËR 213, ZONA KADASTRALE 3805, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 770, DATË 24.9.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, shkronja “ç”, dhe 5 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të Bashkisë Roskovec, për Njësinë Administrative Kurjan, të pasurisë me numër 213, zona kadastrale 3805, sipas formularit dhe planit të rivevimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi, me qëllim për t’u përdorur në fushën e zhvillimit ekonomik.

2. Pasuria e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi i shtohet listës së inventarit që i bashkëlidhet vendimit nr. 770, datë 24.9.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Roskovec, të qarkut të Fierit”.

3. Bashkisë Roskovec i ndalohet ndryshimi i destinacionit dhe tjetërsimi i pasurisë së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Bashkia Roskovec dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
**Belinda Balluku**

**1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE**  
**(Per inventarizimin e pronave te veçanta)**

Identifikoi: <b>Eneida Hoxha, Eldison Kocaqi (Topograf)</b> (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)										
Bashkia: ROSKOVEC, Njësia Administrative Kurjan										
Fusha e përdorimit të Pronës: Zhvillim Ekonomik										
Supervizori: <b>Agur Shabanaj (I.M.M.Tokës)</b> (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)										
Aprovi: <b>Majlinda Bufi (Kryetari i Bashkisë)</b> (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel, firma, vula)										
Nr. Rend.	A			B			C			
	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m <sup>2</sup> )	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m <sup>2</sup> )	Funksioni për të cilin përdoret Prona	Institucioni / Enti me përgjegjësi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
	3805 233-D	213	Truall	Truall Fshati Vlosh	8970		Zhvillim Ekonomik	Bashkia Roskovec	Bashkia Roskovec	







**VENDIM**  
**Nr. 28, datë 27.1.2023**

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE**  
**TË HOLLËSISHME TË PËRDITËSIMIT**  
**TË LISTAVE TË PRONAVE**  
**SHTETËRORE DHE RREGULLAVE PËR**  
**BASHKËPUNIMIN NDËRMJET**  
**INSTITUCIONEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 39, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Ky vendim ka për qëllim:

a) përcaktimin e procedurave të përditësimit të plotë apo të pjesshëm të pronave të paluajtshme shtetërore, të inventarizuara ose jo, në pronësi ose përdorim apo përgjegjësi administrimi të institucioneve qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore;

b) përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të veprimtarisë midis institucioneve shtetërore apo njësive të vetëqeverisjes vendore dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, gjatë procesit të përditësimit.

2. Në këtë vendim, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) **“Përditësim”**, procesi i saktësimit të listës dhe/ose të dhënave të pronës së inventarizuar apo që do të inventarizohet, sipas gjendjes reale nga konstatimi në terren dhe gjendjes juridike në raport me titujt e pronësisë private, të lëshuar sipas legjislacionit në fuqi;

b) **“Përditësim i plotë”**, procesi që kryhet për të gjitha pronat e inventarizuara apo të transferuara në favor të institucioneve shtetërore/njësive të vetëqeverisjes vendore;

c) **“Përditësim i pjesshëm”**, procesi i rishikimit për një ose më shumë prona të listës së inventarit të pronave shtetërore të miratuara për institucionet qendrore dhe/ose të transferuara në pronësi ose në përdorim të njësive të vetëqeverisjes vendore, përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 20/2020,

“Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”;

ç) **“Strukturë e posaçme”**, struktura e cila ka për objekt të veprimtarisë së saj inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në regjistrimin e pronave në regjistrin kadastral publik të pasurive të paluajtshme dhe pajisjen me certifikatë pronësie, për çdo pasuri;

d) **“Subjekt i interesuar”**, subjekti që përmbush kushtet e përcaktuara në shkronjën “c”, të pikës 1, të nenit 39, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”;

dh) **“Formular i përditësimit të pronës”**, dokumenti në të cilin pasqyrohen të dhënat e pronave që do të përditësohen, elemente të të cilit janë të dhënat kadastrale të pronës, funksioni për të cilën përdoret prona, enti me përgjegjësi administrative, enti përdorues i pronës, fakti i inventarizimit apo jo me vendim të Këshillit të Ministrave, si dhe çdo specifikim tjetër i nevojshëm që ndodhet në ASHK.

3. Pronat që inventarizohen dhe transferohen rishtazi, në çdo rast, i nënshtrohen përditësimit, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në këtë vendim.

**II. PROCEDURAT E HOLLËSISHME,**  
**DOKUMENTACIONI I PËRDITËSIMIT DHE**  
**RREGULLAT PËR BASHKËPUNIMIN**  
**NDËRMJET INSTITUCIONEVE**

1. Procedurat e përditësimit të listës ose të dhënave të pronës shtetërore të inventarizuar kryhen, kur konstatohet, se:

a) për një pronë apo një pjesë të saj ekziston titull pronësie i të tretëve, i miratuar, sipas legjislacionit të posaçëm;

b) gjatë inventarizimit nuk janë pasqyruar të drejtat reale të të tretëve, që rëndojnë mbi pronën;

c) gjendja reale (faktike) e pronës, ku përfshihen sipërfaqja, pozicioni, konfigurimi dhe karakteristikat e tjera fizike, nuk përputhet me dokumentacionin e inventarizimit;

ç) prona e inventarizuar është objekt i proceseve kalimtare të pronësisë, sipas ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë, në Republikën e Shqipërisë”.

2. Në rastet kur përditësimi kryhet kryesisht nga ASHK-ja gjatë procedurave të regjistrimit fillestar ose përmirësimit apo përditësimit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme të zonës kadastrale, në



përfundim të këtij procesi njoftohet institucioni qendror shtetëror apo njësi e vetëqeverisjes vendore për të dhënat e përditësuara në regjistrin kadastral. Me marrjen e njoftimit nga ana e këtyre institucioneve vijohet me përditësimin e listës shtetërore sipas këtyre të dhënave.

3. Institucioni shtetëror qendror/njësia e vetëqeverisjes vendore për kryerjen e procedurës së përditësimit vepron, si më poshtë vijon:

a) Struktura e posaçme pranë institucionit qendror apo njësisë së vetëqeverisjes vendore, me asistencën apo pjesëmarrjen e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, identifikon listën/pronën që do t'i nënshtrohet përditësimit dhe grumbullon dokumentacionin tekniko-ligjor, arkivor, që disponon për të.

b) Kryen evidentimin faktik në terren të pronës, për rastin e parashikuar në shkronjën “c”, të pikës 1, të kreut II, të këtij vendimi.

c) Administron nga ASHK-ja informacion për gjendjen juridike të pronës, në përputhje me ligjin nr. 111/2018, “Për kadastrën”, dhe vendimin nr. 389, datë 13.5.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale”, të ndryshuar, përfshirë dhe informacionin për proceset kalimtare të pronësisë, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, dhe harton relacionin përkatës.

ç) Harton planin e rilevimit të pronës sipas modelit dhe në përputhje me standardet teknike të përcaktuara në vendimin nr. 782, datë 7.10.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale”.

d) Harton listën e përditësuar të pronës/pronave, ku janë saktësuar emërtesa, vendndodhja, komponentët dhe destinacioni i përdorimit.

dh) Paraqet për shqyrtim pranë ASHK-së listën e pronave shtetërore të përditësuar, në mënyrë që të procedohet me hartimin e projektvendimit për miratimin e listës përfundimtare të pronave shtetërore nga Këshilli i Ministrave. Lista që paraqitet për shqyrtim shoqërohet nga relacioni i gjendjes juridike dhe plani i rilevimit.

Për pronat që përditësohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, lista e pronave, së bashku me relacionin dhe planin e rilevimit i nënshtrohet

vendimmarrjes nga këshilli bashkiak dhe verifikimit të ligjshmërisë nga prefekti, përpara se të përcillet për shqyrtim pranë ASHK-së.

4. ASHK-ja, pas shqyrtimit të dokumentacionit tekniko-ligjor, harton projektvendimin për miratimin e listës përfundimtare të pronave shtetërore nga Këshilli i Ministrave. Kur konstatohet mospërputhje e dokumentacionit me kriteret e parashikuara në nenin 36, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, ASHK-ja njofton institucionin administrues ose njësinë e vetëqeverisjes vendore për të kryer ndryshimet e nevojshme.

5. Lista e pronave shtetërore që përditësohen shoqërohet nga dokumentacioni i mëposhtëm:

a) formulari i përditësimit të pronës/pronave, sipas modelit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) plani i rilevimit të pronës/pronave që përditësohet/n;

c) informacioni për gjendjen juridike (kartelat kadastrale) të pasurisë/pasurive të paluajtshme që preket/n nga përditësimi, jo më të hershëm se 30 (tridhjetë) ditë.

Për pronat e njërive të vetëqeverisjes vendore krahas dokumentacionit të sipërpërmendur, lista shoqërohet edhe nga vendimi i këshillit bashkiak që miraton përditësimin.

6. Për pronat e paluajtshme shtetërore, që figurojnë në administrim të institucioneve qendrore apo në përdorim/pronësi të njërive të vetëqeverisjes vendore, të regjistruara apo jo në regjistrat kadastralë, por ekziston titull pronësie ndaj të tretëve, i krijuar sipas legjislacionit të posaçëm, veprohet, si më poshtë vijon:

a) Procedurat për përditësimin e listës së pronave shtetërore nisin kryesisht nga institucioni administrues, njësi e vetëqeverisjes vendore, ASHK-ja apo me kërkesë të subjektit të interesuar, atëherë kur konstatohet se titulli i pronësisë private shtrihet tërësisht apo pjesërisht mbi pronë shtetërore.

b) ASHK-ja, pas verifikimit të dokumentacionit të pronësisë, pozicionimit gjeografik të sipërfaqes në favor të subjektit të interesuar, në rastin kur prona shtrihet mbi pasuri në përgjegjësi administrimi të një institucioni qendror, njofton këtë të fundit për fillimin e procedurave të përditësimit të listës së inventarit dhe zbritjen e





sipërfaqes së pasurisë për të cilën ekziston titulli i pronësisë private. Dokumentacioni tekniko-ligjor plotësohet sipas përcaktimeve të këtij kreu. Propozimi për heqjen e përgjegjësisë së administrimit miratohet sipas procedurave të legjislacionit në fuqi për pronat e paluajtshme të shtetit.

c) ASHK-ja, pas verifikimit të dokumentacionit të pronësisë, pozicionimit gjeografik të sipërfaqes në favor të subjektit të interesuar, në rastin kur prona shtrihet mbi pasuri në përdorim/pronësi të njësisë së vetëqeverisjes vendore, njofton këtë të fundit për fillimin e procedurave për përditësimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të transferuara në njësitë e vetëqeverisjes vendore. Dokumentacioni tekniko-ligjor plotësohet sipas përcaktimeve të këtij kreu. Propozimi për revokimin e transferimit të pronësisë bëhet në përputhje me parashikimet e nenit 8/a, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar.

7. Institucionet qendrore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, në përputhje me nenin 44, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, krijojnë strukturat e posaçme të bashkëpunimit me

drejtorinë përkatëse të ASHK-së, të cilat rakordojnë ndërmjet tyre, me qëllim realizimin e procedurave të parashikuara nga neni 37, i ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”. Të dhënat e personave përgjegjës pranë strukturave të institucioneve qendrore dhe atyre të njësisë të vetëqeverisjes vendore i njoftohen Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së.

8. Të gjitha pronat e miratuara, të përditësuara në favor të institucioneve qendrore ose njësisë të vetëqeverisjes vendore, regjistrohen në regjistrin e pasurive të paluajtshme, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave për miratimin e listës së pronave shtetërore, në përputhje me nenin 24, të ligjit nr. 111/2018, “Për Kadastrën”.

### III. DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohen Agjencia Shtetërore e Kadastrës, institucionet qendrore shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
**Belinda Balluku**



1. FORMULARI I PËRDITËSIMIT TË PRONËS

Identifikoi pronën \_\_\_\_\_  
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Institucioni Qendror Shtetëror /Bashkia: \_\_\_\_\_ Supervizoi: \_\_\_\_\_  
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Aprovoi: \_\_\_\_\_  
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)

Nr.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurisë	Lloji i Pasurisë	Emërtesa e pasurisë Adresa	Sip. e pasurisë (m2)	Nga Sip.		Funksioni për të cilin përdoret pronë/ pasuria	Institucioni me përgjegjësi administrative/ pronësi	Institucioni përdorues i pasurisë Statusi juridik i përdorimit	Inventarizuar me VKM	Te dhëna të tjera (Shënime të veçanta)
						Truall (m2)	Ndërtesë (m2)					
<b>TOTAL</b>												

Shënim: Siperfaqja totale do të plotësohet vetëm për pronë me shumë komponente (që perben nga disa pasuri).



**VENDIM**  
**Nr. 29, datë 27.1.2023**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES  
PUBLIK, TË PRONARËVE TË  
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË  
PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI  
“ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE  
KUÇOVË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Zgjerimi i varrezave publike Kuçovë”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Kuçovë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë” dhe “drufrutorë”, me një vlerë të përgjithshme prej 2 374 693 (dy milionë e treqind e shtatëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 2 374 693 (dy milionë e treqind e shtatëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre) lekësh, përballohet nga Bashkia Kuçovë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Bashkia Kuçovë.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Kuçovë.

8. Bashkia Kuçovë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Kuçovë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të aktit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Kuçovë për pasuritë e shpronësuara.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kuçovë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Bashkisë Kuçovë.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Kuçovë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kuçovë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Berat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Belinda Balluku**



LISTA EMËRORE PËRFUNDIMTARE E PRONARËVE PASURI E PALUAJTSHME PRONË PRIVATE E TË CILËVE PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTTT “ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE KUÇOVË”

Nr.	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE					VLËRESIMI PËR SHPRONËSIM					
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshat/qytet	Numri i pasurisë	Zona kadastrale	Lloji i pasurisë	Totale	Sipërfaqja e shpronësimit (m <sup>2</sup> )	ÇMIMI (lek/m <sup>2</sup> )	Vlera (lek)	Vlera e kulturave bujqësore dhe drufutorëve, sipas proces-verbalit të Drejtorisë së Bujqësisë	VLERA TOTALE	Shënime
1	Fitim	Isa	Çela	Polovine	648/7	2179	Are	4000	4000	268	1072000	766 693	1,838,693	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Kuçovë
2	Niko	Dervish	Lazi	Polovine	648/6	2179	Are	2000	2000	268	536 000		536 000	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Kuçovë
<b>TOTALI</b>												<b>2,374,693</b>		

**VENDIM**

Nr. 33, datë 27 1.2023

**PËR MIRATIMIN E BUXHETIT PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE, PËR VITIN 2023**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 189/c, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e buxhetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, për vitin 2023, sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
**Belinda Balluku**

*Tabela nr. 1*

PLANI TË ARDHURA–SHPENZIME, PËR VITIN 2023, PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME E PRONËSISË INDUSTRIALE

000/LEK

Të ardhurat		Shpenzimet	
Të ardhura nga aktiviteti kryesor	135,000	Shpenzime personeli	55,821
Të trashëguara investime dhe projekte në vazhdim	92,769	Shpenzime operative dhe korrente	25,716
Marrëveshja e Madridit	66,000	Transferta korrente e jashtme	90,000
Marrëveshja e Hagës	1,000	Shpenzime kapitale	123,332
Të ardhura nga marrëveshja e shtrirjes me ZEP	100	<b>Totali i shpenzimeve</b>	<b>294,869</b>
		Teprica derdhje në buxhetin e shtetit	0
<b>Totali i të ardhurave</b>	<b>294,869</b>	<b>Totali i shpenzimeve dhe teprica në buxhetin e shtetit</b>	<b>294,869</b>



**VENDIM**  
**Nr. 36, datë 27.1.2023**

**PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE  
FUNKSIONIMIN E SPITALEVE  
RAJONALE, TERCIARE DHE  
QENDRAVE SPITALORE RAJONALE  
PUBLIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 14, të ligjit nr. 55/2022, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Spitalet rajonale terciare dhe qendrat spitalore rajonale krijohen, organizohen dhe funksionojnë, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr. 55/2022, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, dhe në këtë vendim. Hapja e spitaleve, rast pas rasti, bazuar në parashikimet e planit spitalor kombëtar bëhet nga ministri përgjegjës për shëndetësinë.

2. Spitali rajonal, qendra spitalore rajonale dhe spitali terciar e ushtrojnë veprimtarinë e tyre, në përputhje me standardet, protokollat e shërbimeve për trajtimin spitalor dhe udhërrëfyesve, të miratuara nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë.

3. Spitali rajonal është institucioni i kujdesit shëndetësor me shtretër, i përgjithshëm ose i specializuar, që ofron kujdes shëndetësor ndaj popullatës së një qarku të caktuar, sipas sistemit të referimit.

4. Qendra Spitalore Rajonale krijohet kur një spital i përgjithshëm, terciar apo rajonal, administron një ose më shumë spitale të përgjithshme dhe/ose të specializuara dhe/ose ditore, në nivel bashkie ose qarku, me qëllim optimizimin e menaxhimit të burimeve financiare, njerëzore dhe ato kapitale, për ofrimin e një shërbimi spitalor cilësor dhe të aksesueshëm afër vendbanimit.

5. Qendra Spitalore Rajonale menaxhon dhe administron burimet financiare dhe njerëzore, në bazë të nevojave për shërbim spitalor të popullatës që ajo mbulon, sipas udhëzimit të miratuar nga ministri përgjegjës për shëndetësinë.

6. Spitali terciar është ai spital, i cili ofron shërbim mjekësor terciar, procedura diagnostike,

terapeutike, konsulta të specializuara për diagnostikim e trajtim mjekësor me pajisje biomjekësore të teknologjisë së lartë.

7. Spitali mund të ofrojë shërbime të nivelit terciar për një ose më shumë specialitete që përbëjnë një njësi funksionale, të organizuar dhe të aftë për të shërbyer si qendër reference për rajonin përkatës vetëm për këtë shërbim terciar, bazuar në organizimin territorial dhe sistemin e referimit.

8. Bordi drejtues kryesohet nga përfaqësuesi i ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë dhe ka në përbërje:

a) një përfaqësues të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor;

b) një përfaqësues të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor;

c) një përfaqësues nga Shoqatat e Pacientëve;

ç) një përfaqësues nga Komisioni Mjekësor.

9. Përgjegjësitë e veçanta të Bordit përcaktohen në rregulloren e spitalit.

10. Funksionet e Bordit drejtues janë:

a) mbikëqyr dhe kontrollon drejtimin e veprimtarisë së spitalit;

b) miraton rregulloren e brendshme, rregulloret ekonomike, financiare, të auditimit dhe të kontrollit, me propozimin e drejtorit të përgjithshëm të spitalit, sipas rregullores tip, të miratuar nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë;

c) miraton çdo vit raportin vjetor, bilancin, buxhetin vjetor;

ç) miraton përdorimin e të ardhurave dytësore të spitalit, sipas prioriteteve të tij;

d) i propozon për miratim ministrit përgjegjës për shëndetësinë strukturën organizative të spitalit;

dh) miraton indikatorët e performancës së personelit shëndetësor dhe normat e aktivitetit të shërbimit spitalor;

e) miraton kontratën tip të punës për personelin shëndetësor të spitalit, me propozimin e drejtorit të përgjithshëm të spitalit;

ë) harton dhe miraton rregulloren e funksionimit të Bordit;

f) kontrollon zbatimin e normave dhe aktivitetit mjekësor, të përcaktuara nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë, lidhur me shërbimet përkatëse klinike.

11. Drejtori i përgjithshëm emërohet dhe shkarkohet nga ministri përgjegjës për shëndetësinë, sipas legjislacionit në fuqi.



12. Detyrat e drejtorit të përgjithshëm përcaktohen në rregulloren e funksionimit të veprimtarisë së spitalit.

13. Komisioni Mjekësor është një ndër organet drejtuese të spitalit rajonal, qendrës spitalore rajonale dhe spitalit terciar.

14. Komisioni Mjekësor për Qendrën Spitalore Rajonale përbëhet nga drejtuesit e spitaleve, të cilat janë pjesë e Qendrës Spitalore Rajonale dhe drejtuesit e shërbimeve ose përfaqësues të zgjedhur nga vetë shërbimet e këtyre spitaleve.

15. Komisioni Mjekësor për spitalet rajonale dhe terciare përbëhet nga drejtuesit e shërbimeve ose përfaqësues të zgjedhur nga vetë shërbimet e këtyre spitaleve.

16. Funksionet dhe detyrat e Komisionit Mjekësor përcaktohen në rregulloren e spitalit.

17. Financimi i spitaleve bëhet në bazë të legjislacionit në fuqi dhe nga tarifat për shërbime klinike dhe joklinike për pacientë jashtë sistemit të referimit. Tarifat për shërbime klinike dhe joklinike jashtë sistemit të referimit përcaktohen në mekanizmin e sistemit të referimit.

18. Spitalet rajonale terciare dhe Qendra Spitalore Rajonale, për financimin e shërbimeve shëndetësore dhe aktivitetit, lidhin kontratë me Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

19. Spitali zbaton sistemin e referimit, të miratuar nga ministri përgjegjës për shëndetësinë.

20. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor auditojnë, kontrollojnë dhe monitorojnë, sipas fushave të tyre të përgjegjësisë, zbatimin e sistemit të referimit, menaxhimin e buxhetit, vlerësimin e aktivitetit vjetor të spitaleve dhe performancën e spitaleve, sipas treguesve të aktivitetit spitalor, sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e financimit.

21. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Operatori i Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor dhe drejtoritë e spitaleve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
Belinda Balluku

## VENDIM

Nr. 37, datë 27.1.2023

### PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 330, DATË 22.4.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE SHTETËRORE ‘SISTEMI I DEKLARIMIT TË PASURISË DHE KONFLIKTIT TË INTERESIT – EACIDS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 330, datë 22.4.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa:

1. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

“3/1. Të dhënat, që përmban “Sistemi i Deklarimit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit – EACIDS”, mbrohen nëpërmjet një niveli sigurie që siguron enkriptimin e të dhënave që ruhen në të.”.

2. Në shkronjën “c”, të pikës 5, shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Personi i interesuar për aksesimin e sistemit elektronik dhe bazën e të dhënave EACIDS regjistrohet me llogari përdoruesi të posaçme dhe fjalëkalim, duke paraqitur saktë identitetin e tij me qëllim garantimin e sigurisë së informacionit.”.

II. Ngarkohet Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
Belinda Balluku



**VENDIM**  
**Nr. 38, datë 27.1.2023**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË  
BUXHETIN E VITIT 2023, MIRATUAR  
PËR KOMISIONIN QENDROR TË  
ZGJEDHJEVE, PËR ORGANIZIMIN  
E ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E  
VETËQEVERISJES VENDORE,  
TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 87, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në buxhetin e miratuar për vitin 2023, për organizimin e zgjedhjeve për organet e vetëqeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023, i shtohet fondi prej:

a) 1 993 610 933 (një miliard e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre milionë e gjashtëqind e dhjetë mijë e nëntëqind e tridhjetë e tre) lekësh, në zërin “Shpenzime korrente”, të programit buxhetor 01620 “Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale”;

b) 606 389 067 (gjashtëqind e gjashtë milionë e treqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëdhjetë e shtatë) lekësh, në zërin “Shpenzime kapitale”, të programit buxhetor 01620 “Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale”.

2. Efekti financiar, i përcaktuar sipas pikës 1, të këtij vendimi, përballohet:

a) 1 800 000 000 (një miliard e tetëqind milionë) lekë nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për përballimin e kostos së zgjedhjeve, miratuar për vitin 2023;

b) 800 000 000 (tetëqind milionë) lekë nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për raste të paparashikuara të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme, miratuar për vitin 2023.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
**Belinda Balluku**

**URDHËR**  
**Nr. 18, datë 12.1.2023**

**PËR DELEGIM KOMPETENCASH**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 9000/2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

**URDHËROJ:**

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Kulturës, zëvendësministrit të Ministrisë së Kulturës, znj. Meri Kumbe, nga data 13.1.2023 deri në datën 17.1.2023.

2. Në ushtrim të kompetencave të titullarit të Ministrisë së Kulturës, sipas pikës 1 të këtij urdhri, zëvendësministri ushtron këto përgjegjësi kryesore:

a) nënshkruan përgjigjet zyrtare drejtuar institucioneve shtetërore për të gjitha çështjet që janë brenda fushës së veprimtarisë së Ministrisë së Kulturës dhe që lidhen me ushtrimin e funksionit të drejtimit administrativ të institucionit;

b) ndjek dhe kontrollon veprimtarinë e nëpunësve të aparatit të Ministrisë së Kulturës.

3. Në ushtrimin e kompetencave, sipas këtij urdhri, zëvendësministri ndihmohet dhe mbështetet nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës ose personi që ushtron detyrat e tij, në rast mungese.

4. Zëvendësministri ndalohet të nëndelegojë të një organ i tretë kompetencat e përfituara përmes këtij akti delegimi.

5. Ngarkohet zëvendësministri i Ministrisë së Kulturës, Znj. Meri Kumbe, për zbatimin e këtij urdhri.



6. Ngarkohet Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve për komunikimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I KULTURËS  
**Elva Margariti**

**URDHËR**  
**Nr. 36, datë 24.1.2023**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES  
PËR KRIJIMIN E REGJISTRIT  
SHTETËROR TË REVISTAVE  
SHKENCORE QË BOTOHEN NË  
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 60 dhe 79, të ligjit 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; të pikës 3 të kreut V, të vendimit nr. 112, datë 23.2.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore ‘Doktor’ dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë ‘Profesor i asociuar’ dhe ‘Profesor’”, të ndryshuar; dhe të vendimit nr. 165, datë 21.3.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për metodologjinë e procesit të vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë të institucioneve të arsimit të lartë,

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e rregullore “Për krijimin e regjistrit shtetëror të revistave shkencore që botohen në Republikën e Shqipërisë”, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit dhe institucionet publike dhe jopublike që kryejnë veprimtari shkencore në Republikën e Shqipërisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT  
**Evis Kushi**

**RREGULLORE**

**PËR KRIJIMIN E REGJISTRIT SHTETËROR  
TË REVISTAVE SHKENCORE QË  
BOTOHEN NË REPUBLIKËN E  
SHQIPËRISË**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Baza ligjore**

Kjo Rregulloret bazohet në nenet 60 dhe 79 të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; në vendimin nr. 112, datë 23.2.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore ‘Doktor’ dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë ‘Profesor i asociuar’ dhe ‘Profesor’”, të ndryshuar; dhe në vendimin nr. 165, datë 21.3.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për metodologjinë e procesit të vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë të institucioneve të arsimit të lartë”.

**Neni 2**  
**Qëllimi dhe objektivat**

1. Kjo Rregullore ka për objekt krijimin e regjistrit shtetëror për revistat shkencore të botuara në Republikën e Shqipërisë, si dhe përcaktimin e procedurave për përfshirjen e revistave përkatëse në këtë regjister.

2. Regjistri administrohet nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, në formatin e shkruar dhe elektronik.

**Neni 3**  
**Fusha e zbatimit**

Kjo Rregullore zbatohet për revistat shkencore të botuara nga institucionet kërkimore shkencore në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 4**  
**Përkufizime dhe shkurtime**

1. “Regjistri shtetëror i revistave shkencore”, regjistri shtetëror i revistave shkencore të





botuara në Republikën e Shqipërisë (në vijim “Regjistri”) është një bazë unike të dhënash të të gjitha revistave shkencore të botuara në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

2. **“Artikull kërkimor-shkencor (*research article*)”** është rezultat i kërkimit shkencor origjinal, i cili kontribuon në mënyrë të drejtpërdrejtë në fushën përkatëse. Këta lloj artikujsh shkruhen nga kërkues shkencor në mënyrë individuale ose me bashkautorësi me studiues, kërkues ose ekspertë të fushës dhe aplikojnë standardet më të larta të vlerësimit dhe të komunikimit shkencor.

3. **“Artikull vlerësues (*review article*)”** përmbledh sistematikisht literaturën primare (artikujt kërkimorë-shkencorë) për një çështje të caktuar, si dhe propozon/sugjeron drejtime të mundshme studimore për t’u hulumtuar në të ardhmen.

4. **“Bord editorial”**, grupi i individëve të cilët udhëheqin revistën shkencore, duke ofruar ekspertizë profesionale në botim, tërheqjen e autorëve të rinj, si dhe nxitjen e publikimeve. Tipikisht bordi përbëhet nga studiues, kërkues apo ekspertë të fushës, në fushën e revistës shkencore.

5. **“Citescore – CiteScore (pikëzimi i citimit) i një reviste shkencore”** është një masë që pasqyron numrin mesatar vjetor të citimeve në artikujt e fundit të botuar në atë revistë. Kjo llogaritje e vlerësimit të një reviste akademike/shkencore u shpall në dhjetor 2016 nga kompania *Elsevier*, që është administratore e bazës së të dhënave të revistave shkencore *Scopus*. Ky indikator është si një alternativë ndaj indikatorit të faktorit të impaktit që përdoret në *Journal Citation Reports*, të përlogaritur nga kompania *Clarivate Analytics*, që administron bazën e të dhënave të revistave shkencore *Web of Science*.

6. **“Faktor impakti – Journal Impact Factor (JIF) i një reviste akademike”** është një tregues renditje i llogaritur nga *Clarivate. Impact Factor* pasqyron numrin mesatar vjetor të citimeve të artikujve të botuar në dy vjetët e fundit në një revistë të caktuar, siç indeksohet nga *Clarivate’s Web of Science*.

7. **“Indeksim”**, procesi i përfshirjes së një reviste shkencore në një databazë të caktuar, e cila mund të jetë e përgjithshme ose e specializuar në një fushë të caktuar. Indeksimi i revistës shkencore

është një element i rëndësishëm që tregon cilësinë e saj.

8. **“International Standard Serial Number (ISSN) – ISSN”** është kodi 8-shifror, i cili përdoret për të identifikuar gazetat, revistat shkencore etj. (të printuara dhe elektronike).

9. **“Institucione kërkimore shkencore”**, institucionet publike dhe jopublike që kryejnë veprimtari kërkimore shkencore në Republikën e Shqipërisë.

10. **“Journal Acceptable Rate (JAR)”**, përqindja e pranimit të artikujve për botim në revistën shkencore, është përqindja e pranimit të artikujve shkencorë, që pranohen për botim nga totali i të gjithë artikujve që paraqiten nga studiues të fushës përkatëse.

11. **“Kategoritë e revistave”**, revistat shkencore do të klasifikohen sipas kategorive A, B dhe C, në përputhje me kriteret specifike për secilën kategori.

12. **“Periodiciteti”**, përsëritja e botimit të numrave të revistës shkencore në intervale të rregullta kohore.

13. **“Revistë shkencore”**, botim periodik shkencor, i cili ka si synim kryesor shpërndarjen e gjetjeve të kërkimit shkencor sistematik të kryer në një fushë të caktuar. Për efekt të kësaj Rregulloreje, të gjitha botimet shkencore (pavarësisht emërimit), të cilat plotësojnë kriteret e përcaktuara, konsiderohen si revista shkencore.

14. **“SCImago Journal Rank (SJR)”**, indikator i cili mat prestigjin e revistave shkencore dhe përfshin numrin e citimeve të marra nga revistat përkatëse dhe prestigjin e revistës nga vijnë citimet.

15. **“Vlerësimi shkencor (*peer review*)”**, procesi i vlerësimit kritik të cilësisë dhe të meritave shkencore të artikullit shkencor dhe kërkimit përkatës. Ky vlerësim kryhet nga redaktorët e revistës shkencore, si dhe ekspertë të tjerë të fushës përkatëse akademike.

16. **“Vlerësim i jashtëm (*external peer review*)”**, vlerësimi shkencor i kryer nga ekspertë të jashtëm (vendës ose të huaj), të pavarur, të fushës përkatëse, që nuk i përkasin institucionit. Ky vlerësim mund të kryhet në nivele të ndryshme anonimatit apo edhe i hapur për të gjitha palët e përfshira.



## KREU II REGJISTRI

### Neni 5

#### Regjistri i Revistave Shkencore

1. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja elektronike e të dhënave të depozituara në regjister kryhet nëpërmjet një sistemi të informatizuar që administrohet nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI).

2. Regjistri në format të shkruar trajtohet sipas legjislacionit në fuqi për arkivat, nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit.

### Neni 6

#### Kriteret për regjistrim

#### 1. Për t'u përfshirë në kategorinë C, revista shkencore duhet të plotësojë kriteret, si më poshtë:

1.1 Periodiciteti i publikimit të jetë të paktën një herë në vit, publikim i rregullt në një muaj të caktuar të vitit.

1.2 Të ketë të paktën dy numra të revistës botuar në mënyrë të pandërprerë në dy vjetët e fundit.

1.3 Të ketë të përcaktuar qartë fushën/fushat e studimit për të cilën botohet.

1.4 Të jetë e identifikuar me një ISSN të vlefshme, të konfirmuar nga Regjistri Ndërkombëtar ISSN.

1.5 Të jetë e botuar në gjuhën shqipe dhe/ose në një nga pesë gjuhët zyrtare të Bashkimit Evropian (BE), si dhe të ketë abstrakt ose përmbledhje.

1.6 Të ketë një bord editorial të përbërë nga personel pjesa më e madhe e të cilëve kanë gradën shkencore “Doktor”.

1.7 Të ketë një procedurë standarde për dërgimin e artikujve të rinj për botim në redaksinë e revistës.

1.8 Të ketë një procedurë vlerësimi për artikujt që botohen.

1.9 Të ketë procedurë për vlerësimin e plagjiaturës.

1.10 Raporti i pranimit të artikujve për botim (JAR) me ato që paraqiten, duhet të jetë deri në masën 90%.

#### 2. Për t'u përfshirë në kategorinë B, revista shkencore duhet të plotësojë kriteret, si më poshtë:

2.1 Periodiciteti i publikimit të jetë të paktën dy herë në vit, publikim i rregullt në një muaj të caktuar të vitit.

2.2 Të ketë të paktën tetë numra të revistës botuar në mënyrë të pandërprerë në katër vjetët e fundit.

2.3 Të ketë të përcaktuar qartë fushën/fushat e studimit për të cilën/cilat botohet.

2.4 Të jetë e identifikuar me një ISSN të vlefshme, të konfirmuar nga Regjistri Ndërkombëtar ISSN.

2.5 Të jetë e botuar në gjuhën shqipe dhe/ose në një nga pesë gjuhët zyrtare të BE-së. Abstrakti ose përmbledhja të jetë në një nga pesë gjuhët zyrtare të BE-së.

2.6 Të ketë një bord editorial të përbërë kryesisht nga një staf me të paktën 5 anëtarë që janë të kategorisë “Profesor” ose kanë gradën shkencore “Doktor” (PHD), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së.

2.7 Të ketë një procedurë standarde të miratuar për dërgimin e artikujve të rinj për botim në redaksinë e revistës.

2.8 Të ketë një procedurë të përcaktuar lidhur me vlerësimin e jashtëm (*External Peer Review*) me vlerësues vendës dhe të huaj.

2.9 Të jetë e indeksuar në Drejtorinë e Revistave Shkencore me Akses të Hapur – DOAJ (*Directory of Open Access Journal*) (<https://doaj.org>).

2.10 Artikujt e revistës të kenë një Identifikues Digjital të Artikullit – DOI (*Digital Object Identifier*), që përbëhet nga një tërësi unike germash e numrash, që të orientojnë drejt një linku në internet ku është botuar artikulli (<https://www.doi.org/>).

2.11 Raporti i pranimit të artikujve për botim (JAR) me ato që paraqiten, duhet të jetë deri në masën 80%.

2.12 Të ketë procedurë për vlerësimin e plagjiaturës.

#### 3. Për t'u përfshirë në kategorinë A, revista shkencore duhet të plotësojë kriteret, si më poshtë:

3.1 Periodiciteti i publikimit të jetë të paktën 2 herë në vit, publikim i rregullt në një muaj të caktuar të vitit.



3.2 Të ketë të paktën 8 numra të revistës botuar në mënyrë të pandërprerë në katër vjetët e fundit.

3.3 Të ketë të përcaktuar qartë fushën/fushat e studimit për të cilën botohet.

3.4 Të jetë e identifikuar me një ISSN të vlefshme, të konfirmuar nga Regjistri Ndërkombëtar ISSN.

3.5 Të jetë e botuar në një nga 5 gjuhët zyrtare të BE-së. Nëse revista është e indeksuar në *Scopus* dhe/ose *Web of Science*, pranohet të jetë e botuar dhe në gjuhën shqipe.

3.6 Të ketë një bord editorial të përbërë kryesisht nga një staf me të paktën 5 anëtarë që janë të kategorisë “Profesor”, kanë titullin akademik ose kanë gradën shkencore “Doktor” (PHD), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së.

3.7 Të ketë një procedurë standard për dërgimin e artikujve të rinj për botim në redaksinë e revistës. Vetëm 2/3 e autorëve të artikujve të revistës të çdo numri duhet t'i përkasin institucionit që e boton atë.

3.8 Të ketë një procedurë të përcaktuar lidhur me vlerësimin e jashtëm (*External Peer Review*) me vlerësues vendës dhe të huaj.

3.9 Të jetë e indeksuar në Drejtorinë e Revistave Shkencore me Akses të Hapur – DOAJ (*Directory of Open Access Journal*) (<https://doaj.org/>).

3.10 Artikujt e revistës të kenë një Identifikues Digjital të Artikullit – DOI (*Digital Object Identifier*), që përbëhet nga një tërësi unike shkronjash e numrash që të orientojnë drejt një linku në internet ku është botuar artikulli (<https://www.doi.org/>).

3.11 Të jetë e indeksuar në një nga Bazat e të Dhënave të Revistave Shkencore të njohura ndërkombëtarisht, si *Scopus* dhe/ose *Web of Science*, dhe të ketë një nga indikatorët e citimit: impakt faktor (IF), *CiteScore* ose *Scimago Journal Rank* (SJR).

3.12 Të ketë procedurë për vlerësimin e plagjiaturës.

3.13 Raporti i pranimit të artikujve për botim (JAR) me ato që paraqiten, duhet të jetë deri në masën 70%.

4. Revista, përbërja e bordit editorial, procedurat e vlerësimit dhe të gjitha elementet për secilën kategori të specifikuar më sipër, duhet të jenë të publikuara në faqen zyrtare *web*.

Neni 7

### Procedura e aplikimit

1. Institucionet kërkimore shkencore përcjellin pranë AKKSHI-së, aplikimin për përfshirjen e revistës/ave shkencore në regjistër.

2. Në rast se i njëjti institucion boton më shumë se një revistë shkencore, dërgon aplikim individual për secilin botim.

3. Aplikimi kryhet në formatin elektronik dhe përmban:

a) Formularin e aplikimit, me elementet e mëposhtme:

i. titullin e revistës shkencore;

ii. *link*-un e faqes zyrtare *web* të revistës shkencore;

iii. ISSN;

iv. vitin e botimit të parë;

v. fushën;

vi. periodicitetin;

vii. gjuhën;

viii. bordin editorial (listën e plotë të anëtarëve përfshirë titujt dhe rolet);

ix. nivelin e aksesueshmërisë;

x. procedurën e vlerësimit;

xi. procedurën e vlerësimit të jashtëm (nëse ka);

xii. procedurën e vlerësimit të plagjiaturës;

xiii. formularin e nënshkruar nga titullari i institucionit dhe drejtuesi i revistës shkencore;

b) Dokumentacionin provues, sipas elementeve të plotësuar në formular.

4. Regjistrimi fillestar i revistave të botuara nga institucionet kërkimore shkencore, si dhe çdo regjistrim tjetër i mëvonshëm, që ndryshon formën apo përmbajtjen e tyre, bëhet në bazë të aplikimit drejtuar AKKSHI-së.

5. Në përbërje të dokumentacionit të aplikimit duhet të jenë këto elemente:

i. kërkesa për regjistrim;

ii. formulari;

iii. vendimi i senatit të IAL-së apo Këshillit Shkencor të institucionit kërkimor për miratimin e formës së revistës, periodicitetit duhet të jenë në origjinal ose kopje autentike me origjinalin;

iv. akti i hapjes së revistës ose numri më i vjetër i revistës që disponon institucioni;

v. akti i indeksimit të revistës;

vi. forma e revistës (*design*) që do të regjistrohet;



6. Dokumentet duhet të jenë në gjuhën shqipe ose të përkthyer dhe të konfirmuara nga institucioni përkatës.

7. AKKSHI-ja kryen shqyrtimin dhe verifikimin e dokumenteve të paraqitura në dosjen e aplikimit, brenda 10 ditë pune, nga data e depozitimit të aplikimit.

Neni 8

### **Miratimi i regjistrimit**

1. AKKSHI-ja, pasi kryen shqyrtimin dhe verifikimin e dokumentacionit në dosjen e aplikimit nga institucionet e sipërcituara dhe vëren se dokumentacioni i depozituar është i plotë, sipas kërkesave të kësaj Rregulloreje, si edhe përmbush kriteret për t'u klasifikuar në një nga kategoritë A, B, C atëherë miraton regjistrimin e revistës shkencore.

2. Pas miratimit kryhet regjistrimi i revistës në regjistër dhe nga institucioni përkatës i ngarkuar me procesin e regjistrimit, lëshohet vërtetimi përkatës për institucionin e interesuar që ka paraqitur aplikimin.

3. Vërtetimi i regjistrimit lëshohet brenda 5 ditësh nga data e regjistrimit në regjistër.

Neni 9

### **Plotësim dokumentacioni**

1. Në rast se pas verifikimeve të parashikuara në nenin 7 të kësaj Rregulloreje, rezulton se nuk janë përmbushur të gjitha kërkesat për regjistrimin e revistave shkencore, AKKSHI-ja njofton me shkrim ose në rrugë elektronike institucionin që ka paraqitur aplikimin për plotësimin e dokumentacionit.

2. Procedura e shqyrtimit për regjistrim rifillon menjëherë pas përmbushjes së kriterëve të parashikuara.

3. Afati i shqyrtimit të aplikimit fillon të llogaritet nga dita e depozitimit të plotësimeve/saktësimeve.

Neni 10

### **Kodi unik i identifikimit të revistës shkencore**

1. Çdo revistë shkencore, e regjistruar në regjistrin, pajiset me një kod unik identifikimi.

2. Kodi unik i identifikimit përbëhet nga këto elemente:

a) RSH – Akronimi për Revistë Shkencore.

b) Viti i botimit të revistës për herë të parë.

c) Emri i shkurtuar i institucionit kërkimor shkencor.

d) Numri i fushës/nënfushës së kërkimit shkencor, sipas shtojcës 1, të vendimit nr. 165, datë 21.3.2018, të Këshillit të Ministrave.

Neni 11

### **Ankimi administrativ**

1. Çdo institucion kërkimor shkencor, të cilit i është refuzuar regjistrimi i revistës shkencore, ka të drejtën e ankimit administrativ brenda 30 ditësh në AKKSHI.

2. AKKSHI-ja, ngre komisione ekspertësh për shqyrtimin e ankimit, vendimin e të cilit ia njofton institucionit të interesuar brenda 10 ditëve nga data e depozitimit të ankimit.

3. Brenda 30 ditësh nga vendimmarrja e AKKSHI-së, institucion kërkimor shkencor ka të drejtën e ankimit administrativ ndaj këtij vendimi në MAS.

4. MAS-i, pasi shqyrton ankimin, merr vendim dhe ia njofton institucionit të interesuar brenda 10 ditëve nga data e depozitimit të ankimit.

Neni 12

### **Aksesi publik**

Regjistri i revistave shkencore publikohet në faqen zyrtare *web* të MAS-it dhe të AKKSHI-së.

Neni 13

### **Të dhënat e regjistrimit**

Të dhënat që do të mbahen në regjistër për çdo revistë shkencore do të jenë, si më poshtë:

a) Titulli i revistës;

b) Institucioni botues;

c) Viti i parë i botimit;

d) Fusha e kërkimit (sipas shtojcës 1, të vendimit nr. 165, datë 21.3.2018, të Këshillit të Ministrave);

e) Periodiciteti;

f) Bordi botues;

g) Gjuha;

h) ISSN;



- i) Vlerësimi shkencor (*peer review*);
- j) *Website*;
- k) Niveli i aksesit;
- l) Financuesi;
- m) Pagesë për botim artikulli;
- n) Numri unik identifikimit të revistës shkencore;
- o) Indeksimi në një *database* ndërkombëtare;
- p) Indeksi i citimit;
- q) Procesi i plagjiaturës;
- r) Procedura e vlerësimit të plagjiaturës.

Neni 14  
**Afatet**

Aplikimi për regjistrimin e revistave shkencore në regjistrin shtetëror kryhet sipas procedurës së përcaktuar në nenin 5 të kësaj Rregulloreje, në çdo kohë, dhe regjistrimi i tyre në regjister kryhet menjëherë pas kategorizimit të tyre.

Neni 15  
**Procedura e vlerësimit**

Vlerësimi i plotësimit të kriterëve të revistave, sipas përcaktimeve në këtë Rregullore kryhet nga AKKSHI-ja. Në rastin kur revista u përket fushave specifike, si studimet albanologjike, siguria publike dhe mbrojtja, vlerësimi i plotësimit të kriterëve të tyre do të realizohet nga grupe pune të cilat duhet të ngrihen nga AKKSHI-ja.

KREU III  
**DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

1. Ministria përgjegjëse për arsimin kryen vlerësime periodike çdo tre vjet, në vijimësi të përputhshmërisë së kriterëve përkatëse nga revistat shkencore, të cilat regjistrohen në regjistrin shtetëror.

2. Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë.

**VENDIM**  
**Nr. 42, datë 27.12.2022**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,  
e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Altin Binaj	anëtar;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Fiona Papajorgji	anëtare,

me sekretare Enina Kotoni, në datat 8.11.2022 dhe 27.12.2022, përkatësisht në seancë plenare publike dhe mbi bazën e dokumenteve, mori në shqyrtim çështjen nr. 2 (Nj) 2022 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

**KËRKUES:** Një grup deputetësh të Kuvendit të Shqipërisë (jo më pak se një e katërta e deputetëve), përfaqësuar me autorizim nga Marash Logu.

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:** Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar me autorizim nga Erind Mërkuri. Këshilli i Ministrave, përfaqësuar me autorizim nga Elira Kokona dhe avokate e shtetit Irma Qosja.

**OBJEKTI:** Zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet jo më pak se një të katërtës së deputetëve dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Deklarimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 80/2021 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, “Për mosmiratimin e projektvendimit, ‘Për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve dhe mosveprimeve të institucioneve shtetërore dhe funksionarëve publikë në çështjet që kanë sjellë si pasojë vendimin e arbitrazhit ‘Becchetti dhe të tjerë kundër Shqipërisë’”.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 7, 77, 78, 131, pika 1, shkronja “ç” dhe 134, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 25 i Rregullores së Kuvendit; nenet 54, 55 dhe 56 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe



funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*); ligji nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, i ndryshuar (*ligji nr. 8891/2002*).

## GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi pretendimet e kërkuarit, një grup prej jo më pak se një e katërta e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*) dhe Këshillit të Ministrave, të cilat kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

### VËREN:

#### I

### Rrethanat e çështjes

1. Kërkuari, një grup deputetësh të Kuvendit (jo më pak se një e katërta e deputetëve), anëtarë të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, ka depozituar në Kuvend kërkesën nr. 2226, datë 1.10.2021 për ngritjen e një komisioni hetimor, me qëllim kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve dhe mosveprimeve të institucioneve shtetërore dhe funksionarëve publikë në çështjet që kanë sjellë si pasojë vendimin e arbitrazhit “Becchetti dhe të tjerë kundër Shqipërisë”. Sipas kërkuarit, shteti shqiptar, bazuar në vendimin për dëmshpërblim të Qendrës Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve (*ICSID*) pranë Bankës Botërore, duhet t’i paguajë palës paditëse shumë prej 120 milionë eurosh.

2. Objekti i propozuar për veprimtarinë e komisionit hetimor është: a) verifikimi i ligjshmërisë së veprimeve të Kryeministrit, Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, sekretarit të përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, si dhe funksionarëve të tjerë publikë; b) verifikimi i ndërvarësisë së këtyre veprimeve me veprimet procedurale të marra nga organet e drejtësisë, të cilat kanë kulmuar me sekuestrimin e Agonset; c) verifikimi i veprimeve dhe mosveprimeve të Agjencisë për Administrimin e Aseteve të Sekuestruara, të cilat kanë sjellë shkatërrimin e plotë të Agonset; d) verifikimi i veprimeve dhe

mosveprimeve të organeve kompetente relevante për sa i përket mosdhënies së informacioneve të kërkuara nga INTERPOL; e) dëmi ekonomik që i shkaktohet buxhetit të shtetit nga ky vendim; f) pasojat e rënda mbi investimet e huaja dhe lirinë e medias në Shqipëri; g) vlerësimi i nevojës për marrjen e masave të përshtatshme për një mbrojtje më të mirë të investimeve të huaja dhe lirisë së medias, duke shmangur edhe rrezikun potencial për gjoba të larta ndaj shtetit shqiptar.

3. Konferenca e Kryetarëve në mbledhjen e datës 4.10.2021 ka shqyrtuar, ndër të tjera, edhe kërkesën e mësipërme për ngritjen e komisionit hetimor dhe ka vlerësuar se kjo nismë e paraqitur nga kërkuari i plotësonte elementet formale të kërkuara nga nenet 5 dhe 6 të ligjit nr. 8891/2002. Në lidhje me thelbin e kërkesës, pakica parlamentare ka mbajtur qëndrimin se kërkesa për ngritjen e komisionit hetimor në fjalë është në përputhje me ligjin për sa i përket aspektit formal dhe përmbajtjes së saj, ndërsa shumica parlamentare ka mbajtur qëndrimin se objekti i komisionit hetimor, në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, duhet t’i nënshtrohet diskutimit të shumicës dhe pakicës parlamentare për të arritur konsensusin lidhur me të. Në përfundim, shumica dhe pakica parlamentare kanë rënë dakord të caktojnë nga radhët e tyre dy persona përgjegjës për të diskutuar lidhur me thelbin e objektit të komisionit hetimor, si dhe për ta kaluar këtë kërkesë për diskutim në seancën plenare të datës 14.10.2021.

4. Në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve të datës 12.10.2021 palët kanë diskutuar mbi objektin e hetimit të komisionit të kërkuar. Sipas procesverbalit të kësaj mbledhjeje rezultoi se Avokatura e Shtetit, me shkresën nr. 2282 prot., datë 6.10.2021, ka kërkuar mosngritjen e komisionit hetimor për çështjen “Becchetti” ose shtyrjen e ngritjes së tij pas shterimit të mjeteve të mbrojtjes dhe përfundimit të proceseve gjyqësore ndërkombëtare. Avokatura e Shtetit ka nënvizuar se në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) është duke u zhvilluar një proces gjyqësor me aplikant shoqërinë “Agonset” sh.p.k, në kuadër të së cilit janë paraqitur dokumente të prodhuara nga arbitrazhi dhe është kërkuar që ato të mos jenë objekt publikimi, duke qenë se procesi i arbitrazhit karakterizohet nga konfidencialiteti. Për këto arsye, edhe GJEDNJ-ja ka urdhëruar që të



mos lejohet asnjë publikim i të dhënave të procesit të arbitrazhit. Më tej, Avokatura e Shtetit ka shprehur shqetësimin se investimi i Kuvendit për ngritjen e këtij komisioni hetimor parlamentar do të shfrytëzohej si një provë thelbësore në favor të aplikantit për të demonstruar si në proceset ekzistuese, ashtu edhe në ato potenciale, se Republika e Shqipërisë është në shkëlqje të detyrimeve ndërkombëtare. Pas diskutimeve në këtë mbledhje nuk është arritur në një konsensus nga palët për objektin e hetimit.

5. Konferenca e Kryetarëve, me vendimin nr. 4, datë 12.10.2021, ka vendosur shqyrtimin e kërkesës së mësipërme në seancën plenare të datës 14.10.2021 dhe me urdhrin nr. 13, datë 12.10.2021 të Kryetares së Kuvendit është parashikuar shqyrtimi i saj në rendin e ditës së asaj seance plenare.

6. Kuvendi, me vendimin nr. 80/2021, datë 14.10.2021, ka vendosur “Mosmiratimin e projektvendimit ‘Për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve dhe mosveprimeve të institucioneve shtetërore dhe funksionarëve publikë në çështjet që kanë sjellë si pasojë vendimin e arbitrazhit ‘Becchetti dhe të tjerë kundër Shqipërisë’” (vendimi nr. 80/2021). Argumentet e paraqitura për mosmiratimin e ngritjes së komisionit hetimor, sipas procesverbalit të seancës plenare, kanë qenë se kërkesa: i. bie në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare, pasi cenon parimin e konfidentalitetit të këtij procesi arbitrazhi që është detyruar për Republikën e Shqipërisë; ii. cenon parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve për arsye se për të njëjtën çështje ekzistojnë edhe procese penale dhe civile në të drejtën e brendshme, si dhe iii. dëmton në mënyrë të drejtpërdrejtë interesat e Republikës së Shqipërisë në lidhje me një procedurë akoma në proces.

7. Me kërkesën e datës 25.10.2021, një grup deputetësh të Kuvendit i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), duke kërkuar zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet jo më pak se një të katërtës së deputetëve dhe Kuvendit, si dhe shfuqizimin e vendimit nr. 80/2021 të këtij të fundit, çështje për të cilën është vendosur kalimi për shqyrtim në seancë plenare publike.

8. Në parashtrimet drejtuar Gjykatës, si dhe në seancën plenare të datës 10.3.2022, subjekti i interesuar, Kuvendi, ka prapësuar në lidhje me

legjitimitimin formal të kërkuarit, duke pretenduar se kërkesa në shqyrtim nuk është nënshkruar nga të gjithë deputetët që kanë nënshkruar kërkesën e depozituar në Kuvend për ngritjen e komisionit hetimor dhe duke qenë se Kushtetuta i njuh një të katërtës së deputetëve të drejtën për të kërkuar ngritjen e komisioneve hetimore parlamentare, vetëm kjo pakicë parlamentare (të njëjtët deputetë) legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës për cenimin e kësaj të drejte.

9. Me vendimin nr. 9, datë 28.3.2022, Gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesës, bazuar në nenin 73, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000, pasi nuk u formua shumica prej 5 gjyqtarësh për vendimmarrje, sipas nenit 133, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, në lidhje me legjitimitimin e një të katërtës së deputetëve që kanë vënë në lëvizje gjykimin kushtetues në raport me një të katërtën e deputetëve që kanë kërkuar ngritjen e komisionit hetimor në Kuvend. Vendimi është shpallur në datën 12.4.2022, datë në të cilën u është njoftuar edhe palëve në proces, dhe ka hyrë në fuqi, në përputhje me nenin 132, pika 2, të Kushtetutës, ditën e botimit në Fletoren Zyrtare nr. 58, datë 15.4.2022.

10. Me kërkesën e datës 13.4.2022, kërkuari, jo më pak se një e katërta e deputetëve të Kuvendit, i është drejtuar Gjykatës me kërkesë me të njëjtin objekt dhe për të njëjtat shkaqe, duke sqaruar se ajo tashmë paraqitet nga i njëjti subjekt që ka paraqitur/nënshkruar edhe kërkesën për ngritjen e komisionit hetimor në Kuvend.

11. Kolegji i Gjykatës, me vendimin e datës 23.5.2022, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Kjo e fundit, me vendimin e datës 7.6.2022, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike.

12. Kuvendi, në parashtrimet e tij të datës 12.7.2022, i ka kërkuar Gjykatës thirrjen e Këshillit të Ministrave si subjekt të interesuar në këtë gjykim. Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës, në vështrim të nenit 39, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, me vendimin e datës 21.9.2022, ka vendosur të pranojë kërkesën e Kuvendit për thirrjen e Këshillit të Ministrave si subjekt të interesuar në gjykimin kushtetues.

13. Pas zhvillimit të seancës plenare publike të datës 8.11.2022, trupi gjykues i asaj seance filloi bisedimet, në përfundim të të cilave u konstatua se



nuk arrihej kuorumi i nevojshëm për marrjen e vendimit, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000. Në këto kushte, si dhe duke pasur parasysh faktin se në datën 7.12.2022 Presidenti i Republikës kishte dekretuar emërimin e gjyqtarit të ri të Gjykatës Kushtetuese, me vendimin e datës 9.12.2022 Gjykata, në zbatim të nenit 73, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, vendosi riçeljen e seancës plenare për shqyrtimin e kësaj çështjeje dhe fillimin e shqyrtimit të saj nga e para, si dhe zhvillimin e seancës plenare mbi bazë të dokumenteve<sup>1</sup>.

## II

### Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

**14. Kërkuesi**, jo më pak se një e katërta e deputetëve të Kuvendit, në thelb, ka pretenduar se është cenuar e drejta e pakicës parlamentare për të kërkuar ngritjen e një komisioni hetimor, për arsyet e parashtruara në vijim:

14.1 Kërkesa për ngritjen e komisionit hetimor është paraqitur në Kuvend pas njohjes me vendimin e ICSID-it, me të cilin detyrohet shteti shqiptar t'i paguajë dëmshpërblim palës paditëse, pasi nga faktet dhe provat ka rezultuar se si rezultat i veprimeve dhe mosveprimeve të paligjshme të disa zyrtarëve të lartë shtetërorë, sipërmarrjet e biznesmenit italian Francesco Becchetti janë shkatërruar plotësisht. Kërkesa përmbushte tre kriteret kushtetuese: i. kishte të bënte me funksionin ligjvënës dhe funksionet e tjera për të cilat Kuvendi është i autorizuar të marrë masa ligjore; ii. objekti i hetimit fokusohet në një çështje konkrete; iii. ka të dhëna dhe indicie të mjaftueshme që dëshmojnë për ekzistencën e praktikave të organeve publike që dëmtojnë investimet e huaja dhe lirinë e medias, për të cilat është i nevojshëm hetimi parlamentar. Gjithashtu, kërkesa dhe projektvendimi shoqëruet përcaktonin qartë objektin e punës së komisionit, si dhe garancitë për respektimin e parimeve kushtetuese, veçanërisht të parimit të ndarjes së pushteteve dhe shmangies së mbivendosjes së kompetencave me organet e drejtësisë.

14.2 Në seancën plenare të datës 14.1.2021 Kuvendi nuk ka bërë asnjë përpjekje ose propozim

për të rishikuar objektin e kërkesës, por e ka kaluar atë në procedurën e zakonshme të votimit, duke vendosur mospranimin e kërkesës me pretendimin se cenohet e drejta ndërkombëtare e arbitrazhit, parimi i konfidencialitetit dhe ai i ndarjes e balancimit të pushteteve, pasi për të njëjtën çështje ekzistojnë procese civile dhe penale. Kuvendi, edhe pse duhet t'ia nënshtrohet diskutimit parlamentar shkallën e respektimit të parimeve kushtetuese, vetëm i ka përmendur në mënyrë sipërfaqësore, pa një analizë të thelluar. Është detyrë e shumicës parlamentare që të argumentojë parimet kushtetuese që cenohen nga objekti i propozuar, si dhe të propozojë formulime alternative të tij, deri në gjetjen e një versioni konsensual me kërkuesit.

14.3 Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të ndarjes së pushteteve, duke e krahasuar objektin e veprimtarisë së komisionit hetimor me objektin e punës së prokurorisë konstatohet dallimi mes tyre dhe nuk ka asnjë përpjekje të pakicës që të përvetësohet kompetenca e këtij organi, pra që të ndiqet penalisht ose të kryhen hetime për çështjet për të cilat ka filluar procedimi penal. Fakti se një çështje e ngjashme po hetohet nga prokuroria, nuk krijon pengesë *apriori* për ngritjen e komisionit hetimor. Është detyrë e komisionit hetimor që, pas ngritjes së tij, të shmangë çdo ndërhyrje në kompetencat e organeve të tjera shtetërore.

14.4 Në lidhje me pretendimin se shkelet e drejta ndërkombëtare, edhe pse nuk është përcaktuar se cili traktat, konventë, marrëveshje ose normë e së drejtës ndërkombëtare shkelet, ai nuk lidhet me parime të natyrës kushtetuese. Kurse në lidhje me parimin e konfidencialitetit, kërkohet ruajtja e tij për një vendim që është i aksesueshëm *online* nga kushdo. Edhe pse deputetët kërkues ofruan gatishmërinë për zhvillimin e mbledhjeve me dyer të mbyllura në rastet kur do administroheshin informacione, të dhëna ose dokumente konfidenciale, kjo nuk mjaftoi për gjetjen e një konsensusi.

14.5 Kushtetutshmëria e objektit të hetimit parlamentar qëndron edhe në respektimin e konceptit kushtetues “çështje e veçantë”, pasi objekti i veprimtarisë së komisionit hetimor, përveç pasojave të rënda ekonomike për shtetin shqiptar dhe qytetarët e tij, lidhet edhe me dy çështje të rëndësishme, siç janë mbrojtja e investimeve të huaja dhe liria e medias, për të cilat është urgjente

<sup>1</sup> Votuan kundër riçeljes së seancës plenare gjyqtarët: Elsa Toska, Altin Binaj dhe Sandër Beci.





nxjerrja e përgjegjësive institucionale dhe vlerësimi i nevojës për të ndërhyrë në ligj.

**15. Subjekti i interesuar, Kuvendi,** ka prapësuar si vijon:

#### 15.1 Për juridiksionin e Gjykatës

15.1.1 Kërkesa përbën gjë të gjykuar, pasi me vendimin nr. 9, datë 28.3.2022, Gjykata ka vendosur në mënyrë përfundimtare rrezimin e kërkesës së paraqitur nga një grup deputetësh me të njëjtin objekt dhe për të njëjtat shkaqe. Pavarësisht se nuk u arrit shumica prej 5 gjyqtarësh, sipas nenit 73, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000, në këto raste kërkesa konsiderohet e rrezuar.

15.1.2 Vendimi nr. 9, datë 28.3.2022 i Gjykatës ka hyrë në fuqi më 15.4.2022, kur është botuar në Fletoren Zyrtare, kurse kërkesa në shqyrtim është paraqitur në datën 13.4.2022, dy ditë përpara hyrjes së tij në fuqi, pra para se çështja gjyqësore të mbyllet. Duke qenë se në Gjykatë po shqyrtohej në të njëjtën kohë një mosmarrëveshje midis të njëjtave palë, me të njëjtat shkaqe e të njëjtin objekt, duhej të vendosej pushimi i gjykimit.

#### 15.2 Për themelin e pretendimeve

15.2.1 Grupi i parë i çështjeve objekt hetimi (shkronjat “a”–“e”) dalin jashtë kornizës kushtetuese dhe ligjore të Kuvendit dhe vijnë në kundërshtim me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve. Referuar parashikimeve të nenit 3, pika 4, të ligjit nr. 8891/2002, komisioni hetimor nuk mund të ngrejë akuzë dhe të marrë atributet e gjykatës. Kontrolli i ligjshmërisë së veprimeve të organeve ose zyrtarëve të tyre bie në fushëveprimin e organeve të pavarura kushtetuese, siç janë prokuroria dhe gjykatat dhe këto çështje janë në shqyrtim nga këto organe.

15.2.2 Çështjet e grupit të dytë të objektit të hetimit (shkronjat “P” dhe “g”) janë shumë të gjera dhe nuk krijojnë lidhje organike midis tyre, pasi tentohet të hetohet për çdo lloj investimi të huaj në Shqipëri e nuk specifikohet se për cilat investime të huaja bëhet fjalë dhe për cilën periudhë kohore, çka e bën të pamundur identifikimin e saktë të objektit të hetimit. Edhe masat që synohen të merren për mbrojtjen e të gjitha investimeve të huaja në Shqipëri janë të papërcaktuara, pasi nuk trajtohet lloji i investimeve dhe periudha kohore. Për më tepër, flitet për shmangien e rrezikut potencial për gjoba të larta ndaj shtetit shqiptar, çka nuk ka lidhje organike me objektin e hetimit të tërësi dhe gjithë

situata mbështetet në aludime hipotetike për të ardhmen.

15.2.3 Hetimi parlamentar do të vinte në kundërshtim me detyrimet ndërkombëtare të marra përsipër nga shteti shqiptar, përfshirë ruajtjen e parimit të konfidencialitetit, i cili nuk lejon bërjen publike dhe nxjerrjen e të dhënave të shkëmbyera gjatë arbitrazhit, duke përfshirë jo vetëm vendimin, por edhe çdo dokument tjetër të kësaj procedure. Shteti shqiptar, nëpërmjet disa marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara me akte ligjore (ligji nr. 7515, datë 1.10.1991, “Për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Ndërkombëtare për Rindërtimin dhe Zhvillimin, Korporatën Financiare Ndërkombëtare, Shoqatën e Zhvillimit Ndërkombëtar, Agjencinë e Garantimit të Investimeve Shumëpalëshe dhe Qendrën Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Konfliktëve në Investimet” (ligji nr. 7515/1991)), ka pranuar fuqinë dhe efektin e konventës ICSID në Republikën e Shqipërisë, si dhe ka njohur autoritetin gjyqësor të arbitrazhit ndërkombëtar. Sipas nenit 54 të konventës, vendimet e dhëna në përputhje me të do të zbatohen nga çdo shtet kontraktues sikur të ishin vendime përfundimtare të një gjykate në atë shtet, prandaj edhe çështja konkrete e vendosur nga arbitrazhi ICSID duhet të respektohet nga ana e Kuvendit. Në përputhje me nenin 180 të Kushtetutës, Republika e Shqipërisë duhet të njohë dhe të zbatojë detyrimet që rrjedhin nga e drejta ndërkombëtare, pjesë e të cilave është edhe zbatimi i vendimeve të arbitrazheve ndërkombëtare. Po në respektim të konfidencialitetit, çështja “Agonset kundër Shqipërisë” (aplikimi nr. 33104/15), është ende në shqyrtim në GJEDNJ, ku janë depozituar edhe aktet e arbitrazhit ICSID. Përderisa GJEDNJ-ja ka vendosur mbajtjen konfidenciale të kësaj çështjeje, edhe ky “vendim gjykate” duhet të respektohet nga Kuvendi.

**16. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave,** ka prapësuar si vijon:

#### 16.1 Për juridiksionin e Gjykatës

16.1.1 Gjykata, me vendimin nr. 9, datë 28.3.2022, ka vendosur rrezimin e kërkesës në mbështetje të neneve 72 dhe 73, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000, çka nuk lejon rishqyrtimin e çështjes. Pretendimi se kjo çështje nuk është gjë e gjykuar është i pabazuar, pasi kërkesat janë të njëjta për nga



struktura dhe përmbajtja, duke u bazuar mbi të njëjtat shkaqe dhe argumente kushtetuese.

16.1.2 Kërkesa është paraqitur në datën 13.5.2022, pra përpara fillimit të efekteve të vendimit të Gjykatës nr. 9, datë 28.3.2022, i cili ka hyrë në fuqi më 15.4.2022. Për rrjedhojë, është krijuar situata e shqyrtimit paralelisht të dy kërkesave të njëjta, pasi nga pikëpamja procedurale çështja e parë nuk konsiderohej e mbyllur.

#### 16.2 Për themelin e çështjes

16.2.1 Objekti i komisionit hetimor del përtej tagrave dhe kompetencave kushtetuese e ligjore të Kuvendit, pasi komisioni do të kishte detyrë verifikimin dhe kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve ose mosveprimeve të zyrtarëve publikë dhe institucioneve publike, duke verifikuar edhe ndërvarësinë e tyre me veprimet procedurale të ndërmarra nga organet e drejtësisë. Ngritja e këtij komisioni hetimor me këtë objekt mund të ndikojë në veprimtarinë e organeve të sistemit të drejtësisë (gjykatat dhe prokuroritë), pasi çështja penale ndaj shtetasit Francesco Beccheti është ende në shqyrtim dhe ajo ka përfunduar vetëm në shkallë të parë, ku ai është dënuar me burgim.

16.2.2 Dy pikat e fundit të objektit të hetimit janë të gjera dhe të përgjithshme, pasi kërkohet hetim për investimet e huaja dhe lirinë e medias në Shqipëri, si dhe për nevojën e marrjes së masave të përshtatshme për mbrojtjen e tyre, por pa specifikuar llojin e këtyre investimeve, periudhën kohore të hetimit, llojin e masave që kërkohet të merren, lidhjen e hetimit për investimet e huaja me lirinë e medias, si dhe me pikat e tjera të objektit të hetimit. Në mungesë të specifikimit të këtyre çështjeve objekti i hetimit mbetet i papërcaktuar në mënyrë të qartë dhe të saktë, pasi disa prej tyre supozohet të kenë lidhje me çështje të kaluara, ndërsa të tjera me çështje që ndoshta mund të zbulohen ose gjenden në të ardhmen.

16.2.3 Ngritja e komisionit hetimor shkel të drejtën ndërkombëtare dhe parimin e konfidencialitetit. Pas nisjes së hetimeve nga prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe kryerjes së veprimeve hetimore, shtetasi Francesco Beccheti, personat e lidhur me të dhe kompanitë në zotërim të tij kanë nisur disa procese para juridiksioneve ndërkombëtare, trupa arbitrazhi dhe GJEDNJ-ja, dhe të gjitha çështjet që lidhjen me objektin e hetimit parlamentar janë të mbrojtura nga parimi i konfidencialitetit. Në

çështjen “Hydro s.r.l. e të tjerë kundër Republikës së Shqipërisë” (ICSID çështja nr. ARB/15/28), gjykata, me kërkesë të palës paditëse, ka urdhëruar mbajtjen e procesit konfidencial dhe referuar faqes zyrtare të ICSID-it nuk gjenden të dhëna për këtë proces përveç procedurës së administrimit të tij. Edhe në çështjen “Agonset sh.p.k. kundër Shqipërisë”, GJEDNJ-ja ka pranuar kërkesën e aplikantit për ruajtjen e konfidencialitetit të procesit.

16.2.4 Respektimi i detyrimeve që vijnë nga marrëveshjet ndërkombëtare, në bazë të neneve 5, 116, 121, 122, 123 dhe 180 të Kushtetutës, është i detyrueshëm për të gjitha organet shtetërore, përfshirë Kuvendin. Hapja e një procesi hetimor dhe publikimi i të dhënave ose të një pjesë të tyre do e vendoste shtetin shqiptar në konflikt me juridiksionet ndërkombëtare në të cilat Shqipëria është palë dhe do të çonte në shkelje të detyrimeve ndërkombëtare të marra përsipër në kuadër të anëtarësimit në këto organizata. Përmes ligjit nr. 7515/1991, shteti shqiptar ka pranuar fuqinë dhe efektin e konventës ICSID në Republikën e Shqipërisë, si dhe ka njohur autoritetin gjyqësor të arbitrazhit ndërkombëtar ICSID. Sipas nenit 54 të Konventës, vendimet e dhëna në përputhje me të do të zbatohen nga çdo shtet kontraktues sikur të ishin vendime përfundimtare të një gjykate në atë shtet, prandaj dhe çështja konkrete e vendosur nga arbitrazhi ICSID si “vendim gjykate” duhet të respektohet nga ana e Kuvendit. Garancia e ofruar për zhvillimin e mbledhjeve me dyer të mbyllura është e panevojshme, pasi urdhri i ICSID-it për ruajtjen e konfidencialitetit është tepër i qartë dhe zhvillimi i mbledhjeve me dyer të mbyllura nuk nënkupton respektimin dhe përmbushjen e këtij detyrimi. Detyrimi për njohje dhe zbatim të vendimeve të arbitrazhit parashikohet edhe në nenin 3 të konventës së Kombeve të Bashkuara “Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit”, ku Republika e Shqipërisë ka aderuar.

### III

#### Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

##### A. Për juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese

17. Subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, kanë prapësuar se kërkesa përbën gjë të gjykuar, pasi me vendimin nr. 9, datë 28.3.2022 Gjykata ka vendosur në mënyrë



përfundimtare rrëzimin e kërkesës së paraqitur nga një grup deputetësh me të njëjtin objekt dhe shkaqe. Pavarësisht se nuk u arrit shumica prej 5 gjyqtarësh, sipas nenit 73, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000, në këto raste kërkesa konsiderohet e rrëzuar, çka nuk lejon rishqyrtimin e çështjes. Kërkesat janë të njëjta për nga struktura dhe përmbajtja e tyre, si dhe bazohen mbi të njëjtat shkaqe dhe argumente kushtetuese.

18. Në lidhje me këtë pretendim kërkuar ka parashtruar se nuk gjendemi përpara gjësë së gjykuar, sepse në gjykimin e mëparshëm, sipas asaj që rezultojnë nga vendimi, është diskutuar në lidhje me legjitimitimin e kërkuar, pra se kush e ka të drejtën për t'iu drejtuar Gjykatës në raport me subjektin që konkretisht i është drejtuar. Megjithatë, vendimi i mëparshëm i Gjykatës nuk ia heq të drejtën subjektit për ta vënë atë në lëvizje brenda afatit ligjor.

19. Gjykata ka theksuar se zbatimi i detyrueshëm i vendimeve të saj garantohet nga Kushtetuta, e cila në nenet 132 dhe 145 sanksionon shprehimisht këtë koncept kushtetues. Ndikimi i padiskutueshëm i këtyre vendimeve është i tillë që i imponon të gjitha organeve shtetërore fuqinë detyruese të arsytimit të vendimit të saj (*shih vendimin nr. 17, datë 10.4.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Arsyetimi që përdor Gjykata në vendimet e saj ka forcën e ligjit, çka buron nga autoriteti i këtij organi për të thënë fjalën e fundit në çështjet për të cilat të tjerët tashmë janë shprehur. Çdo qëndrim i kundërt krijon një precedent të rrezikshëm në marrëdhëniet institucionale (*shih vendimin nr. 78, datë 12.12.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se nga standardi i detyrueshëm të zbatimit të vendimmarrjes kushtetuese nuk mund të bëjë përjashtim as vetë kjo Gjykatë (*shih vendimet nr. 4, datë 15.2.2021; nr. 78, datë 12.12.2017; nr. 44, datë 29.6.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Gjykata ka theksuar se në të drejtën kushtetuese parimi *res judicata* njihet si një nga tri format e efekteve që merr vendimi gjyqësor në procedurën abstrakte të kontrollit të kushtetutshmërisë së normave juridike. Në aspektin formal e procedural, në gjykimin kushtetues “gjë e gjykuar” nënkupton përfundimin në drejtim të mosankueshëm të vendimit, ndërsa në atë substancial nënkupton fuqinë detyruese të vendimit. Tipar karakteristik i gjësë së

gjykuar është se kur në vendimin e parë çështja e ngritur është konsideruar e pabazuar në themel, ajo nuk mund të shqyrtohet më tej. Në rastet kur Gjykata nuk është shprehur në lidhje me pajtueshmërinë me Kushtetutën të normës juridike, kërkuar nuk ndalohet të paraqesë përsëri të njëjtën kërkesë për kontrollin e pajtueshmërisë së kësaj norme me Kushtetutën. Kjo varet nga pjesa arsyetuese e vendimit, sepse rrëzimi i kërkesës mund të jetë vendosur për shkaqe të tjera (*shih vendimet nr. 4, datë 15.2.2021; nr. 78, datë 12.12.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Kufijtë e zbatimit të parimit të gjësë së gjykuar përcaktohen në lidhje të ngushtë me thelbin e mosmarrëveshjes në gjykim. Në këtë aspekt, Gjykata çmon se gjëja e gjykuar përfshin jo vetëm urdhërimet e dispozitivit të vendimit gjyqësor, por edhe vërtetimet e fakteve dhe zbatimin e së drejtës, të përcaktuara në pjesën përshkruese arsyetuese të vendimit, me kusht që të jenë kryer me qëllim të dhënies së vendimit gjyqësor dhe t'u përkasin fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit mbi të cilin gjykata ka dhënë vendimin e saj. Në këtë kuptim, Gjykata në praktikën e saj ka pranuar edhe rishqyrtimin e kërkesës së të njëjtit subjekt, me të njëjtin objekt, kur përmes një kërkesë tjetër, brenda afatit ligjor të parashikuar nga ligji i saj organik, janë ngritur shkaqe të reja për antikushtetutshmërinë e aktit të kundërshtuar (*shih vendimet nr. 78, datë 12.12.2017; nr. 29, datë 21.12.2006, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Për të arritur në përfundimin nëse ndodhet para gjësë së gjykuar, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se në gjykimin e parë është vendosur rrëzimi i kërkesës duke u ndalur vetëm te legjitimitimi *ratione personae*, do të analizojë subjektin inicues dhe përmbajtjen e kërkesës së mëparshme dhe të asaj në shqyrtim, si dhe qëndrimin e mbajtur prej saj në vendimin që është shprehur në lidhje me atë kërkesë.

23. Gjykata vëren se me kërkesën e datës 25.10.2021 një grup deputetësh të Kuvendit, në cilësinë e një të katërtës së deputetëve, i është drejtuar asaj për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave midis pakicës parlamentare dhe Kuvendit dhe shfuqizimin e vendimit të këtij të fundit për mosngritjen e komisionit hetimor. Në atë gjykim është vënë në diskutim legjitimitimi i një të katërtës së deputetëve që kanë vënë në lëvizje



grykimin kushtetues në raport me një të katërtën e deputetëve që kanë kërkuar ngritjen e komisionit hetimor në Kuvend, pretendim ky i ngritur nga subjekti i interesuar, Kuvendi. Gjykata ka konstatuar se kërkesa për ngritjen e komisionit hetimor, e depozituar në Kuvend, ishte nënshkruar nga 39 deputetë, ndërsa kërkesa drejtuar Gjykatës ishte nënshkruar nga 36 deputetë, 5 nga të cilët nuk rezultojnë të kishin nënshkruar kërkesën për ngritjen e komisionit hetimor. Pra, vetëm 31 nga 36 deputetët që i ishin drejtuar Gjykatës rezultojnë të kishin nënshkruar kërkesën për ngritjen e komisionit hetimor, për rrjedhojë lista nominale e deputetëve në të dyja kërkesat nuk përputhej. Mbi këto fakte, Gjykata ka vënë në diskutim nëse e drejta për t'iu drejtuar asaj për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave në lidhje me (mos) ngritjen e komisioneve hetimore i njihet nominalisht vetëm pakicës parlamentare së një të katërtës së deputetëve që ka të drejtë të kërkojë ngritjen e komisioneve të tilla, sipas kuptimit të nenit 77, pika 2, të Kushtetutës, apo kjo e drejtë lidhet vetëm me numrin e deputetëve të kërkuar nga Kushtetuta për të vënë në lëvizje Gjykatën (35 deputetë). Ajo ka vënë në diskutim edhe se cili është momenti që pakica parlamentare konstituohet në krahasim me nënshkrimin e kërkesës për ngritjen e komisionit, votimin e saj në Kuvend dhe paraqitjen e kërkesës në Gjykatë. Megjithatë, duke qenë se në përfundim të diskutimeve për çështjen e legjitimitetit të kërkuarit nuk u arrit numri i kërkuar i votave për vendimmarrje, i parashikuar në nenin 133, pika 2, të Kushtetutës dhe nenin 72, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata, në mbështetje të nenit 73, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000, me vendimin nr. 9, datë 28.3.2022, vendosi rrëzimin e kërkesës.

24. Me kërkesën e datës 13.4.2022 (kërkesa në shqyrtim), Gjykata është vënë sërish në lëvizje nga një grup deputetësh të Kuvendit (jo më pak se një e katërta e deputetëve), anëtarë të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike. Në këtë situatë, Gjykata vlerëson të shprehet fillimisht në lidhje me subjektin kushtetues që e ka vënë atë në lëvizje, për të përcaktuar nëse ai është i njëjtë me subjektin për të cilin ajo është shprehur në vendimin e mëparshëm.

25. Gjykata vëren se të dyja kërkesat janë paraqitur nga një e katërta e deputetëve të Kuvendit sipas përcaktimit të nenit 77, pika 2, të

Kushtetutës, e cila ka të drejtën të kërkojë ngritjen e një komisioni hetimor për shqyrtimin e një çështjeje të veçantë. Megjithatë, jo çdo entitet brenda Kuvendit, që formalisht përbën një të katërtën e deputetëve, ka të drejtë të paraqesë kërkesë kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave të pakicës parlamentare për ngritjen e komisionit hetimor, por vetëm ai grupim që e ka ushtruar ose kërkon ta ushtrojë efektivisht këtë të drejtë. Kjo sepse të drejtat e pakicës parlamentare janë në dispozicion vetëm të një pakice të kualifikuar që përmbush disa kritere, përfshirë arritjen e një kuorumi të caktuar të anëtarëve të Kuvendit. Edhe pse përgjithësisht opozita parlamentare përfaqëson pakicën parlamentare, kjo jo domosdoshmërisht nënkupton një unitet homogjen, por ajo, ashtu si dhe shumica parlamentare, mund të ndahet në grupe të ndryshme ose të shumëfishta, siç janë grupimet parlamentare, të cilat nuk plotësojnë kërkesat formale për të formuar një grup parlamentar ose deputetët e pavarur. Kushtetuta nuk e kufizon ushtrimin e të drejtave të pakicës vetëm tek anëtarët e opozitës parlamentare, por siguron ushtrimin e këtyre të drejtave për ata anëtarë të Parlamentit që së bashku plotësojnë një kuorum të caktuar, pa marrë parasysh përbërjen dhe krijimin e saj dhe pavarësisht anëtarësisë në parti ose grupe parlamentare (*shih vendimin 2 BvE 4/14, datë 3.5.2016, të Gjykatës Kushtetuese Federale të Gjermanisë, paragrafët 93–97, 102*).

26. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se grupet e deputetëve, të cilëve norma kushtetuese u ka njohur të drejta si entitete, përfshi edhe të drejtën për të vënë në lëvizje Gjykatën, nuk nënkupton dhe nuk barazohet me organizimin politik të deputetëve apo partive politike që veprojnë brenda Kuvendit. Në këtë kuptim, jo çdo grup parlamentar i pakicës është automatikisht edhe subjekt kushtetues, në rast se ai nuk plotëson kriteret kushtetuese, si në aspektin formal (numri i deputetëve kërkuar), ashtu edhe në aspektin substancial (të provuarit e interesit në rastet kur është e zbatueshme).

27. Gjykata ka vlerësuar se kur një grup deputetësh e vë atë në lëvizje për zgjidhjen e konfliktit të kompetencave, ai duhet të pretendojë jo vetëm se i është cenuar një kompetencë e caktuar, por edhe të parashtrijë se midis cilave organe ekziston konflikti, cila është kompetenca që ushtrohet nga organi tjetër dhe në ç'mënyrë pengohet ushtrimi i saj ose në ç'mënyrë një organ e



ushtron pa të drejtë një kompetencë. Nuk është i mjaftueshëm fakti që të dyja palët kundërshtare në procesin e konfliktit të kompetencave të pretendojnë interpretim ose zbatim të gabuar të ligjit ose Kushtetutës, por midis palëve duhet të ekzistojë një marrëdhënie juridike në kuptimin kushtetues dhe nga kjo marrëdhënie të kenë ardhur pasoja të tilla që të kenë shkaktuar mosmarrëveshjen midis tyre (*shih vendimin nr. 25, datë 8.5.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Mbi këto standarde, Gjykata vlerëson se vetëm një e katërta e deputetëve që pretendon se është penguar në ushtrimin e një të drejte kushtetuese institucionalizohet si një entitet i pavarur, i veshur me këto të drejta, mbrojtjen e të cilave mund ta kërkojë duke vënë në lëvizje këtë gjykim kushtetues. Ndërkohë, në rastin konkret ajo nuk është vënë në lëvizje nga i njëjti grupim deputetësh, nga pikëpamja nominale, që ka paraqitur kërkesën e shqyrtuar me vendimin nr. 9, datë 28.3.2022, për rrjedhojë çështja e legjitimitetit të këtij kërkuesi, jo vetëm që nuk ka qenë objekt shqyrtimi i atij vendimi, por rrëzimi ka ardhur për mosarritje të shumicës së kërkuar të votave.

29. Duke vijuar më tej me analizën e dy kërkesave, Gjykata vëren, gjithashtu, se edhe pse kërkesa në shqyrtim është e njëjtë në përmbajtje me kërkesën e mëparshme, pra ka të njëjtin objekt dhe mbështetet mbi të njëjtat shkaqe, në vendimin nr. 9, datë 28.3.2022 nuk është trajtuar asnjë nga shkaqet e kushtetutshmërisë së asaj çështjeje, për sa kohë që as në pjesën arsyetuese, as në dispozitiv Gjykata nuk është shprehur në lidhje me themelin e pretendimeve, pra për kërkimet për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave dhe kontrollin e kushtetutshmërisë së vendimit të Kuvendit që pretendohej se e ka shkaktuar atë. Pavarësisht se në atë çështje është vendosur rrëzimi i kërkesës, kjo vendimmarrje kishte të bënte me legjitimitetin e kërkuetit, ndërkohë që asnjë nga shkaqet e parashtruara në kërkesën e parë, edhe pse të njëjta, nuk janë vënë në diskutim në lidhje me bazueshmërinë e tyre në themel.

30. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se vendimi nr. 9, datë 28.3.2022 nuk përbën gjë të gjykuar, pra as pengesë në aspektin kushtetues për shqyrtimin e kësaj çështjeje sipas objektit të saj.

31. Gjykata vëren, gjithashtu, se sipas subjekteve të interesuara, Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave, kërkesa është paraqitur kur procesi i parë ende nuk

kishte përfunduar, duke krijuar situatën e shqyrtimit paralelisht në të njëjtën kohë, të dy kërkesave të njëjta, ndërkohë që nga pikëpamja procedurale, në atë moment çështja e parë nuk mund të konsiderohej e mbyllur. Vendimi nr. 9, datë 28.3.2022 i Gjykatës ka hyrë në fuqi më 15.4.2022, data e botimit në Fletoren Zyrtare, kurse kërkesa është paraqitur dy ditë përpara se ky vendim të hynte në fuqi. Sipas tyre, duke qenë se në Gjykatë po shqyrtohej në të njëjtën kohë një mosmarrëveshje midis të njëjtave palë, me të njëjtin shkak e të njëjtin objekt, duhej të vendosej pushimi i gjykimit.

32. Në lidhje me këtë pretendim kërkuesi ka prapësuar se ka marrë dënim për vendimin e Gjykatës në datën 12.4.2022, dhe se kërkesa është paraqitur në datën 13.4.2022. Ajo është paraqitur të nesërmen e marrjes dënim për vendimin e Gjykatës, pa pritur publikimin e tij në Fletoren Zyrtare, me qëllim respektimin e afatit ligjor për paraqitjen e kërkesës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave.

33. Gjykata, në përputhje me parashikimet e nenit 1, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, për sa kohë që një situatë e tillë nuk gjen rregullim në ligjin organik dhe Rregulloren e saj për Procedurat Gjyqësore, bazuar në natyrën e çështjes, i referohet nenit 58 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit, kur në të njëjtën gjykatë ose gjykata të ndryshme shqyrtohen në të njëjtën kohë mosmarrëveshje midis të njëjtave palë dhe kanë të njëjtin shkak e të njëjtin objekt, vendoset pushimi i gjykimit të mosmarrëveshjeve të paraqitura pas asaj të regjistruar më parë. Në kuptim të kësaj dispozite, Gjykata vëren se edhe pse kërkesat kanë të njëjtin objekt dhe shkaqe, ato nuk kanë qenë në shqyrtim në të njëjtën kohë. Kërkesa në shqyrtim është paraqitur pasi Gjykata kishte përfunduar shqyrtimin e kërkesës së parë dhe kishte njoftuar publikisht jo vetëm dispozitivin e vendimit, por edhe shkakun për të cilin ajo kishte vendosur rrëzimin e kërkesës, pavarësisht se vendimi nuk ishte shpallur ende i arsyetuar dhe nuk ishte botuar në Fletoren Zyrtare, pra nuk kishte hyrë në fuqi.

34. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se edhe në këtë drejtim ajo nuk ka pengesë për të marrë në shqyrtim kërkesën, për rrjedhojë kjo çështje hyn në juridiksionin kushtetues dhe pretendimet e subjekteve të interesuara janë të pabazuara.



### B. Për legjitimitimin e kërkesës

35. Neni 131, pika 1, shkronja “ç”, i Kushtetutës, i detajuar në nenet 54–56 të ligjit nr. 8577/2000, parashikon se Gjykata vendos për mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve, të cilat duhet të kenë natyrë kushtetuese dhe të lidhen drejtpërdrejt me ushtrimin e veprimtarisë së organeve brenda secilit pushtet. Gjykata merr në shqyrtim këto konflikte kur subjektet përkatëse e kanë konsideruar veten kompetente për të vendosur për çështje konkrete dhe sipas rastit kanë nxjerrë aktet për rregullimin e saj ose kur subjektet nuk e kanë konsideruar veten kompetente të vendosin në raste të veçanta. Kërkesa duhet të paraqitet brenda 6 muajve nga çasti i lindjes së konfliktit, nga subjektet në konflikt ose nga subjektet e cenuara drejtpërdrejt nga konflikti dhe bazë për fillimin e shqyrtimit përbën çdo lloj akti ligjor ose nënligjor, veprim ose mosveprim i organeve që ka çuar në mosmarrëveshjen e pretenduar të kompetencave. Në të tilla gjykime Gjykata vendos përfundimisht se cili organ i pushtetit është kompetent për zgjidhjen e çështjes konkrete, për të cilën ka lindur mosmarrëveshja, dhe kur ajo është e lidhur me akte ligjore ose nënligjore të nxjerra nga organet palë në konflikt, Gjykata shqyrton edhe kushtetutshmërinë apo ligjshmërinë e aktit.

36. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se pengimi i kompetencës së hetimit që neni 77, pika 2, i Kushtetutës i njeh pakicës parlamentare përbën konflikt kushtetues kompetencash. Vendimi i Kuvendit për mosmiratimin e kërkesës së një të katërtës së deputetëve për ngritjen e komisionit hetimor parlamentar cenon këtë të drejtë kushtetuese të pakicës parlamentare. Situata të tilla, në vlerësimin e Gjykatës, shkaktojnë në realitet një mosmarrëveshje ndërmjet pakicës parlamentare (jo më pak se një e katërta e deputetëve), nga njëra anë, dhe Kuvendit, nga ana tjetër, për ushtrimin e së njëjtës kompetencë kushtetuese (*shih vendimet nr. 57, datë 23.7.2015; nr. 30, datë 16.5.2014; nr. 18, datë 14.5.2003, të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Gjykata vëren, fillimisht, se kërkesa për ngritjen e komisionit hetimor është nënshkruar nga 39 deputetë dhe nga ky numër i përgjithshëm 36 prej tyre kanë nënshkruar kërkesën në shqyrtim, pra përmbushet kërkesa kushtetuese e nenit 77, pika 2, të Kushtetutës në lidhje me numrin e

deputetëve për të vënë në lëvizje Gjykatën (një e katërta e deputetëve ose 35 deputetë). Gjykata vëren, gjithashtu, se kërkuksi ka pretenduar se i është mohuar kompetenca kushtetuese për ngritjen e një komisioni hetimor parlamentar, pasi Kuvendi, me vendimin nr. 80/2021 nuk e ka miratuar kërkesën e pakicës parlamentare të paraqitur për këtë qëllim. Kërkuksi ka kundërshtuar edhe aktin e Kuvendit që, sipas tij, është bërë shkas për lindjen e kësaj mosmarrëveshjeje. Për rrjedhojë, duke qenë se mosmarrëveshja në fjalë ka natyrë kushtetuese dhe kërkuksi është subjekt në konflikt, Gjykata vlerëson se ai legjitimohet *ratione personae*.<sup>2</sup>

38. Në lidhje me afatin për paraqitjen e kërkesës, vendimi i Kuvendit objekt kërkesë është marrë në datën 14.10.2021, ndërsa kërkesa në shqyrtim është paraqitur në Gjykatë në datën 13.4.2022, pra brenda afatit 6-mujor të parashikuar nga neni 55 i ligjit nr. 8577/2000.

39. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuksi, jo më pak se një e katërta e deputetëve, legjitimohet për vënien në lëvizje të juridiksionit kushtetues në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes së kompetencave mes pakicës parlamentare dhe Kuvendit.

### C. Për themelin e kërkesës

40. Kërkuksi ka pretenduar se kërkesa për ngritjen e komisionit hetimor i përmbush kriteret kushtetuese për sa i përket çështjes së veçantë dhe objektit të hetimit parlamentar, që përveç pasojave të rënda ekonomike për shtetin shqiptar dhe qytetarët e tij, lidhet edhe me dy çështje të rëndësishme, siç janë mbrojtja e investimeve të huaja dhe liria e medias, për të cilat është urgjente nxjerrja e përgjegjësive institucionale dhe vlerësimi i nevojës për të ndërhyrë në ligj. Megjithatë, Kuvendi nuk ka bërë asnjë përpjekje ose propozim për të rishikuar objektin e kërkesës, por e ka kaluar atë në procedurën e zakonshme të votimit, duke vendosur mospranimin e kërkesës me pretendimin se cenohet e drejta ndërkombëtare e arbitrazhit, parimi i konfidencialitetit dhe ai i ndarjes e

<sup>2</sup> Gjyqtari Altin Binaj votoi për moslegjitimitimin *ratione personae* të kërkuksit, me argumentin se në rastin konkret subjekti që duhet t'i drejtohet Gjykatës është vetëm një numër prej jo më pak se 35 deputetësh, të cilët kanë votuar edhe në seancë plenare në Kuvend për pranimin e kërkesës për ngritjen e komisionit hetimor.



balancimit të pushteteve, pasi për të njëjtën çështje ekzistojnë procese civile dhe penale. Sipas kërkesit, fakti se një çështje e ngjashme po hetohet nga prokuroria nuk krijon pengesë *apriori* për ngritjen e komisionit hetimor, por është detyrë e komisionit hetimor që, pas ngritjes së tij, të shmangë çdo ndërhyrje në kompetencat e organeve të tjera shtetërore. Në lidhje me pretendimin për shkeljen e së drejtës ndërkombëtare, ai nuk lidhet me parime të natyrës kushtetuese, kurse për sa i takon parimit të konfidencialitetit, kërkohet ruajtja e tij për një vendim që është i aksesueshëm *online* nga kushdo.

41. Subjekti i interesuar, Kuvendi, ka prapësuar se çështjet e grupit të parë të objektit të hetimit, shkronjat “a”-“e”, dalin jashtë kornizës kushtetuese dhe ligjore të Kuvendit dhe vijnë në kundërshtim me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve. Për sa u përket çështjeve të grupit të dytë të objektit të hetimit, shkronjat “f” dhe “g”, ato janë të gjera dhe, mbi të gjitha, nuk krijojnë lidhje organike midis tyre, pasi tentohet të hetohet për çdo lloj investimi të huaj në Shqipëri dhe nuk specifikohet se për cilat investime të huaja bëhet fjalë e për cilën periudhë kohore, çka e bën të pamundur identifikimin e saktë të objektit të hetimit. Nga ana tjetër, hetimi parlamentar do të binte në kundërshtim me detyrimet ndërkombëtare të marra përsipër nga shteti shqiptar, përfshirë ruajtjen e parimit të konfidencialitetit, jo vetëm në lidhje me zbatimin e konventës ICSID në Republikën e Shqipërisë dhe njohjen e autoritetit gjyqësor të arbitrazhit ndërkombëtar, por edhe për sa i përket çështjes “Agonset kundër Shqipërisë” në shqyrtim në GJEDNJ, ku janë depozituar edhe aktet e arbitrazhit. Në kushtet kur vetë GJEDNJ-ja ka vendosur mbajtjen konfidenciale të kësaj çështjeje, kjo duhet të respektohet edhe nga Kuvendi.

42. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar se referuar kërkimeve të objektit të komisionit hetimor, ai del përtej tagrave dhe kompetencave kushtetuese e ligjore të Kuvendit, pasi merren atributet e organit të prokurorisë. Komisioni hetimor do të kishte detyrë verifikimin dhe kontrollin e ligshmërisë së veprimeve ose mosveprimeve të zyrtarëve publikë dhe institucioneve publike, duke verifikuar edhe ndërvarësinë e tyre me veprimet procedurale të ndërmarra nga organet e drejtësisë. Ngritja e këtij

komisioni hetimor me këtë objekt mund të ndikojë në veprimtarinë e organeve të sistemit të drejtësisë (gjykatat dhe prokuroritë), pasi çështja penale ndaj shtetasit Francesco Beccheti është ende në shqyrtim dhe ajo ka përfunduar vetëm në shkallë të parë, ku ai është dënuar me burgim. Kurse dy pikat e fundit të objektit të hetimit janë të gjera dhe të përgjithshme dhe në mungesë të specifikimit të çështjeve objekt hetimi ai mbetet i papërcaktuar në mënyrë të qartë e të saktë. Po kështu, ngritja e komisionit hetimor shkel të drejtën ndërkombëtare dhe parimin e konfidencialitetit, pasi hapja e një procesi hetimor dhe publikimi i të dhënave, ose të një pjese të tyre, do e vendosnin shtetin shqiptar në konflikt me juridiksionet ndërkombëtare në të cilat është palë dhe do çonin në shkelje të detyrimeve ndërkombëtare, gjë që bie në kundërshtim me nenet 5, 116, 121, 122, 123 dhe 180 të Kushtetutës. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit vazhdon të mbetet në fuqi, duke e bërë të pamundur administrimin dhe përdorimin e të dhënave dhe informacioneve të nxjerra në kundërshtim me të.

43. Gjykata vëren se fjalja e parë e pikës 2 të nenit 77 të Kushtetutës parashikon, se: “*Kuvendi ka të drejtë dhe, me kërkesë të një së katërtës së të gjithë anëtarëve të tij, është i detyruar të caktojë komision hetimi për të shqyrtuar një çështje të veçantë*”. Në kuptim të përmbajtjes së kësaj norme, Kuvendi vihet në dy pozicione të ndryshme: nga njëra anë, krijimi i komisionit hetimor paraqitet si një e drejtë e tij, që realizohet sipas procedurave të parashikuara në Kushtetutë dhe në Rregullore; nga ana tjetër, vendoset në një pozicion disi të veçantë, duke i hequr të drejtën për të vlerësuar vendimmarrjen për ngritjen e komisionit hetimor, por njëkohësisht institucionalizon një lloj tjetër autoriteti kushtetues, që njihet si pushtet i pakicës parlamentare. Kushtetuta, duke njohur të drejtën për të ngritur komisione hetimore si e drejtë e një të katërtës së deputetëve për të vepruar në mënyrë të pavarur nga shumica parlamentare, nëpërmjet shprehjes “*është i detyruar*” ka evituar, veçanërisht për ngritjen e komisionit, kalimin e çështjes në procedurat e zakonshme të votimit, duke vendosur një balancë ndërmjet së drejtës së shumicës për të vendosur dhe asaj të pakicës së cilësuar (*shih vendimet nr. 57, datë 23.7.2015; nr. 30, datë 16.5.2014; nr. 20, datë 4.5.2007, të Gjykatës Kushtetuese*).

44. E drejta e pakicës vetëm për sa i përket kërkesës për ngritjen e komisionit hetimor mbetet



një e drejtë e pakufizuar nga vullneti i shumicës. Njëkohësisht, e drejta e pakicës për të disponuar mbi objektin e hetimit e kufizon kompetencën e shumicës për ta ndryshuar këtë objekt pa pëlqimin e pakicës, me përjashtim të rasteve kur nga qëllimi dhe objekti i hetimit konstatohet se preken parimet kushtetuese. Gjithsesi, kjo e drejtë nuk mund të konsiderohet absolutisht e pakufizuar dhe ky kufizim është i lidhur me detyrimin që objekti i hetimit të respektojë parimet dhe standardet kushtetuese, ndër të tjera, veçanërisht ato që lidhen me parimin e ndarjes e balancimit ndërmjet pushteteve, të drejtën për një proces të rregullt ligjor, prezumimin e pafajësisë, paanshmërinë dhe respektimin e jetës private të individit (*shih vendimet nr. 22, datë 5.5.2010; nr. 20, datë 4.5.2007; nr. 18, datë 14.5.2003, të Gjykatës Kushtetuese*).

45. Në një shtet të së drejtës, Kuvendi, në ushtrim të kompetencave të tij kushtetuese kryen funksionet klasike të miratimit të ligjeve (funksioni legjislativ), të kontrollit parlamentar, kryesisht ndaj pushtetit ekzekutiv, por edhe ndaj institucioneve të tjera (funksioni i kontrollit), të emërimit dhe shkarkimit të krerëve të institucioneve kryesore kushtetuese (funksioni emërues), të miratimit të buxhetit të shtetit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të tij (funksioni financiar). Në aspektin kushtetues komisioni hetimor është një nga instrumentet e kontrollit me anë të të cilit Kuvendi ushtron dhe perfeksionon pushtetin e tij legjislativ. Kontrolli parlamentar nënkupton të drejtën e pushtetit legjislativ për t'u informuar dhe për të realizuar mbikëqyrjen për zbatimin e ligjeve nga organet e pushtetit publik, me qëllim marrjen e masave të domosdoshme për parandalimin e paligjshmërisë, si dhe nxjerrjen e përgjegjësive konkrete (*shih vendimin nr. 18, datë 14.5.2003, të Gjykatës Kushtetuese*). Qëllimi i ngritjes së komisioneve hetimore është njohja dhe verifikimi i një fenomeni, i një ngjarjeje apo i një veprimtarie, me synimin për të nxjerrë përfundime mbi nevojën e miratimit, plotësimit apo korrigimit të ligjeve të veçanta, si dhe për të nxjerrë përgjegjësinë për mënyrën e qeverisjes (*shih vendimet nr. 57, datë 23.7.2015; nr. 30, datë 16.5.2014; nr. 22, datë 5.5.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

46. Ushtrimi i funksionit të hetimit parlamentar nuk mund të realizohet duke ndërhyrë në veprimtarinë e organeve të pavarura, pasi natyra e hetimit parlamentar nuk është e njëjlojtë dhe nuk mund të barazohet me hetimin që realizojnë në

bazë të ligjit organet e tjera të pavarura ose të specializuara për kryerjen e një funksioni të tillë. Në këtë kuptim nuk mund të konsiderohet se është në përputhje me parimet kushtetuese një hetim i iniciuar që nuk i përket veprimtarisë së legjislativit dhe qëllimeve të tij, pasi ky instrument i rëndësishëm nuk mund të përdoret në mënyrë abuzive dhe tej hapësirës kontrolluese që Kushtetuta i njeh Kuvendit (*shih vendimet nr. 30, datë 16.5.2014; nr. 22, datë 5.5.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

47. Në aspektin kushtetues është e lejueshme përdorimi i këtij mjeti kontrolli kurdo që vlerësohet se duhet të hetohet një “*çështje e veçantë*”, sipas nenit 77, pika 2, të Kushtetutës, kuptimin e së cilës Gjykata e ka analizuar brenda konceptit të funksionit të kontrollit parlamentar dhe të së drejtës së pakicës parlamentare, duke vlerësuar se ajo nënkupton të gjitha ato çështje që përfshihen brenda këtij funksioni dhe që përmbajnë në vetvete një interes publik. Në parim “*çështja e veçantë*”, objekt i hetimit parlamentar, është një çështje me rëndësi të veçantë shtetërore/publike. Edhe pse lista e çështjeve me interes publik nuk mund të jetë shteruese, pasi interesi publik kuptohet në sensin relativ, në varësi të situatave të ndryshme që krijohen, Gjykata ka vlerësuar se çështjet e verifikimit të zbatueshmërisë së legjislacionit, të formulimit të propozimeve ose iniciativave ligjore, që kanë për qëllim frenimin dhe parandalimin e fenomeneve negative për shoqërinë e shtetit, janë të përfshira në konceptin kushtetues “*çështje e veçantë*” (*shih vendimin nr. 18, datë 14.5.2003, të Gjykatës Kushtetuese*).

48. “*Një çështje*” që në aspektin kushtetues mund t'i nënshtrohet hetimit parlamentar, përbëhet nga fakte apo rrethana të cilat përfshihen në objektin e veprimtarisë së Kuvendit dhe për të cilat ekziston një mosmarrëveshje. Në këtë kuptim, çështja duhet të ketë ndodhur përpara marrjes së një vendimi përkatës nga ana e Kuvendit për ngritjen e një komisioni hetimor. Komisioni hetimor parlamentar ngrihet kur ekziston në fakt një çështje në kuptimin kushtetues dhe jo për të verifikuar nëse mund të zbulohet ose të gjendet ndonjë e tillë në të ardhmen (*shih vendimet nr. 57, datë 23.7.2015; nr. 22, datë 5.5.2010; nr. 20, datë 4.5.2007, të Gjykatës Kushtetuese*).

49. Gjykata rithekson rëndësinë themelore që ka përcaktimi i “*çështjes/ve*” që do të jenë objekt i





hetimit. Përcaktimi i ekzistencës së një çështjeje që kërkon verifikim dhe vlerësim, si parakusht për ngritjen e një komisioni, duhet të kryhet në një mënyrë objektive. Për këtë qëllim, objekti i hetimit duhet të përmbajë fakte të përcaktueshme ose kompleks faktesh, të cilat të tregojnë se për çfarë po hetohet, pasi në këtë mënyrë ai evidenton edhe çështjen e veçantë. Identifikimi i subjekteve dhe objektit të veprimtarisë hetimore të komisionit është një kërkesë *sine qua non* për të përcaktuar saktësisht çështjet që duhet të adresojë komisioni ose për të vlerësuar nëse duhet të ndërmerret apo jo një hetim për këtë çështje. “Çështja e veçantë”, në kuptim të nenit 77 të Kushtetutës, përbëhet nga një sërë rrethanash, të cilat përcaktojnë objektin e interesit të Kuvendit dhe që duhet të specifikohen në vendimin e Kuvendit për ngritjen e një komisioni hetimor (*shih vendimet nr. 12, datë 20.5.2008; nr. 20, datë 4.5.2007, të Gjykatës Kushtetuese*).

50. Për sa më sipër, për zhvillimin e një hetimi parlamentar duhet të përmbushen të paktën këto kushte kryesore: hetimi i çështjes duhet të synojë sigurimin e një informacioni që është në funksion të procesit ligjvënës ose që u shërben funksioneve të tjera për të cilat është i autorizuar Kuvendi dhe objekti i hetimit duhet të përqëndrohet në një çështje të veçantë (duhet të ekzistojnë të dhëna ose indicie të mjaftueshme që dëshmojnë për ekzistencën e një çështjeje të një interesi të veçantë publik, për të cilën është i nevojshëm ky hetim) (*shih vendimin nr. 20, datë 4.5.2007, të Gjykatës Kushtetuese*).

51. Në kuptim të rëndësisë së çështjes së veçantë shtetërore/publike, Gjykata ka vlerësuar se është kompetencë e Kuvendit, në rastin konkret e pakicës parlamentare, të vlerësojë interesin publik për çështjet që kërkon të hetohen (*shih vendimin nr. 30, datë 16.5.2014, të Gjykatës Kushtetuese*). Kur ka një çështje të veçantë, domethënë një çështje të një rëndësie të veçantë publike, Kushtetuta nuk e ndalon Kuvendin që, në funksion të veprimtarisë së tij ligjvënëse, të ngrejë komisione hetimi, të tilla që mund të ngarkohen me hetimin e aktivitetit të shtetit ose institucioneve të qeverisjes vendore, pra për mënyrën si kryejnë institucionet përkatëse shtetërore ose vendore funksionet e tyre të përcaktuara në Kushtetutë dhe ligje (*shih vendimet nr. 22, datë 5.5.2010; nr. 20, datë 4.5.2007, të Gjykatës Kushtetuese*).

52. Gjykata, duke iu rikthyer çështjes konkrete në shqyrtim, konstaton se si gjatë diskutimeve në Konferencën e Kryetarëve, ashtu edhe në seancën plenare në Kuvend, palët kanë ndarë qëndrime të ndryshme për përshtatshmërinë kohore të ngritjes së komisionit hetimor dhe për sa i përket objektit të hetimit. Në përfundim shumica parlamentare ka vendosur mosmiratimin e ngritjes së komisionit hetimor, duke konsideruar se kërkesa e pakicës: i. bie në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare, pasi cenon parimin e konfidencialitetit të këtij procesi arbitrazhi që është detyruar për Republikën e Shqipërisë; ii. cenon parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve për arsye se për të njëjtën çështje ekzistojnë edhe procese penale dhe civile në të drejtën e brendshme, si dhe iii. dëmton në mënyrë të drejtpërdrejtë interesat e Republikës së Shqipërisë në lidhje me një procedurë akoma në proces.

53. Për rrjedhojë, në vijim të kritereve kushtetuese të lartpërmendura, të përcaktuara nga norma dhe jurisprudenca kushtetuese, Gjykata do të vlerësojë nëse shkaqet e referuara nga shumica parlamentare janë të natyrës kushtetuese dhe nëse ato mund të përbëjnë pengesë për ngritjen e komisionit hetimor, duke analizuar secilën në veçanti.

*C.1. Për parimin e zbatimit të së drejtës ndërkombëtare në drejtim të konfidencialitetit*

54. Gjykata, bazuar në aktet e procedurave parlamentare, vëren se pakica parlamentare ka paraqitur 3 kërkesa për ngritjen e komisioneve hetimore për çështje të ndryshme, përfshirë atë objekt i këtij gjykimi. Në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve të datës 4.10.2021 është diskutuar dhe është rënë dakord që për secilin komision të caktohen personat përgjegjës për të diskutuar e sqaruar disa prej çështjeve të lidhura me objektin e këtyre komisioneve në përputhje me jurisprudencën kushtetuese, në mënyrë që në seancën e datës 14.10.2021 të gjendej formulimi i saktë i objektit të projektvendimit që do t'i propozohej seancës. Në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve të datës 12.10.2021, të pranishmit janë informuar në lidhje me shkresën nr. 2282 prot., datë 6.10.2021 të Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit, me anë të së cilës është kërkuar mosngritja e komisionit hetimor për çështjen “Becchetti” ose shtyrja e ngritjes së tij pas shterimit të mjeteve të mbrojtjes dhe përfundimit të



proceseve gjyqësore ndërkombëtare. Avokatura e Shtetit ka sjellë në vëmendje edhe se në GJEDNJ është duke u zhvilluar një proces gjyqësor, me aplikant shoqërinë “Agonset” sh.p.k., në kuadër të të cilit janë paraqitur dokumente të prodhuara nga procesi i arbitrazhit dhe është kërkuar që të mos publikohen, duke qenë se ai proces karakterizohet nga konfidencialiteti. Avokatura e Shtetit ka shprehur shqetësimin se investimi i Kuvendit për ngritjen e këtij komisioni hetimor parlamentar do të shfrytëzohej si një provë thelbësore në favor të aplikantit për të treguar, si në proceset ekzistuese, ashtu edhe në ato potenciale, se Republika e Shqipërisë ka shkelur detyrimet ndërkombëtare.

55. Gjatë kësaj mbledhjeje, përfaqësuesi i shumicës parlamentare është shprehur në mbështetje të kërkesës së Avokaturës së Shtetit, me qëllim mbrojtjen e interesave të vendit, si dhe për të parandaluar dëmet eventuale që mund t'i vijnë shtetit nga çfarëdolloj forme ekspozimi të informacionit dhe të të dhënave, në situatën që komisionet hetimore do të duhet të disponojnë dokumentacionin, apo edhe të keqpërdorimit të mundshëm nga palët. Për rrjedhojë, është propozuar ngritja e këtij komisioni hetimor në një moment të dytë gjatë mandatit të këtij Kuvendi. Ndërsa përfaqësuesit e pakicës parlamentare janë shprehur se vendimi i arbitrazhit ka marrë formë të prerë, pra komisioni hetimor lidhet me një procedurë gjykimi arbitrazhi që ka përfunduar, për të cilën kërkohet të nxirren përgjegjësitë në lidhje me mënyrën se si organet e pushtetit ekzekutiv kanë kryer detyrat e tyre në mbrojtje të interesit të shqiptarëve dhe se cilët janë personat që kanë sjellë dëmin financiar për qytetarët shqiptarë. Ata kanë mbajtur qëndrimin se funksioni kontrollues i Kuvendit nuk mund të kufizohet nga një kërkesë e Avokaturës së Shtetit për ruajtjen e konfidencialitetit, por vetëm nga Kushtetuta dhe ligji (*shih faqet 6–12 të procesverbalit të mbledhjes*).

56. Në seancën plenare të Kuvendit të datës 14.10.2021, përfaqësuesi i shumicës parlamentare është shprehur, në thelb, se të gjitha proceset ku Republika e Shqipërisë është palë në juridiksionet ndërkombëtare dhe që kanë lidhje të drejtpërdrejtë ose jo me objektin e kërkesës për hetim, janë konfidenciale, rrjedhimisht të dhënat që rrjedhin apo janë prodhuar prej tyre nuk mund të bëhen publike. Për sa kohë që konfidencialiteti i këtyre proceseve është detyrues, bazuar në konventat

ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar, çdo shkelje e tij përfaqëson shkelje të së drejtës ndërkombëtare dhe përbën rrezik serioz e të konsiderueshëm financiar për interesat e shtetit dhe jo vetëm. Po kështu, është pretenduar se kërkesa për ngritjen e komisionit hetimor shkel edhe parimet e ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve, shtetit të së drejtës dhe atij të prezumimit të pafajësisë, pasi jo vetëm në disa juridiksione ndërkombëtare të huaja, por edhe brenda vendit, ka procese penale dhe civile që nuk kanë përfunduar ende dhe ngritja e komisionit do të ndikonte negativisht në zhvillimin dhe mbarëvajtjen e tyre me pasoja për shtetin shqiptar. Në SPAK është paraqitur një kallëzim penal nga Partia Demokratike me objekt të njëjtë me atë të komisionit hetimor, ndaj ngritja e tij do të shkaktonte jo vetëm ndikim negativ në mbarëvajtjen e proceseve penale, por edhe mbivendosje dhe uzurpim kompetencash kushtetuese (*shih faqet 63 dhe 64 të procesverbalit të seancës plenare*).

57. Përfaqësuesi i pakicës parlamentare, në prapësim të qëndrimit të shumicës, ka parashtruar se Avokatura e Shtetit, si organ i pushtetit ekzekutiv, nuk mund t'i kërkojë Parlamentit të mos ushtrojë kompetencat e veta kushtetuese. Hetimi i komisionit hetimor ka për qëllim të mbrojë interesin publik jo ta cenojë atë dhe hetimi parlamentar ka qëllime të ndryshme nga hetimi penal ose proceset gjyqësore dhe ato nuk mund të pengojnë njëra-tjetrën. Procesi në arbitrazh ka përfunduar dhe ka nisur ekzekutimi i detyrimit, ndërsa proceset e tjera në arbitrazh dhe në GJEDNJ nuk kanë lidhje me kërkesën për këtë komision hetimor, ndërkohë që nuk është urdhëruar konfidencialiteti për vendimin për të cilin është kërkuar ngritja e këtij komisioni hetimor (*shih faqet 66 dhe 67 të procesverbalit të seancës plenare*).

58. Në këtë seancë plenare Kuvendi, me vendimin nr. 80/2021, ka vendosur të mos e miratojë kërkesën e një grupi deputetësh, përfaqësues të pakicës parlamentare, për ngritjen e komisionit hetimor “Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve dhe mosveprimeve të institucioneve shtetërore dhe funksionarëve publikë në çështjet që kanë sjellë si pasoje vendimin e arbitrazhit ‘Beccchetti dhe të tjerë kundër Shqipërisë’”.

59. Gjykata, vlerëson fillimisht të theksojë detyrimin e shtetit shqiptar për zbatimin e së drejtës



ndërkombëtare mbështetur në nenin 5 të Kushtetutës. Detyrimi i institucioneve shtetërore për të zbatuar në mënyrë efektive konventat ndërkombëtare të ratifikuara me ligj buron jo vetëm nga statusi i së drejtës ndërkombëtare në rendin juridik vendas, por edhe nga angazhimet për mbrojtjen e të drejtave në mënyrë konkrete dhe efektive (*shih vendimet nr. 17, datë 15.3.2016; nr. 24, datë 21.4.2014, të Gjykatës Kushtetuese*). Kushtetuta në nenet 116 dhe 122 i radhit marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, të cilat përbëjnë pjesë të sistemit të brendshëm juridik, në hierarkinë e akteve normative që kanë fuqi përpara ligjeve. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të. Gjithashtu, Gjykata ka theksuar se në sferën e zbatimit të traktateve ndërkombëtare gjen zbatim parimi *pacta sunt servanda*, sipas të cilit çdo traktat në fuqi është detyrues për palët dhe duhet të zbatohet prej tyre në mirëbesim dhe parimi se një palë nuk mund të përdorë dispozitat e së drejtës së brendshme si justifikim për pamundësinë e saj për të zbatuar një traktat (*shih vendimin nr. 15, datë 15.4.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

60. Gjykata vëren se parimi i zbatimit të së drejtës ndërkombëtare, në drejtim të konfidencialitetit, ka qenë objekt i debateve parlamentare, duke u fokusuar vetëm në çështjen nëse ai lejon ngritjen e një komisioni hetimor, ndërkohë që palët nuk kanë vënë në diskutim nëse ky parim mund të gjejë zbatim gjatë fazave të tjera të veprimtarisë hetimore, pra gjatë ushtrimit të kompetencave të komisionit hetimor sipas parashikimeve ligjore përkatëse.

61. Gjykata Kushtetuese Federale, për sa i përket zbatimit të parimit të konfidencialitetit gjatë kontrollit parlamentar të shërbimeve të inteligjencës, ka vlerësuar se ai mund të përdoret si shkak për të refuzuar pyetjen si dëshmitarë përpara një komisioni hetimor parlamentar, për arsye të rëndësishme që burojnë nga interesat e sigurisë së shtetit. Arsyet specifike duhet të jepen paraprakisht, duke vërtetuar ekzistencën e rrethanave të veçanta që mund të justifikojnë dhënien dhe respektimin e këtyre garancive të konfidencialitetit të pakushtëzuar. Komisionet hetimore mund të marrin në pyetje dëshmitarët dhe, kur është e nevojshme, t'i detyrojnë ata të japin dëshmi duke përdorur masat shtrënguese të parashikuara në dispozitat penale. Por në rastet kur ata u

nënshtrohen detyrimeve të veçanta të konfidencialitetit, është e lejueshme të pyeten si dëshmitarë vetëm nëse, si dhe në masën që është e lejueshme si përjashtim nga detyrimi i konfidencialitetit. Megjithatë, nëse qeveria mbrohet me të drejtën e saj për të refuzuar që të dorëzojë prova para një komisioni hetimor bazuar në ligjin kushtetues, ajo ka detyrimin që t'i deklarojë këto arsye, duke qenë se ka detyrimin që t'i mundësojë parlamentit ushtrimin në mënyrë efektive të funksionit të mbikëqyrjes së veprimeve të ekzekutivit. Kjo i lejon parlamentit të vlerësojë nëse do ta pranojë këtë refuzim ose të përcaktojë hapat e mëtejshëm të nevojshëm në lidhje me kërkesën e tij për informacion. Për këtë qëllim, parlamenti duhet të jetë në gjendje të vlerësojë nëse balancimi që qeveria i ka bërë interesave të prekura, që ka çuar në refuzimin e dhënies së informacionit, është i besueshëm dhe i kuptueshëm (*shih vendimin 2 BvE 4/18, datë 16.12.2020, të Gjykatës Kushtetuese Federale të Gjermanisë*).

62. Gjykata vëren se e drejta e pakicës parlamentare për të kërkuar ngritjen e një komisioni hetimor është një nga të drejtat më kryesore të saj. Në vijim të së drejtës për të drejtuar interpelanca dhe pyetje ndaj kabinetit qeveritar, si dhe për t'u informuar, e drejta e hetimit parlamentar lejon hetimin e fakteve dhe rrethanave që përbëjnë bazat e nevojshme për vendimmarrjen e Kuvendit dhe lejon që ai të ushtrojë në mënyrë efektive jo vetëm funksionin ligjvënës, por edhe atë të kontrollit mbi qeverinë. Në këtë kuptim një komision hetimor, si një mjet kontrollues, është një instrument specifik i kontrollit parlamentar. Nga ana tjetër, e drejta për të kërkuar akte dhe dokumente i përket thelbit të së drejtës së hetimit dhe formon pjesë integrale të së drejtës së kontrollit parlamentar. Megjithatë, kjo e drejtë e komisionit hetimor për të mbledhur prova mund t'u nënshtrohet kufizimeve, të cilat, përfshirë ato që parashikohen nga ligji i posaçëm për funksionimin dhe organizimin e komisioneve hetimore, duke pasur parasysh që e drejta e pakicës për të kërkuar ngritjen e një komisioni hetimor është një e drejtë e nivelit kushtetues, duhet, gjithashtu, të gjejnë mbështetje në ligjin kushtetues.

63. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se konventa ICSID dhe rregullat e arbitrazhit në vetvete nuk përmbajnë një prezumim të përgjithshëm të parimit të konfidencialitetit, por janë palët që përshtatin



nivelin e konfidencialitetit ose transparencës në procedurat e tyre. Kështu, neni 48, pika 5, i konventës ICSID parashikon se qendra nuk do të publikojë vendimin (“Award”) pa pëlqimin e palëve. Ato mund të bien dakord për informacionin dhe dokumentet që dëshirojnë t’i mbajnë konfidenciale. Gjykata vëren se në momentin e paraqitjes së kërkesës për ngritjen e komisionit hetimor veprime të caktuara të organeve të drejtësisë shqiptare në lidhje me sekuestrimin e asetëve ishin kundërshtuar nga Becchetti dhe të tjerë në GJEDNJ, por në atë kohë ky proces nuk kishte përfunduar ende. Ndërkohë, sipas të dhënave të publikuara në faqen zyrtare të ICSID-it, vendimi i arbitrazhit nuk është publik [[Award \(Not public\)](#)] dhe shteti shqiptar ka ndërmarrë disa hapa të tjerë proceduralë që kanë të bëjnë me procedurat e rishikimit dhe anulimit të tij, sipas konventës dhe rregullave të saj.

64. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se fakti që çështje të caktuara mes palëve private dhe shtetit shqiptar janë për shqyrtim në juridiksione të tjera ndërkombëtare, në të cilat, me kërkesë të palëve, është urdhëruar zbatim i parimit të konfidencialitetit, nuk mund të përbëjë kriter pengues për ngritjen e komisionit hetimor, i cili ka natyrë dhe qëllim të ndryshëm dhe nuk synon të hetojë, të zgjidhë ose vendosë për çështjet që janë objekt i këtyre proceseve dhe as të vendosë për çështje që zgjidhen sipas së drejtës ndërkombëtare apo për detyrime të marra përsipër sipas kësaj të drejte. Në këtë kuptim, kriteri i konfidencialitetit jo vetëm që nuk është një detyrim i rangut kushtetues, por në rastin konkret ai nuk rezulton si një detyrim i përgjithshëm që ka lindur sipas së drejtës ndërkombëtare të detyrueshme për zbatim. Gjykata vlerëson se detyrimi i shtetit për zbatimin e së drejtës ndërkombëtare sipas nenit 5 të Kushtetutës, nuk passjell ndonjë detyrim të po këtij rangu për mënyrën e ushtrimit të funksioneve kushtetuese nga organet e pushtetit publik në lidhje me konfidencialitetin.

65. Gjykata ka vlerësuar se Kuvendi ia nënshtron diskutimit parlamentar shkallën e respektimit të parimeve kushtetuese në objektin e veprimtarisë së propozuar. Ky debat realizohet me qëllim gjetjen e një konsensusi ndërmjet palëve lidhur me objektin e hetimit, deri në arritjen e një vendimmarrje. Kufizimi që mund t’i bëhet objektit të hetimit me argumentin se nuk respektohen

parimet kushtetuese, nuk e bëjnë një vendimmarrje të tillë përfundimtare dhe të pakontrollueshme nga pikëpamja e kushtetutshmërisë për arsye se do ta vendoste të drejtën kushtetuese të pakicës parlamentare në vlerësimin e shumicës, duke dhunuar në këtë mënyrë ushtrimin normal të kësaj të drejte (*shtih vendimet nr. 38, datë 12.6.2015; nr. 30, datë 16.5.2014; nr. 18, datë 14.5.2003, të Gjykatës Kushtetuese*).

66. Në rastin konkret nga ana e shumicës parlamentare është pretenduar se zbatimi i parimit të konfidencialitetit lidhet me përmbajtjen e vendimit të arbitrazhit, të dhënat e pasqyruara në të cilin janë bërë pjesë edhe e çështjeve që ndodhen për shqyrtim në GJEDNJ, shqyrtim ky që në atë kohë nuk kishte përfunduar dhe ajo gjykatë nuk kishte arritur ende në një vendimmarrje. Për rrjedhojë, këto pretendime nuk i përkasin fazës së ngritjes së komisionit hetimor, pra shqyrtimit të kërkesës në Kuvend, por veprimtarisë së komisionit hetimor dhe kanë të bëjnë me natyrën e të dhënave që mund të bëhen objekt hetimi nga ai komision.

67. Sipas parashikimeve të ligjit nr. 8891/2002, komisioni hetimor ka të drejtë të mbledhë të dhëna që mund të jenë informacione zyrtare dhe jozyrtare, të administrojë dokumente zyrtare si dhe të dhëna të tjera, të thërrasë dëshmitarë, ekspertë, titullarë institucionesh për pyetje, si dhe të kërkojë nga ata informacione ose dokumente zyrtare (nenet 14–18). Gjykata vlerëson se në ushtrimin e kësaj veprimtarie, gjatë kërkesave për paraqitjen e dokumenteve ose të dhënave, nëse ka të dhëna konfidenciale gjejnë zbatim rregullat e legjislacionit në fuqi.

68. Bazuar në këto konsiderata, Gjykata vlerëson se në zbatim të së drejtës ndërkombëtare konfidencialiteti në vetvete nuk mund të përbëjë dhe të shërbejë si argument kushtetues për të kufizuar të drejtën e pakicës parlamentare për të kërkuar ngritjen e komisionit hetimor dhe se Kuvendi nuk mund të justifikohet me zbatimin e këtij parimi për mospranimin e kërkesës për ngritjen e një komisioni hetimor.<sup>3</sup>

<sup>3</sup> Mbjatjen qëndrimin se kriteri i konfidencialitetit përbën pengesë për ngritjen e komisionit hetimor gjyqtarët Altin Binaj dhe Sandër Beci.



### C.2. Për parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve

69. Kërkuesi ka parashtruar se Kuvendi nuk ka bërë përpjekje ose propozime për të rishikuar objektin e kërkesës, por e ka kaluar kërkesën në procedura të zakonshme votimi, pa ia nënshtruar një analize të thelluar shkallën e respektimit të parimeve kushtetuese në veprimtarinë e komisionit hetimor dhe se objekti i veprimtarisë së komisionit hetimor nuk mbivendoset me veprimtarinë e prokurorisë, sepse ai përjashton shprehimisht mundësinë e ngritjes së akuzave ose marrjen e personave si të pandehur.

70. Subjektet e interesuara kanë prapësuar se shkelet parimi i ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve, pasi për të njëjtat çështje që janë propozuar si objekt i hetimit është paraqitur një kallëzim penal dhe ka procese gjyqësore në shqyrtim, për rrjedhojë me këtë veprimtari komisioni hetimor do të marrë kompetencat kushtetuese të prokurorisë dhe gjykatës. Gjithashtu ato kanë argumentuar se grupi i parë i çështjeve objekt hetimi (shkronjat “a”–“e”) dalin jashtë kornizës kushtetuese dhe ligjore të Kuvendit dhe janë në kundërshtim me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, ndërsa çështjet e grupit të dytë të objektit të hetimit (shkronjat “f” dhe “g”) janë shumë të gjera dhe nuk krijojnë lidhje organike midis tyre, pasi tentohet të hetohet për çdo lloj investimi të huaj në Shqipëri e nuk specifikohet se për cilat investime të huaja bëhet fjalë dhe për cilën periudhë kohore, çka e bën të pamundur identifikimin e saktë të objektit të hetimit.

71. Gjykata, në shqyrtimin e funksionit kushtetues të Kuvendit dhe rolin e komisionit parlamentar hetimor, merr parasysh faktin se Kushtetuta nuk i njeh epërsi një pushteti ose organi kushtetues në raport me pushtetet e tjera të shtetit. Në bazë të parimit të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve, asnjë organ ose institucion tjetër, në përbërje ose jo të njërit prej tri pushteteve, nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve, që, sipas rastit, do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera kushtetuese (*shih vendimet nr. 22, datë 5.5.2010; nr. 12, datë 20.5.2008; nr. 19, datë 3.5.2007, të Gjykatës Kushtetuese*). Veprimtaria e një komisioni hetimor nuk duhet as të zëvendësojë, as të marrë kompetencat e organeve të cilat, në bazë të Kushtetutës, janë të detyruara ta realizojnë këtë kompetencë. Komisioni hetimor, duke hetuar një

fushë të caktuar brenda kompetencave që përfshihen në përgjegjësinë kushtetuese të Kuvendit, mund të arrijë të gjejë të dhëna, të cilat përbëjnë shkak për t'u vlerësuar nga ana e tij, por pa hyrë në sferën e organeve hetimore e gjyqësore të ngarkuara nga Kushtetuta për veprimtari të këtij lloji (*shih vendimin nr. 12, datë 20.5.2008, të Gjykatës Kushtetuese*).

72. Gjykata rithekson se, për qëllim të vlerësimit nëse respektohet kriteri kushtetues i ndarjes dhe balancimit të pushteteve, identifikimi i objektit të veprimtarisë hetimore të komisionit parlamentar është parakusht për të përcaktuar nëse duhet ose jo të ndërmerret një hetim i tillë (*shih vendimin nr. 30, datë 16.5.2014, të Gjykatës Kushtetuese*). Kuvendi, kur cakton një komision hetimor, duhet të respektojë parimin kushtetues të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve dhe limitet kushtetuese të kontrollit parlamentar, të cilat nuk lejojnë që ky kontroll të ushtrohet për çdo çështje dhe për çdo organ. Nga ana tjetër, objekti i kontrollit parlamentar duhet të jetë i tillë që të mos çojë në shkeljen e rregullimeve kushtetuese që kanë të bëjnë me marrëdhëniet me organet e tjera (*shih vendimin nr. 22, datë 5.5.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

73. Për qëllime të vlerësimit nëse në rastin konkret është respektuar parimi i ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve, Gjykata, në përputhje me jurisprudencën e saj për kriteret që duhet të respektohen gjatë ngritjes së komisionit hetimor dhe kompetencat e kufizuara që ai disponon, u ndal në verifikimin nëse, referuar qëllimit dhe objektit të propozuar nga pakica parlamentare, plotësohet kriteri i “çështjes së veçantë” dhe më tej nëse, referuar pikave të veçanta të tij, objekti është i përcaktuar në mënyrë të mjaftueshme në kuptim të kërkesave të qartësisë dhe saktësisë.

#### C.2.1 Për kriterin “çështje e veçantë”

74. Gjykata ka theksuar se kushtetutshmëria e objektit të hetimit parlamentar varet gjithashtu nga prania apo përfshirja në të e konceptit kushtetues “çështje e veçantë” si edhe nga metodat dhe instrumentet që i vihen në dispozicion komisionit për të realizuar qëllimin për të cilin është krijuar (*shih vendimin nr. 20, datë 4.5.2007, të Gjykatës Kushtetuese*).

75. Në kërkesën për ngritjen e komisionit hetimor konstatohet se është përcaktuar se ai ka për qëllim kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve



dhe mosveprimeve të institucioneve shtetërore dhe funksionarëve publikë dhe pasojave të tyre në dhënien e vendimit të gjykatës së arbitrazhit. Sipas pakicës parlamentare, nëpërmjet veprimeve dhe mosveprimeve të paligjshme të organeve të pushtetit ekzekutiv i është shkaktuar një dëm shumë i madh buxhetit të shtetit dhe ky hetim synon marrjen e masave dhe nxjerrjen e rekomandimeve për organet kompetente që personat përgjegjës të procedohen sipas ligjit, si dhe të merren masat e përshtatshme që raste të tilla të mos përsëriten në të ardhmen.

76. Konkretisht, Gjykata vëren se referuar kërkesës së pakicës parlamentare, si qëllim për krijimin e komisionit hetimor, është përcaktuar: *“Kontrolli i ligjshmërisë së veprimeve dhe mosveprimeve të institucioneve shtetërore dhe funksionarëve publikë në çështjet që kanë sjellë si pasojë vendimin e arbitrazhit ‘Becchetti dhe të tjerë kundër Shqipërisë’, për të cilën Qendra për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve Ndërkombëtare pranë Bankës Botërore ka vendosur detyrimin e shtetit shqiptar t’i paguajë sipërmarrësit Becchetti dhe ortakëve të tij një shpërblim prej mbi 120 milionë euro, përfshirë interesat dhe shpenzimet gjyqësore.”*. Kurse si objekt i veprimtarisë së komisionit hetimor është propozuar: a) verifikimi i ligjshmërisë së veprimeve të Kryeministrit, Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, sekretarit të përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, si dhe funksionarëve të tjerë publikë; b) verifikimi i ndërvarësisë së këtyre veprimeve me veprimet procedurale të marra nga organet e drejtësisë, të cilat kanë kulmuar me sekuestrimin e Agonset; c) verifikimi i veprimeve dhe mosveprimeve të Agjencisë për Administrimin e Aseteve të Sekuestruara, të cilat kanë sjellë shkatërrimin e plotë të Agonset; d) verifikimi i veprimeve dhe mosveprimeve të organeve kompetente relevante për sa i përket mosdhënies së informacioneve të kërkuara nga INTERPOL; e) dëmi ekonomik që i shkaktohet buxhetit të shtetit nga ky vendim; f) pasojat e rënda mbi investimet e huaja dhe lirinë e medias në Shqipëri; g) vlerësimi i nevojës për marrjen e masave të përshtatshme për një mbrojtje më të mirë të investimeve të huaja dhe lirisë së medias, duke shmangur edhe rrezikun potencial për gjoba të larta ndaj shtetit shqiptar.

77. Bazuar në qëllimin e evidentuar nga pakica parlamentare, si dhe nga tërësia e fakteve dhe subjekteve të përcaktuara në objektin e hetimit, Gjykata vlerëson se ato arrijnë të evidentojnë

çështjen e veçantë për të cilën kërkohet të ndërmerret ky hetim, pasi mbartin interesin publik dhe plotësojnë kërkesën e të qenit me natyrë shtetërore/publike. Me fjalë të tjera, objekti i hetimit fokusohet në një çështje konkrete, që lidhet me veprimet ose mosveprimet që kanë sjellë për pasojë një vendim arbitrazhi në dëm të shtetit shqiptar, proces që ka përfunduar dhe ka sjellë pasoja konkrete përpara paraqitjes së kërkesës për ngritjen e komisionit hetimor. Prandaj, çështja objekt hetimi përbën një çështje të veçantë, në kuptim të nenit 77, pika 2, të Kushtetutës.<sup>4</sup>

*C.2.2 Për kriterin e qartësisë së objektit të komisionit hetimor*

78. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se objekti i hetimit të komisionit hetimor duhet, gjithashtu, të plotësojë kriterin e saktësisë dhe të mosdykuptimësisë. Formulimi i objektit të veprimtarisë së komisioneve hetimore në mënyrë të paqartë është i palejueshëm në një shtet demokratik të së drejtës, pasi përbën një kërcënim real për shkeljen e parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe për një ndërhyrje të tepruar në sferën e kompetencave të organeve të tjera shtetërore (*shih vendimin nr. 22, datë 5.5.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

79. Objekti i veprimtarisë së komisionit hetimor duhet të jetë i përcaktuar, i specifikuar dhe i kuptueshëm për të gjitha subjektet e mundshme, të detyruara të paraqiten përpara komisionit, ose të cilat detyrohen të paraqesin dokumentet e informacionet përkatëse të kërkuara nga komisioni. Vetëm atëherë është i mundur përcaktimi në mënyrën e duhur i situatës së një çështjeje të caktuar, e cila, nga ana e saj, përbën një kërkesë për përmbushjen korrekte të një detyre që i është ngarkuar komisionit (*shih vendimet nr. 12, datë 20.5.2008; nr. 20, datë 4.5.2007, të Gjykatës Kushtetuese*).

80. Në lidhje me këtë pretendim, qëndrimet e gjyqtarëve ishin të ndryshme. Kështu, sipas njërit

<sup>4</sup> Votuan se objekti i hetimit të komisionit hetimor nuk plotëson kriterin kushtetues të veçantisë së çështjes gjyqësore: Altin Binaj, Sandër Beci, Ilir Toska dhe Genti Ibrahim.

Gjyqtari Ilir Toska për këtë shkak mbajti qëndrimin se nuk mund të vijohet më tej me analizën e përmbushjes së kriterëve të tjera kushtetuese dhe se kërkesa duhet të rrëzohet.



qëndrim u vlerësua se objekti i propozuar i hetimit të komisionit hetimor nuk plotëson kërkesat e qartësisë dhe përcaktueshmërisë dhe nuk është i argumentuar qartë dhe në mënyrë të mjaftueshme në lidhje me faktet e përcaktueshme ose ato komplekse faktesh që tregojnë qartë se për çfarë do të hetohet, çka vë në dyshim respektimin e parimit të shtetit të së drejtës dhe të të drejtave themelore, parimit të ndarjes së pushteteve, si dhe të kompetencave të kufizuara që Kushtetuta dhe ligji i njeh komisionit hetimor.<sup>5</sup> Sipas qëndrimit tjetër, objekti i hetimit nuk përmban pasaktësi ose paqartësi në mënyrën e formulimit të tij, të tilla që të ngrenë dyshime për mosrespektimin e parimeve kushtetuese, veçanërisht atij të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve, ndaj Kuvendi kishte detyrimin që të pranonte kërkesën për ngritjen e komisionit hetimor.<sup>6</sup> Ndërsa sipas një qëndrimi tjetër, objekti i hetimit është specifikuar në mënyrë të tillë që në disa prej pikave të vend për paqartësi, por këto paqartësi nuk janë të atij niveli që të arrihet në konkluzionin se mund të cenohen kompetencat e organeve të pavarura, sidomos në drejtim të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve.<sup>7</sup>

81. Në përfundim, Gjykata, me shumicë votash, vlerëson se në rastin konkret në kuadër të respektimit të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, nuk përmbushen njëkohësisht kriteret kushtetuese, të cilat janë të detyrueshme të plotësohen për ngritjen e komisionit hetimor, në kuptim të nenit 77, pika 2, të Kushtetutës, prandaj kërkesa duhet të rrëzohet.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 77, 131, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës, si dhe të neneve 54, 55 dhe 56 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

<sup>5</sup> Votuan për rrëzimin e kërkesës për këtë shkak gjyqtarët: Fiona Papajorgji, Altin Binaj, Sandër Beci dhe Genti Ibrahim.

<sup>6</sup> Votuan për pranimin e kërkesës për këtë shkak gjyqtarët: Vitore Tusha, Marsida Xhaferllari dhe Sonila Bejtja.

<sup>7</sup> Votoi për pranimin e kërkesës për këtë shkak gjyqtarja Elsa Toska.

#### VENDOSI:

##### 1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

**Marrë më 27.12.2022.**

**Shpallur më 26.1.2023.**

**Kryetare:** Vitore Tusha (kundër)

**Anëtarë:** Sandër Beci, Altin Binaj, Fiona Papajorgji, Genti Ibrahim, Ilir Toska

**Anëtarë kundër:** Elsa Toska, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja

#### MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të vënë në lëvizje nga një grup deputetësh të Kuvendit të Shqipërisë (jo më pak se një e katërta e deputetëve), me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet një të katërtës së deputetëve dhe Kuvendit të Shqipërisë, si dhe deklarimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit të tij nr. 80/2021, “Për mosmiratimin e projektvendimit ‘Për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve dhe mosveprimeve të institucioneve shtetërore dhe funksionarëve publikë në çështjet që kanë sjellë si pasojë vendimin e arbitrazhit ‘Becchetti dhe të tjerë kundër Shqipërisë’”, jemi kundër qëndrimit të shumicës, pasi vlerësojmë se kërkesa duhet pranuar. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese, parashatrojmë në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin kundër.

2. Edhe pse ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën se parimi i zbatimit të së drejtës ndërkombëtare në drejtim të parimit të konfidencialitetit nuk është i zbatueshëm dhe nuk mund të jetë pengesë për ngritjen e komisionit hetimor dhe, më tej, se për nga qëllimi i ngritjes së komisionit hetimor dhe çështja që kërkohet të hetohet plotësohet kriteri kushtetues i çështjes së veçantë, i përcaktuar nga norma kushtetuese (neni 77, pika 2) dhe i elaboruar nga jurisprudenca kushtetuese, nuk ndajmë të njëjtin qëndrim në lidhje me përfundimin e saj se në rastin konkret nuk plotësohen në mënyrë kumulative të gjitha



kriteret kushtetuese, përfshi atë që ka të bëjë me qartësinë e objektit hetimor.

3. Në vlerësimin tonë, siç edhe është shprehur përmbledhtazi në paragrafin nr. 80 të vendimit, për nga mënyra se si është formuluar objekti i propozuar i hetimit, ai nuk ngre dyshime për mosrespektimin e parimeve kushtetuese, në rastin konkret të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve. Bazuar në jurisprudencën kushtetuese, në lidhje me ato elemente që duhet të verifikohen në drejtim të përcaktimit nëse objekti i hetimit është i qartë ose i saktë, vlerësojmë se në rastin konkret ai ka përcaktuar harkun kohor të hetimit, faktet që duhet të hetohen, subjektet që do të jenë objekt i kësaj veprimtarie, duke mos lënë vend për paqartësi ose dykuptimësi për detyrat konkrete që do të kryejë komisioni hetimor. Nuk konstatohet që ky objekt të jetë i përgjithshëm dhe, për më tepër, që të ketë mbivendosje të veprimtarisë së propozuar të hetimit me procesin hetimor që është duke u kryer ndërkohë nga organet kushtetuese të pavarura, prokuroria dhe gjykata. Edhe vetë praktika parlamentare, në zbatim të standardeve të jurisprudencës kushtetuese për komisionet hetimore, nuk ka rezultuar të ketë mbivendosur kontrollin parlamentar me veprimtarinë e institucioneve të pavarura.

4. Në këtë drejtim duhet evidentuar se edhe vetë pakica parlamentare, në kërkesën drejtuar Kuvendit, është kujdesur për respektimin e standardeve kushtetuese, duke u shprehur se e drejta e komisionit për kryerjen e hetimeve do të realizohet vetëm brenda funksionit të kontrollit parlamentar dhe detyrës kushtetuese të deputetëve, dhe se objekti e qëllimi i ngritjes së këtij komisioni nuk sjell mbivendosje ose transferime të kompetencave të parashikuara nga Kushtetuta për organe të tjera, por synon njohjen dhe verifikimin në hollësi të të gjitha veprimeve ose mosveprimeve që kanë sjellë dëm në buxhetin e shtetit, me qëllim që të kontrollohet zbatimi i ligjit dhe të nxirren përgjegjësitë ligjore, si dhe të merren masat e nevojshme. Kjo reflektohet edhe në përmbajtjen e projektvendimit për ngritjen e komisionit hetimor, bashkëlidhur kërkesës drejtuar Kuvendit, në pikën III të të cilit është shënuar shprehimisht se *“komisioni ka të drejtë të hetojë dhe të bëjë transparencë të plotë për çdo çështje që përfshihet në objektin e punës së tij, në përputhje me parimet kushtetuese, veçanërisht parimin e*

*ndarjes së pushteteve, duke mos iu mbivendosur punës së organeve të drejtësisë”*.

5. Gjithashtu, vlerësojmë të theksojmë se në kushtet kur formulimi i këtij objekti të hetimit ishte në formën e një propozimi, në përputhje me jurisprudencën kushtetuese, si edhe me parimin e luajalitetit kushtetues, kërkohej bashkëveprimi i shumicës dhe pakicës parlamentare për konsultimin e tij, me qëllim arritjen e një konsensusi për evitimin e çdo formulimi që mund të krijonte paqartësi në dukje, të tilla që mund të lindnin dyshime për mosrespektimin e parimit kushtetues të ndarjes dhe balancimit të pushteteve. Në rastin konkret, shumica nuk e ka vënë në diskutim objektin e hetimit, në drejtim të mundësisë së riformulimit të tij në ato aspekte që, sipas saj, lindnin dyshime për paqartësi, çka është e vetmja mënyrë për të respektuar të drejtën kushtetuese të pakicës parlamentare, të sanksionuar nga neni 77, pika 2, i Kushtetutës, por në mënyrën se si ka vepruar në rastin konkret, ia ka mohuar asaj këtë të drejtë.

**Kryetare:** Vitore Tusha

**Anëtare:** Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari

## URDHËR

**Nr. 16, datë 25.1.2023**

### **PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM KOMPETENCASH**

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 21, shkronja “a”, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; si edhe të nenit 30, pika 1, germa “a”, të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar, për shkak të mungesës në punë për arsye objektive, të kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit;

## URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së përfaqësimit të institucionit në marrëdhëniet me palët e treta, znj. Laerta Rooze, Sekretare e Përgjithshme e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.





2. Delegimin e kompetencës së mësipërme për periudhën 26.1.2023–27.1.2023.

3. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, znj. Laerta Rooze.

4. Znj. Laerta Rooze nuk mund ta nëndelegojë këtë kompetencë.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë punonjësit e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE  
Albana Shtylla

**VENDIM**  
Nr. 357, datë 30.12.2022

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “E-VENTO S.R.L ALBANIA” SHPK, PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-S NR. 32, DATË 4.2.2021, “MBI KËRKESËN E SHOQËRISË ‘E-VENTO S.R.L. ALBANIA’ SHPK, PËR SHTYRJEN E AFATEVE TË VENDIMIT NR. 84, DATË 17.7.2008, I NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 53, pika 2 dhe nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2129 prot., datë 29.12.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 249, datë 13.12.2021 “Mbi rishikimin e vendimit nr. 111, datë 26.4.2021, ‘Mbi kërkesën e shoqërisë ‘E-Vento S.R.L Albania’ sh.p.k., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 32, datë 4.2.2021, ‘Mbi kërkesën e shoqërisë ‘E-Vento S.R.L Albania’ sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 84, datë 17.7.2008, i ndryshuar”,

konstatoi se:

1. Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 249, datë 13.12.2021, i ndryshuar me vendimin nr. 269, datë 14.10.2022, ka vendosur:

“1. Të zgjasë me 3 (tre) muaj afatin e depozitimit të Deklaratës Mjedisore dhe me 6 (gjashtë) muaj afatin e depozitimit të dokumentacionit pronësor duke filluar ky afat nga data 14.09.2022.

2. Shoqëria “E-Vento s.r.l. Albania” sh.p.k. çdo 3 (tre) muaj të dokumentojë në ERE një progres raport me informacion për investimet që do të kryejë, në kuadër të plotësimit të kushteve të sipërcituara.

3. Shoqëria “E-Vento s.r.l. Albania” sh.p.k. të paraqesë në ERE në mënyrë periodike me data të rifreskuara dokumentet që i nënshtrohen rinovimit të afateve.”.

- ERE njoftoi shoqërinë për vendimin e mësipërm me shkresën nr. 167/14 prot., datë 8.11.2022, duke i sjellë në vëmendje detyrimin për të plotësuar në afat sa kërkuar nga ky vendim.

- Në lidhje me kushtin e vendimit nr. 249/2021, i ndryshuar, që ka të bëjë me pajisjen me deklaratën mjedisore, me shkresat e protokolluara në ERE, përkatësisht me nr. 167/15 prot., datë 21.11.2022, nr. 167/16 prot., datë 7.12.2022, nr. 167/17 prot., datë 7.12.2022 dhe nr. 167/19 prot., datë 22.12.2022, shoqëria ka informuar ERE-n dhe ka dokumentuar përpjekjet e saj për t'u pajisur me deklaratë mjedisore, ku nga informacioni i marrë rezulton se aktualisht kjo procedurë është në fazën e dërgimit të mendimit nga institucionet, si: Bashkia Finiq, Konispol, Sarandë dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM).

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 167/18 prot., datë 12.12.2022, shoqëria ka bërë me dije se me shkresën e saj nr. 230 prot., datë 6.12.2022, ka kërkuar pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. miratimin e pikës së lidhjes dhe nënshkrimin e aktmarrëveshjes përkatëse, në kuadër të plotësimit të kushtit të vendosur në pikën 3 të vendimit nr. 269, datë 14.10.2022, si dhe referuar detyrave të shprehura nëpërmjet konstatimeve të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 111, datë 26.4.2021, ku është përcaktuar se: pas depozitimit të lejes së mjedisit dhe studimit të fizibilitetit, ERE do të vlerësojë më tej mundësinë e shtyrjes, sipas kërkesës së shoqërisë, të afateve të plotësimit të kushteve të vendimit nr. 84/2008, i ndryshuar, konkretisht sipas pikës 1, germa “b”, që ka të bëjë me marrëveshjen e nënshkruar me OST sh.a. dhe sipas pikës 1, germa



“d”, që ka të bëjë me kohën e zbatimit të të gjithë projektit, përfshirë dhe kolaudimin e veprës.

- Për gjithë sa më sipër, rezulton se shoqëria nuk ka arritur ende të përmbushë kushtin e vendosur në pikën 2 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 249/2021, i ndryshuar, që ka të bëjë me pajisjen me deklaratën mjedisore, por ka informuar dhe dokumentuar në ERE të gjitha përpjekjet që varen nga vullneti i saj dhe po ashtu statusin në të cilën ndodhet pajisja me këtë dokument.

- Në këto rrethana, duke vlerësuar përpjekjet e shoqërisë dhe informacionin e dokumentacionin e depozituar nga ana e saj në mënyrë periodike në ERE, vlerësojmë që të shtyhet dhe me 3 (tre) muaj të tjerë afati brenda të cilit shoqëria të pajiset me deklaratën mjedisore, aq sa ishte dhe afati fillestar i lënë në dispozicion të saj, afat i cili fillon nga data 15.12.2022.

- Në nenin 53, pika 2, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se: përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, nëse ligji ose aktet nënligjore nuk parashikojnë një afat të caktuar për kryerjen e një veprimi procedural, organi publik që kryen procedurën cakton me vendim të veçantë një afat të arsyeshëm, sipas çështjes konkrete dhe në përputhje me parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Pika 2 e vendimit nr. 249, datë 13.12.2021, ndryshon si vijon:

“2. Të zgjasë me 3 (tre) muaj afatin e depozitimit të deklaratës mjedisore dhe me 6 (gjashtë) muaj afatin e depozitimit të dokumentacionit pronësor duke filluar ky afat nga data 15.12.2022.”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendrike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime

materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendrike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrit Ahmeti

#### VENDIM

Nr. 359, datë 30.12.2022

### **MBI PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS “MBI KËRKESËN E SHOQËRISË ‘HEC BISHNICA 1, 2’ SHPK, PËR ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJES NDËRMJET PALËVE, SHOQËRISË FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË SHA DHE SHOQËRISË ‘HEC BISHNICA 1, 2’ SHPK”**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 20, geramat “a” dhe “ë”, nenit 24, pikat 1, 2 dhe 3, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 23, pika 12, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 96, datë 3.9.2016; rregullores “Për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 114, datë 8.7.2016 dhe “Kontratës për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sh.a.) dhe Prodhuesve me Përparësi të Energjisë Elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 101, datë 23.6.2016, të ndryshuar; vendimit të Bordit të ERE-s nr. 89, “Mbi kërkesën e shoqërisë HEC “Bishnica 1, 2” sh.p.k., për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet shoqërisë Furnizuesi i Tregut të Lirë (FTL sh.a.) dhe HEC “Bishnica 1 dhe 2” sh.p.k.”; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.12.2022, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga grupi i punës me nr. 2129/2 prot., datë 29.12.2022,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 89, datë 28.4.2022 është shprehur “Mbi kërkesën e shoqërisë “HEC Bishnica 1, 2” sh.p.k., për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet palëve,



Shoqërisë Furnizuesi i Tregut të lirë sh.a. dhe shoqërisë “HEC Bishnica 1, 2” sh.p.k., dhe ka vendosur:

Pranimin për shqyrtim nga ERE të kërkesës së paraqitur nga shoqëria “HEC Bishnica 1, 2” sh.p.k., për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet shoqërisë “HEC Bishnica 1, 2” sh.p.k. dhe shoqërisë “FTL” sh.a., duke filluar procedurën për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në përputhje me rregulloren “Për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 114, datë 8.7.2016.

- Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 650, datë 10.10.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 584, datë 8.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”, të ndryshuar ndër të tjera vendosi:

“2/1. Vendosjen e detyrimit të shërbimit publik ndaj prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike, që kanë kontratë me shoqërinë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a. Këtyre prodhuesve me përparësi i vendoset detyrimi i shërbimit publik për shitjen e energjisë elektrike të shoqëria “Furnizuesi i Tregut të Lirë”, në përputhje me çmimin e përcaktuar nga Enti Rregullator i Energjisë, në bazë të metodologjisë së miratuar me vendimin nr. 687, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, i ndryshuar, gjatë periudhës së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike.”, dhe ....

1.- Në pikën 5, fjalët 31 dhjetor 2022, “zëvendësohen me 30 qershor 2023”.

- Sikurse evidentuar më sipër, është vendosur detyrimi i shërbimit publik ndaj prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike, që kanë kontratë me shoqërinë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a., dhe në pikën 2 është përcaktuar vijimi i gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike, deri në datën 30 qershor 2023.

- Meqenëse “HEC Bishnica 1, 2” sh.p.k. ka nënshkruar me shoqërinë FTL sh.a., Kontratën për shit-blerje të energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a., dhe Prodhuesve me Përparësi të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin nr. 101, datë

23.6.2016, të Bordit të ERE-s, të ndryshuar bazuar në VKM-në nr. 650, datë 10.10.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 584, datë 8.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”, të ndryshuar, aplikohet vendosja e detyrimit të shërbimit publik ndaj prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike, që kanë kontratë me shoqërinë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a.

- Këtyre prodhuesve përshirë dhe shoqërinë “HEC Bishnica 1, 2” sh.p.k. i vendoset detyrimi i shërbimit publik për shitjen e energjisë elektrike të shoqëria “Furnizuesi i Tregut të Lirë”, në përputhje me çmimin e përcaktuar nga Enti Rregullator i Energjisë, në bazë të metodologjisë së miratuar me vendimin nr. 687, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, i ndryshuar, gjatë periudhës së gjendjes së emergjencës në fuqizimin me energji elektrike, e cila zgjat deri më 30 qershor 2023.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës së filluar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 89, datë 28.4.2022 “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘HEC Bishnica 1, 2’ sh.p.k., për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet palëve, Shoqërisë Furnizuesi i Tregut të lirë sh.a. dhe shoqërisë ‘HEC Bishnica 1, 2’ sh.p.k.”.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë shoqëritë FTL sh.a. dhe “HEC Bishnica 1, 2” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrit Ahmeti



## VENDIM

Nr. 360, datë 30.12.2022

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS  
SË FILLUAR ME VENDIMIN E ERE-S  
NR. 112, DATË 19.5.2022, MBI KËRKESËN  
E SHOQËRISË “HEC - I TËRVOLIT”  
SHPK, “PËR ZGJIDHJEN E  
MOSMARRËVESHJES NDËRMJET  
SHOQËRISË FURNIZUESI I TREGUT  
TË LIRË (FTL) SHA DHE SHOQËRISË  
‘HEC - I TËRVOLIT’ SHPK”**

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 20, gjerat “a” dhe “ë”, nenit 24, pikat 1, 2, 3, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 23, pika 12, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 96, datë 3.9.2016; “Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 114, datë 8.7.2016; dhe “Kontratës për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sh.a.) dhe prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 101, datë 23.6.2016, të ndryshuar; vendimit të Bordit të ERE-s nr. 112, datë 19.5.2022, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘HEC - i Tërvolit’ sh.p.k. për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet shoqërisë Furnizuesi i Tregut të Lirë (FTL) sh.a. dhe shoqërisë ‘HEC - i Tërvolit sh.p.k.’”; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.12.2021, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga grupi i punës me nr. 2129/2 prot, datë 29.12.2022,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 112, datë 19.5.2022, mori në shqyrtim kërkesën e shoqërisë “HEC - i Tërvolit” sh.p.k., duke vendosur:

1. Pranimin për shqyrtim nga ERE të kërkesës së paraqitur nga shoqëria “HEC - i Tërvolit” sh.p.k., për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet shoqërisë “HEC - i Tërvolit” sh.p.k. dhe shoqërisë FTL sh.a., duke filluar procedurën për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në përputhje me “Rregulloren për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët

dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 114, datë 8.7.2016.

- Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 650, datë 10.10.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 584, datë 8.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”, të ndryshuar, ndër të tjera vendosi:

1. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Vendosjen e detyrimit të shërbimit publik ndaj prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike, që kanë kontratë me shoqërinë Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a. Këtyre prodhuesve me përparësi u vendoset detyrimi i shërbimit publik për shitjen e energjisë elektrike të shoqëria Furnizuesi i Tregut të Lirë, në përputhje me çmimin e përcaktuar nga Enti Rregullator i Energjisë, në bazë të metodologjisë së miratuar me vendimin nr. 687, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, të ndryshuar, gjatë periudhës së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”, dhe ...

2. Në pikën 5, fjalët 31 dhjetor 2022, “zëvendësohen me 30 qershor 2023”.

- Sikurse evidentohet më sipër është vendosur detyrimi i shërbimit publik ndaj prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike, që kanë kontratë me shoqërinë Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a., dhe në pikën 2 është përcaktuar vijimi i gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike, deri në datën 30 qershor 2023.

- Meqenëse “HEC - i Tërvolit” sh.p.k. ka nënshkruar me shoqërinë FTL sh.a., kontratën për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a., dhe prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike, miratuar me vendimin nr. 101, datë 23.6.2016, të Bordit të ERE-s, të ndryshuar bazuar në VKM-në nr. 650, datë 10.10.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 584, datë 8.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”, të ndryshuar, aplikohet vendosja e detyrimit të shërbimit publik ndaj prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike, që kanë kontratë me shoqërinë Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a.



- Këtyre prodhuesve përshtirë dhe shoqërinë “HEC - i Tërvolit” sh.p.k., i vendoset detyrimi i shërbimit publik për shitjen e energjisë elektrike te shoqëria Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a., në përputhje me çmimin e përcaktuar nga Enti Rregullator i Energjisë, në bazë të metodologjisë së miratuar me vendimin nr. 687, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, të ndryshuar, gjatë periudhës së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike, e cila zgjat deri më 30 qershor 2023.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës së filluar me vendimin e Bordit të ERE nr. 112, datë 19.5.2022, kërkesën e shoqërisë “HEC - i Tërvolit” sh.p.k., është shprehur “Për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet shoqërisë Furnizuesi i Tregut të Lirë (FTL) sh.a. dhe Shoqërisë “HEC - i Tërvolit” sh.p.k.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR  
Petrit Ahmeti**

#### KËRKESË

**Nr. 81/5, datë 25.1.2023**

#### PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Lidhja e Rrugës Transballkanike me Portin Detar”, Vlorë”, me vlerë totale paraprake të shpronësimit 206,784,251.90 (dyqind e gjashtë milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e katër mijë e dyqind e pesëdhjetë e një lekë pikë nëntëdhjetë) lekë.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Vlorë.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohet sipas vlerësimit paraprak të llogaritur:

Për pasuritë e llojit “truall” dhe “arë” është bërë bazuar në VKM nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

Vlerësimi i pasurisë të llojit “Ndërtesë” është bazuar në VKM nr. 138, datë 23.8.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara, për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Bashkisë Vlorë, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 206,784,251.90 (dyqind e gjashtë milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e katër mijë e dyqind e pesëdhjetë e një lekë pikë nëntëdhjetë) lekë.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM  
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM  
TË SHPRONËSIMEVE  
Egrja Ibrahimi**



LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME QË PREKEN NGA PROJEKTI I ZBATIMIT  
“LIDHJA E RRUGËS TRANSBALLKANIKE ME PORTIN DETAR VLORË”

NR	Pronari	ZK	Nr. i pasurisë	Volum	faqe	truall m <sup>2</sup>	ndërtesë m <sup>2</sup>	Adresa	Lloji i pasurisë	Sipërfaqe truallit për shpronësim	Çmimi i truallit lekë/m <sup>2</sup>	Vlera e truallit lekë	Sipërfaqe ndërtimi për shpronësim	Çmimi i ndërtimit lekë/m <sup>2</sup>	Vlera e ndërtimit lekë	Vlera e truallit dhe ndërtesë	Shënime	
1	Viron Xhavera	8604	32/39-ND	28	225		105	Vlorë	ndërtesë				105	52,296.00	5,491,080.00	5,491,080.00	Sipas origjinës objekti është i llojit banim	
2	Viron Xhavera	8604	32/39-T	28	224	140		Vlorë	truall	92	6,899.00	634,708.00				634,708.00	Kufizim. Plotësim dosje. Prona është me hartë të vjetër.	
3	Sose Lato Barjamaj	8604	32/243	20	119	54		Vlorë	truall	54	6,899.00	372,546.00				372,546.00		
4	Sose Lato Barjamaj	8604	32/306+1-ND1/1	20	124		54	Vlorë	ndërtesë		6,899.00	-	54			1,731,506.00	Vlera e ndërtesës është llogaritur me situacion punimesh, pasi objekti sipas origjinës së pronës është i llojit bar-bufë.	
5	Shoqëria "Onikum" Shpk, Edison Sali	8604	32/306+1-ND1/2	20	125		73	Vlorë	ndërtesë		6,899.00	-	73			2,340,740.00	Vlera e ndërtesës është llogaritur me situacion punimesh, pasi objekti sipas origjinës së pronës është i llojit njësi	
6	Salvatore Tafuro	8604	32/306+1-ND2	20	123		127		ndërtesë		6,899.00	-	127			4,072,246.00		
7	Shoqëria Orikum Edison Sali	8604	32/306	27	63	1304		Vlorë	truall	526	6,899.00	3,628,874.00				3,628,874.00	Pasuria 32/306-ND vol. 27, faqe 61, është mbi pasurinë 32/306 vol. 27, faqe 63	
8	Bardhyl Sali	8604	32/424	39	62	1660		Vlorë	truall	1660	6,899.00	11,452,340.00				11,452,340.00		
9	Bardhyl Sali	8604	32/423	39	61	1574		Vlorë	truall	127	6,899.00	876,173.00				876,173.00		
10	Bardhyl Sali	8604	32/307-ND1	39	47		710	Vlorë	njësi		6,899.00	-	194			3,070,079.00	Pasuria 32/307-nd 1, vol. 39, faqe 47, ngrihet mbi pasurinë 32/306 vol. 27, faqe 63. Nga kjo pasuri do të prishet 194 m <sup>2</sup> ndërtesë nga 710 m <sup>2</sup> . Vlera e ndërtesës është llogaritur me situacion punimesh, pasi objekti sipas origjinës së pronës është i llojit njësi. Situacioni total është në shumën 17 439 314 lekë dhe është llogaritur për 1102 m <sup>2</sup> . Duke kalkular sipas sipërfaqeve të secilës prone rezultojnë që pasuria me sipërfaqe 908 m <sup>2</sup> të jetë llogaritur në shumën 14369235 lekë dhe pasuria me sip. 194 m <sup>2</sup> të jetë llogaritur në shumën 3070079 lekë	
11	Bardhyl Sali	8604	32/307-ND2	39	48		908	Vlorë	njësi		6,899.00	-	908			14,369,235.00	Pasuria 32/307-nd2, vol. 39, faqe 48, ngrihet mbi pasurinë 32/306 vol. 27, faqe 63. Vlera e ndërtesës është llogaritur me situacion punimesh, pasi objekti sipas origjinës së pronës është i llojit njësi. Situacioni total është në shumën 17 439 314 lekë dhe është llogaritur për 1102 m <sup>2</sup> . Duke kalkular sipas sipërfaqeve të secilës prone rezultojnë që pasuria me sipërfaqe 908 m <sup>2</sup> të jetë llogaritur në shumën 14369235 lekë dhe pasuria me sip. 194 m <sup>2</sup> të jetë llogaritur në shumën 3070079 lekë	
12	Rahmi Isufi	8604	32/314	17	230	200		Vlorë	truall	159.5	6,899.00	1,100,390.50				1,100,390.50	Mbi këtë pasuri ndodhet pasuria nr. 32/15-ND	
13	Rami Isufaj	8604	32/15-N1	48	70		200	Vlorë	njësi		6,899.00	-	200			13,003,843.00	Pike karburanti sipas leje ndërtimi me vendim nr. 8/25, datë 16.06.1998 të KRRIT-së Vlorë. Hipotekohet në favor të Societe General Albania. Vlera e ndërtesës është llogaritur me situacion punimesh, pasi objekti sipas origjinës së pronës është i llojit njësi dhe pikë karburanti	
14	Rami Isufaj	8604	32/15+1-1	48	71		216.4	Vlorë	apartament		6,899.00	-	216.4	52,296.00	11,316,854.40	11,316,854.40	Hipotekohet në favor të Societe General Albania.	
15	Rami Isufaj	8604	32/15+1-2	48	72		216.4	Vlorë	apartament		6,899.00	-	216.4	52,296.00	11,316,854.40	11,316,854.40	Hipotekohet në favor të Societe General Albania.	
16	Rami Isufaj	8604	32/15+1-3	48	73		216.4	Vlorë	apartament		6,899.00	-	216.4	52,296.00	11,316,854.40	11,316,854.40	Hipotekohet në favor të Societe General Albania.	
17	Latif Reshat Totaj dhe Nadire Yzeir Totaj	8604	32/589	67	239	437		Vlorë	truall	95	6,899.00	655,405.00				655,405.00	Bashkim pasurie pas vendimit për miratimin e kërkesës për kalimin në pronësi të oborrit në përdorim nr. 280, datë 19.11.2021 dhe objektit 57 m <sup>2</sup> të regjistruar me nr. pasurie 32/16-ND, vol 59, faqe 149	
18	Latif Reshat Totaj	8604	32/16-ND	59	149		57	Vlorë	ndërtesë				57	52,296.00	2,980,872.00	2,980,872.00	Sipas origjinës së pronës të konfirmuar nga ASHK-ja dhe vëzhgimit në terren objekti është banesë. Kjo pasuri ngrihet mbi pasurinë 32/16-T, Vol 59 faqe 148. Mungon marrëdhënia me truallin	
19	BP Muhameti	8604	32/17-T	21	166	345		Vlorë	truall	60	6,899.00	413,940.00				413,940.00	Mbi këtë pasuri ngrihet pasuria 32/17-ND dhe 32/352.	
20	Llambi Todri Mino	8604	32/17-ND	21	165		68	Vlorë	ndërtesë		6,899.00	-	68	52,296.00	3,556,128.00	3,556,128.00	Sipas origjinës së pronës të konfirmuar nga ASHK objekti është banesë. Pasuria 32/17-ND Vol 21 faqe 65 ngrihet mbi pasurinë 32/17-T, Vol 21 faqe 166. Mungon marrëdhënia me truallin	
21	Agim, Fatmir dhe Petrit Mustafaraj	8604	32/20	20	184	290	70	Vlorë	truall	125.5	6,899.00	865,824.50		70	52,296.00	3,660,720.00	4,526,544.50	Sipas origjinës së pronës të konfirmuar nga ASHK-ja dhe vëzhgimit në terren objekti është banesë. Ndallim plotësim dosje, deklaratë kufitare, origjina vendim gjykatë. Ka



															mbivendosje me pasuritë 32/17, 32/18 dhe 32/19		
22	Ollga, Stefan dhe Jani Papajani, Pavlina Janka Violeta Muka	8604	32/22	23	221	672	132	Vlorë	truall	134.5	6,899.00	927,915.50	132	52,296.00	6,903,072.00	7,830,987.50	Kufizim veprimesh deri në plotësimin e deklaratis së kufitareve.
23	Xhemil, Sezai, Vladimir, Shqiponja, Fadil, Verxhina, Avdul, Myfit, Abibe Musa	8604	32/34+1-1	18	84	66	66	Vlorë	apartament	66	6,899.00	455,334.00	66	52,296.00	3,451,536.00	3,906,870.00	Sipas formularit nr. 2 është privatizuar edhe 66 m <sup>2</sup> truall
24	Verë, Marenglen, Martin, Anxhela Sulejmani	8604	32/34+1-2	63	178	49.9	41.5	Vlorë	apartament	49.9	6,899.00	344,260.10	41.5	52,296.00	2,170,284.00	2,514,544.10	Sipas formularit nr. 2 është privatizuar edhe 49.9 m <sup>2</sup> truall Sipas formularit nr. 2 është privatizuar edhe 60 m <sup>2</sup> truall. Vendim nga Bashkia Vlorë nr. 39 datë 14.12.2015. Për kalimin në pronësi të pas. Pal. të ndërtuara deri më 10.8.1991 dhe truallit funksional të saj
25	Sezai Musa	8604	32/533	50	194	60	37	Vlorë	apartament	60	6,899.00	413,940.00	37	52,296.00	1,934,952.00	2,348,892.00	
26	Kujtim Mahmutaj, Vitori Mahmutaj	8604	32/134+1-1	18	89		58	Vlorë	apartament				58	52,296.00	3,033,168.00	3,033,168.00	
27	Arjan Çuni	8604	32/134+1-2	18	90		39	Vlorë	apartament				39	52,296.00	2,039,544.00	2,039,544.00	
28	Armida, Esmeralda, Lefter dhe Thomaidha Bifsha	8604	32/134+1-9	29	51	53.12	33.72	Vlorë	apartament	53.12	6,899.00	366,474.88	33.72	52,296.00	1,763,421.12	2,129,896.00	Plotësim dokumentacioni ligjor dhe teknik.
29	Shpresa, Lonard, Alfred, Elisabeta Xhako dhe Gentiana Rapo	8604	32/134+1-10	22	189		50	Vlorë	apartament				50	52,296.00	2,614,800.00	2,614,800.00	
30	Gezim Lako	8604	32/33+1-2	18	79		38	Vlorë	apartament				38	52,296.00	1,987,248.00	1,987,248.00	
31	Pellumb Aliu	8604	32/33+1-3	18	80		38	Vlorë	apartament				38	52,296.00	1,987,248.00	1,987,248.00	
32	Sokol Velaj	8604	32/33+1-4	18	81		44	Vlorë	apartament				44	52,296.00	2,301,024.00	2,301,024.00	
33	Hiqmet Ibrahimi, Natasha Papa	8604	32/33+1-5	18	82		48	Vlorë	apartament				48	52,296.00	2,510,208.00	2,510,208.00	
34	Odise Anagnosti	8604	32/546	53	54	143.3		Vlorë	truall	23	6,899.00	158,677.00				158,677.00	
35	Odise Anagnosti	8604	32/547-N1	54	162		94	Vlorë	njësi				94		-	1,950,367.00	Vlera e ndërtesës është llogaritur me situacion punimesh, pasi objekti sipas origjinës së pronës është i llojit njësi
36	Odise Anagnosti	8604	32/547+1-1	54	164		100	Vlorë	apartament				100	52,296.00	5,229,600.00	5,229,600.00	
37	Lavdie, Artan, Indrit, Fjorentino Habibaj	8604	32/154-ND	22	134		68	Vlorë	ndërtesë				68	52,296.00	3,556,128.00	3,556,128.00	Sipas origjinës së pronës të konfirmuar nga ASHK-ja dhe vëzhgimit në terren objekti është banesë. Pasuria 32/154-ND është mbi pasurinë 32/154 vol 22, faqe 135
38	PPV	8604	32/154	22	135	432		Vlorë	truall	432	6,899.00	2,980,368.00	0	52,296.00	-	2,980,368.00	NGRIHET PASURIA 32/154-nd. Plotësim dokumentacioni
39	Myzafer Zana, Dashamir Skendaj	8604	32/450	40	170	323.8	95	Vlorë	truall	37.5	6,899.00	258,712.50	0	52,296.00	-	258,712.50	
40	Feto Haderaj, Arben Haderaj, Sokol Haderaj dhe Mirela Haderaj	8604	32/236	21	103	568	123	Vlorë	truall	149	6,899.00	1,027,951.00	123	52,296.00	6,432,408.00	7,460,359.00	Ka kontratë sipërmarrje për ndërtim me nr. 2963 rep, nr. 976 kol datë 7.10.2021
41	PPV	8604	32/190	22	11	481		Vlorë	truall	34	6,899.00	234,566.00	0	52,296.00	-	234,566.00	Pasuria 32/190-nd Vol. 22, f. 10 është mbi pasurinë 32/190 vol. 22 faqe 11. Plotësim dokumentacioni
42	Arben Qemal Dangaj, Fatbardha Isuf Dangaj	8604	32/257/1	64	157	250	88	Vlorë	truall	29	6,899.00	200,071.00		52,296.00	-	200,071.00	
43	PPV	8604	32/257/2	64	158	17		Vlorë	truall	17	6,899.00	117,283.00		52,296.00	-	117,283.00	Plotësim dokumentacioni
44	Edmond Zabit Gjonaj	8604	32/256-ND	21	79		50	Vlorë	ndërtesë		6,899.00	-	50	52,296.00	2,614,800.00	2,614,800.00	Ngrihet mbi pasurinë nr.32/256
45	Edmond, Roland Gjonaj	8604	32/256	21	80	270		Vlorë	truall	228	6,899.00	1,572,972.00		52,296.00	-	1,572,972.00	Ngrihet pasuria nr. 32/256-ND
46	P.P.V	8604	32/226	21	72	338		Vlorë	truall	263	6,899.00	1,814,437.00		52,296.00	-	1,814,437.00	Pasuria nr. 32/226-ND, vol 21, faqe 71, është mbi pasurinë 32/226 vol. 21, faqe 72. Plotësim dokumentacioni
47	PPV	8604	32/208	21	122	211		Vlorë	truall	211	6,899.00	1,455,689.00		52,296.00	-	1,455,689.00	Ngrihet pasuria nr. 32/208-ND. Plotësim dokumentacioni
48	Jaho Avdulla Dano	8604	32/208-ND	21	121		20	Vlorë	ndërtesë		6,899.00	-	20	52,296.00	1,045,920.00	1,045,920.00	Ngrihet mbi pasurinë nr. 32/208. Kufizim veprimesh
49	Zotaj, Petromilo, Gjirrit, Shehu, Zuna, Zalosnja, Osmani, Skenderaj, Asllani, Hasanbelliu, Rakipaj	8604	32/392	31	177	1000		Vlorë	truall	659	6,899.00	4,546,441.00				4,546,441.00	Mbi këtë pasuri ndodhen 2 ndërtesa. Revokuar prokura e Dhimitra Zotaj për Maksim Gjikutaj Kontratë sipërmarrje në favor të DH Konstruksion. Kufizim. Vendim gjykatë. Sigurim padie nr. 3478, datë 13.12.2010
50	Gani Ismaili, Djana Naço, Esli Hajderi	8604	32/250	18	146	1870		Vlorë	truall	388	6,899.00	2,676,812.00				2,676,812.00	
51	PPV	8604	32/316	27	131	357		Vlorë	truall	357	6,899.00	2,462,943.00				2,462,943.00	Mbi këtë pasuri ndodhet pasuria 32/316-ND, vol 27 faqe 112. Pasuria 32/316, vol 27 faqe 131 posedohet nga Joni Begaj
52	Joni Begaj	8604	32/316-nd	27	112		74.5	Vlorë	apartament		6,899.00		74.5	52,296.00	3,896,052.00	3,896,052.00	Pasuria 32/316-ND vol. 27 faqe 112, ngrihet mbi pasurinë nr. 32/316 vol 27 faqe 131. Kufizim veprimesh deri në plotësim dokumentacioni
53	Robert Begaj, Mimoza	8604	32/318	27	200		35.06	Vlorë	apartament		6,899.00	-	35.06	52,296.00	1,833,497.76	1,833,497.76	Kryer rrvlerësimi i pasurisë 2166708 lekë. Kufizim veprimesh



54	Begaj PPV	8604	32/24/2	65	130	38		Vlorë	truall	9	6,899.00	62,091.00			62,091.00	deri në plotësim dokumentacioni	
55	Viron Barjam Çuni	8604	32/552	56	214			Vlorë	truall dhe ndërtesë		6,899.00		242	52,296.00	12,655,632.00	12,655,632.00	Plotësim dokumentacioni Mbyllur. Vijon në vol.53 faqe 151;152. Saktësim dokumentacioni. Sipas notës së Transkriptimit Viron Çuni ka blerë një objekt 2-katësh me sipërfaqe kati përkatësisht 121 m <sup>2</sup> , për të cilin është në proces certifikimi. Plotësim dokumentacioni.
56	shtet	8604	32/306/1	27	76	249		Vlorë	truall	249	-				-		
57	Rexhep Gani Çota	8604	32/557	56	221	143.2	32.4	Vlorë	truall + ndërtesë	130.6	6,899.00	901,009.40	32.4	52,296.00	1,694,390.40	2,595,399.80	Mbi këtë pasuri ngrihet pasuna 32/23-ND1
58	Rexhep Gani Çota	8604	32/23-ND1	52	86		10.5	Vlorë	ndërtesë		6,899.00	-	10.5	52,296.00	549,108.00	549,108.00	Kjo pasuri ngrihet mbi pasurinë 32/557
59	Bedri Adem Çota	8604	32/556	56	220	137.4	24.6	Vlorë	truall dhe ndërtesë	17	6,899.00	117,283.00	25	52,296.00	1,307,400.00	1,424,683.00	
<b>Vlera totale paraprake</b>															<b>206,784,251.90</b>		

Çmimi i truallit sipas VKM nr. 89, datë 3.2.2016, ZK 8604 6899 lekë/m<sup>2</sup>.

Çmimi për objektet sipas VKM 138, datë 23.03.2000 dhe udhëzimi nr. 3, datë 28.12.2016 i EKB-së Tiranë.



**KËRKESË****Nr. 83/3, datë 24.1.2023****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Ndërtim i qendrës shëndetësore në lagjen ‘Gafurr Muço’”, Bashkia Lushnjë.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Lushnjë.

Me anë të këtij publikimi kërkohet të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilët do të

kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pasuritë e llojit “truall”, si dhe bazuar në vendimin nr. 138, datë 23.2.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, për pasuritë e llojit “ndërtesë”.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 2,254,070.00 (dy milionë e dyqind e pesëdhjetë e katër mijë e shtatëdhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM  
**Egra Ibrahim**



LISTA EMËRORE “PËR SHPRONËSIM, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT ‘NDËRTIM I QENDRËS SHËNDETËSORE NË LAGJEN ‘GAFURR MUÇO’”, BASHKIA LUSHNJË

NR.	PRONARI			TË DHËNA HIPOTEKARE									TRUALL			NDËRTESE			VLERA TOTALE (lek)	SHËNIME (kufizime hipotekare, barrë mbi pasurinë etj.)				
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Aë (m²)	Truall (m²)	Ndërtësë (m²)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lek)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lek/m²)			Vlera (lek)			
														O	P	Q	R	S			T			
A	B	C	C	Ç	D	E	F	G	H	I	J	K	O	P	Q	R	S	T	Y	Z				
1	Agim	Qazim	Stafa	Lushnjë	8572	12/182	Ndërtësë	25	0	0	25	18	7	0.0	0	0	25.0	0	348966	348,966	Shkresa nr. prot. 2461/2, datë 6.5.2022.			
2	Alfons	Dude	Beçari	Lushnjë	8572	12/74	Truall	81	0	81	76			81.0	8,954	725274	76	0	1179830	1,905,104	Shkresa nr. prot. 2461/2, datë 6.5.2022.			
3	Shtet			Lushnjë	8572	12/63	Shesh	1442	0	1442	0			0.0	0	0	0	0	0	0	Shkresa nr. prot. 11444/1, datë 4.1.2023.			
4	Shtet			Lushnjë	8572	12/71	Garazh	23	0	0	23			0.0	0	0	23	0	0	0	Shkresa nr. prot. 11444/1, datë 4.1.2023. Në posedim Marjo Alfons Beçari. Objekt i prishur.			
5	Shtet			Lushnjë	8572	12/73	Garazh	18	0	0	18			0.0	0	0	18	0	0	0	Shkresa nr. prot. 11444/1, datë 4.1.2023. Në posedim Panajot Vasho. Objekt i prishur.			
6	Shtet			Lushnjë	8572	12/76	Garazh	32	0	0	32			0.0	0	0	23	0	0	0	Shkresa nr. prot. 11444/1, datë 4.1.2023. Në posedim Osman Leka. Objekt i prishur.			
7	Shtet			Lushnjë	8572	12/77	Garazh	32	0	0	32			0.0	0	0	23	0	0	0	Shkresa nr. prot. 11444/1, datë 4.1.2023. Në posedim Vangjel Solli Nasi. Objekt i prishur.			
8	Shtet			Lushnjë	8572	12/78	Garazh	32	0	0	32			0.0	0	0	23	0	0	0	Shkresa nr. prot. 11444/1, datë 4.1.2023. Në posedim Veli Muça. Objekt i prishur.			
9	Shtet			Lushnjë	8572	12/72	Garazh	20	0	0	20			0.0	0	0	18	0	0	0	Shkresa nr. prot. 11444/1, datë 4.1.2023. Në posedim Spiro Todi. Objekt i prishur.			
<b>SHUMA</b>																		725274			1528796		2,254,070	

**KËRKESË**

Nr. 94/1, datë 20.1.2023

**PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikimi Urban i Rrugëve ‘Ura e Re–Shish’, ‘Antipatrea’, shëtitorja ‘Osumi’ dhe ‘Santa Lucia Filipine’, Berat”, me vlerë totale paraprake të shpronësimit 11,379,828 (njëmbëdhjetë milionë e treqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e njëzetë e tetë) lekë.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Berat.

Me anë të këtij publikimi kërkohet të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohet sipas vlerësimit paraprak të llogaritur:

Për pasuritë e llojit “truall” është bërë bazuar në VKM nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

Vlerësimi i pasurisë të llojit “ndërtesë” është bazuar në VKM nr. 138, datë 23.8.2000, “Për

kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara, për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Bashkisë Berat, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 11,379,828 (njëmbëdhjetë milionë e treqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e njëzetë e tetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM  
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM  
TË SHPRONËSIMEVE  
**Egra Ibrahim**



LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA PROJEKTI “RIKUALIFIKIMI URBAN I RRUGËVE ‘URA E RE SHISH’-‘ANTIPATREA’-SHËTTTORJA ‘OSUM’ DHE ‘SANTA LUCIA FILIPINE’”, BERAT

Nr.	STATUSI JURIDIK		TË DHËNAT (mbi pasurinë sipas ASHK Berat)				VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM SIPAS LLOJIT Ë PASURISË						Dokumenti i pronësisë	Këmbim	Kompensim	Çështje gjyqësore të hapura	VLERA TOTALE (lek)	SHËNIME	
	PRIVAT		Zona kadastrale	Nr. pas.	Lloji i pas.	Sip. totale (m <sup>2</sup> )	Shpronësim ndërtesë			Shpronësim tokë truall									
	Emri Atësia Mbiemri	Pronësia					Sip. (m <sup>2</sup> )	Çmimi (lek/m <sup>2</sup> )	Vlera (lek)	Sip. (m <sup>2</sup> )	Çmimi (lek/m <sup>2</sup> )	Vlera (lek)							
0	1	2	3	4	5	6	7	8	9=7*8	10	11	12=10*11	14	15	16	17	18=9+12+13	19 (SEKSIONI I KARTELËS)	
1	Refat Haxhi Cobo	Pronar	8501	14/165 – nd., 14/165	TRUALL	279.2	20		546,257.90	60.00	4,183	250,980	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√			797,238	
2	Ajet Bendo	Pronar	8501	14/131	TRUALL	18	18		12,329.30	18.00	4,183	75,294	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√			87,623	
3	Ajet Bendo	Pronar	8501	14/175+1-1 14/175+1-2	TRUALL	2,579	60.6	43,069.5	2,610,011.70		-	-	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√			2610011.7	
4	Adriano Qereshniku,Eda Qereshniku, Hamide Qereshniku, Ilirjan Qereshniku, Ines Qereshniku, Nezirhat Qereshniku	Pronar	8501	12/242	TRUALL	590			-	14.00	4,183	58,562	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√			58,562	
5	Adriano Qereshniku,Eda Qereshniku, Hamide Qereshniku, Ilirjan Qereshniku, Ines Qereshniku, Nezirhat Qereshniku	Pronar	8501	12/244	TRUALL	960			-	320.00	4,183	1,338,560	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√			1,338,560	Mbi këtë pasuri ka një ndërtim të paligjshëm
6	Lumturi Lavdan Mynevere Lavdan Shefikat Hazizi Skender Kameniku	Pronar	8501	12/182	TRUALL	4,330			-	973.00	4,183.0	4,070,059	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√			4,070,059	Mbi këtë pasuri ka një ndërtim të paligjshëm
7	Arber Bashkim Çela, Bashkim Eqerem Çela, Behije Nuri Nuri, Fatmir Nuri Nuri, Idajet Nuri Nuri, Luljeta Nuri Nuri, Lumturi Nuri Nuri, Muhamet Nuri Nuri	Pronar	8501	17/213	TRUALL	860			-	175.00	4,183	732,025	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√			732,025	Mbi këtë pasuri ka një ndërtim të paligjshëm
8	Arber Bashkim Çela, Bashkim Eqerem Çela, Behije Nuri Nuri, Fatmir Nuri Nuri, Idajet Nuri Nuri, Luljeta Nuri Nuri, Lumturi Nuri Nuri, Muhamet Nuri Nuri, Donjana Konimi ,Eriona Bejleri	Pronar	8501	17/302	TRUALL	170			-	21.00	4,183.0	87,843	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë					87,843	Mbi këtë pasuri ka një ndërtim të paligjshëm
9	Arjan Engjell Myteveli, Fatos Refat Cobo, Greta Engjell Kajana, Islam Engjell Myteveli, Lorenc Selam Hoxha	Pronar	8502	12/135	TRUALL	1,470			-	210.00	4,183.0	878,430	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√			878,430	
10	Agron Osman Tabaku	Pronar	8502	14/74	TRUALL	600			-	140.00	4,183	585,620	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√			585,620	Mbi këtë pasuri ka një ndërtim të paligjshëm
11	Adriatik Buba	Pronar	8501	14/431	TRUALL	248			-	20.00	4,183	83,660	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√			83,660	
12	Jorgji Stefan Babasikas ,Kajlopi Stavros Doga ,Mikail Stavros Babasikas,Sokol Petraq Dodi,Theodor Petraq Dodi ,Vjollca Petraq Rexha	Pronar	8502	12/120	TRUALL	600			-	12.00	4183	50,196	Kartela e Regjistrimit të Pasurisë		√			50,196	
<b>TOTALI</b>									<b>3,168,599</b>			<b>8,211,229</b>					<b>11,379,828</b>		







*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë  
të një procedure automatike nga një sistem elektronik  
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Formati 61x86/8
-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë  
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 256 lekë